



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE
SHANSEVE TË BARABARTA

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR
BARAZINË GJINORE DHE
REDUKTIMIN E DHUNËS ME BAZË
GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE,
2011-2015

Miratur me VKM Nr.573, datë 16/06/2011

Tiranë, 2012



Botimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje 2011-2015, u mundësua me mbështetjen e UN Women në Kuadrin e Programit të Përbashkët midis Qeverisë Shqiptare dhe OKB-së për periudhën 2012-2016.

Parathënie

Shqipëria ka ndërmarrë angazhime ligjore të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar diskriminimin dhe për të promovuar e bërë realitet barazinë gjinore. Në këtë kontekst, strukturat qeveritare, në bashkëpunim me shoqërinë civile e organizatat ndërkombëtare, kanë punuar në mënyrë të veçantë në drejtim të përmirësimit të legjislacionit e politikave të ndjeshme gjinore, ngritjes dhe fuqizimit të strukturave në mbështetje të barazisë gjinore dhe për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Qeveria shqiptare në Programin 2009-2013, ndër të tjera, “angazhohet për promovimin e parimeve të barazisë gjinore, forcimin e instrumentave ligjorë dhe institucionalë mbrojtës për të siguruar politikat gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes”

Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Eliminimin e Dhunës në Familje (SKBGJ-DHF) 2007-2010 shënoi një hap cilësor në angazhimin e Qeverisë shqiptare për të adresuar çështje që lidheshin me integrimin gjinor në politikat publike dhe me mbrojtjen e vajzave dhe grave nga abuzimi dhe dhuna.

Nisma e MPCSSHB për rishikimin e Strategjisë u nxit nga nevoja për të përputhur afatet e veprimtarisë së kësaj Strategjie me ato të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe si përgjigje ndaj zhvillimeve dhe kërkesave të kohës për të përforcuar veprimet që synojnë krijimin e një shoqërie që bën realitet pjesëmarrjen dhe mbrojtjen e barabartë të qytetarëve të saj.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje, 2011-2015, e rishikuar, si dhe Plani i Veprimit janë konceptuar mbi analizën dhe trajtimin e dy çështjeve kryesore: Barazia Gjinore dhe Reduktimi i Dhunës me Bazë Gjinore.

Dokumenti i ri vendos për vitet 2011-2015 katër qëllime strategjike për t’u përmbushur: Forcimi i mekanizmit institucional dhe ligjor; Rritja e pjesëmarrjes së grave në vendim-marrje; Fuqizimi ekonomik i vajzave dhe grave; si dhe Zvogëlimi i Dhunës me Bazë Gjinore. Strategjia shoqërohet

nga një plan veprimi i mirëpërcaktuar, i shoqëruar edhe me objektiva të matshme e të monitorueshme.

Nëpërmjet zbatimit të objektivave të Strategjisë synojmë ngjitjen e shkallëve domethënëse në arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri nëpërmjet integritit të perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave. Kjo do të thotë pjesëmarrje e barabartë e grave dhe vajzave, burrave dhe djemve në jetën sociale, ekonomike e politike të vendit, si dhe mundësi të barabarta për të gëzuar të gjitha të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në dobi të shoqërisë.

Kam kënaqësinë të theksoj se në procesin e rishikimit të Strategjisë u përfshinë përfaqësues të institucioneve të qeverisjes qendrore, institucione të qeverisjes lokale, përfaqësues të shoqërisë civile e shoqatave jo-qeveritare, grupeve të interesit, përfaqësues të forcave politike në vend, të fushës akademike, si dhe donatorë e partnerë ndërkombëtarë.

Hartimi i Strategjisë u mbështet nga Programi ONE UN “Për barazinë gjinore në Shqipëri”. Vizioni i mishëruar në këtë Strategji është krijimi i “një shoqërie në të cilën barazia gjinore respektohet, vlerësohet, mësohet, mbështetet dhe nxitet; ku dhuna me bazë gjinore e çdo lloj forme nuk tolerohet, por dënohet; ku të prekurit prej saj përkrahen dhe mbrohen dhe ku barazia në mundësi dhe trajtim është realitet për të gjithë, pavarësisht përkatësisë gjinore”.

Risi në përgatitjen e këtij dokumenti është se, së bashku me prioritetet, objektivat dhe masat konkrete, është përcaktuar edhe kosto financiare si dhe burimet e financimit, të cilat do të jenë nga buxheti i shtetit, buxheti i njësisve të qeverisjes vendore si dhe fonde të siguruar nga donatorët.

Sfida e të gjithëve qëndron në zbatimin e masave të parashikuara. Të punojmë të gjithë së bashku për bërjen realitet të tyre.

Gjej rastin të falenderoj të gjithë aktorët që mundësuan të kemi një dokument politikash të përjasur me standartet ndërkombëtare dhe që i adreson në drejtimin e duhur nevojat për integrimin gjinor në të gjitha nivelet.

Falenderim i veçantë për organizatat e Kombeve të Bashkuara si UNWOMEN dhe UNDP për mbështetjen e të gjithë procesit dhe, në

vazhdimësi, për të gjithë kontributin e dhënë në çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës në familje.

Spiro Ksera

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Spiro Ksera', with a stylized flourish at the end.

Ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të
Barabarta

PËRMBAJTJA

Hyrje Kapitulli 1: Kushtet Aktuale

Situata Demografike dhe Struktura Gjinore.....	14
Vlerësimi i Situatës – Arritjet dhe Sfidat.....	14
Mekanizmi Institucional dhe Ligjor.....	15
Pjesëmarrja në Vendim – marrje	23
Situata Ekonomike, Formimi Profesional dhe Pjesëmarrja në Forcat e Punës.....	28
Arsimi.....	37
Mbrojtja Sociale.....	42
Kujdesi Shëndetësor dhe Shërbimet Shëndetësore.....	44
Media.....	51
Dhuna në Familje.....	54
Performanca Aktuale e Qverisë dhe Drejtimit për Përmirësim.....	69
Ndryshimet Kryesore në Strategjinë e Rishikuar.....	71
Titulli i Strategjisë.....	72
Riprioritizimi i Fushave.....	73
Përmirësimi i Sistemit të Monitorimit mbi Bazën e Rezultateve.....	74

Kapitulli 2: Vizioni, Parimet, Qëllimi dhe Prioritetet

Strategjike.....	75
Vizioni i Strategjisë dhe Parimet.....	75
Qëllimi i Strategjisë dhe Prioritetet dhe Objektivat Strategjike.....	77
Grupet e Synuara me Përparësi.....	80
Roli i Parashikuar i Qverisë në Lidhje me Palët e Interesuara.....	84
Sektori Privat.....	84
Media.....	85
Partitë Politike dhe Organizatat Jo Fitimprurëse.....	86

Kapitulli

3:Politikat.....	88
Politikat mbi Mekanizmin Institucional dhe Ligjor.....	89
Forcimi i Mekanizmit Institucional.....	90
Harmonizimi i Legjislacionit dhe Integrimi Gjinor.....	91

Rritja e Kapaciteteve për Zbatimin dhe Monitorimin e Legjislacionit dhe Strategjisë.....	91
Politikat mbi Pjesëmarrjen e Vajzave dhe Grave në Vendim – marrje.....	92
Rritja e Pjesëmarrjes së Grave në Vendim – marrjen Politike.....	93
Rritja e Pjesëmarrjes së Grave në Vendim – marrjen Publike.....	93
Rritja e Pjesëmarrjes së Grave në Efektivat e Policisë dhe Forcave/Misioneve Paqeruajtëse.....	93
Rritja e Angazhimit Qytetar të Grave.....	93
Politikat mbi Fuqizimin Ekonomik.....	94
Rritja e Pavarësisë Ekonomike të Gruas.....	94
Formimi Profesional.....	95
Programet e Punësimit.....	96
Politikat mbi Dhunën me Bazë Gjinore.....	96
Parandalim dhe Përgjigje ndaj Dhunës.....	97
Mbështetja dhe Ri – integrimi i Viktimave të Dhunës.....	98
Kuadër Ligjor i Përmisuar.....	99
Kapitulli 4: Monitorimi dhe Vlerësimi.....	100
Objektivat e Monitorimit dhe Vlerësimit.....	100
Treguesit në Nivel Kombëtar.....	101
Treguesit në Nivel Ndërkombëtar	101
Institucionet Përgjegjëse në Nivel Qendror.....	102
Institucionet Përgjegjëse në Nivel Vendor.....	106
Mekanizmat e Monitorimit dhe Vlerësimit.....	106
Burimet Financiare.....	107
Mobilizimi i Burimeve.....	107
Ndjekja e Shpërndarjes së Burimeve dhe Shpenzimet.....	107
Dokumentimi i Proçesit të Konsultimeve.....	108
Rishikimi i Strategjisë.....	108
Bibliografi.....	109
Shtojca 1: Plani i Detajuar i Veprimit për Mekanizmin Institucional dhe Ligjor.....	112

Shtojca 2: Plani i Detajuar i Veprimit për Pjesëmarrjen e Gruas në Vendim – marrje.....	129
Shtojca 3: Plani i Detajuar i Veprimit për Fuqizimin Ekonomik dhe Shoqëror.....	150
Shtojca 4: Plani i Detajuar i Veprimit për Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore.....	192
Shtojca 5: Draft përshkrimi i Punës për Nëpunësit Gjinor në nivel qendror dhe lokal.....	210
A. Përgjegjësitë e Nëpunësve Gjinor në Nivel Ministrie.....	210
B. Përgjegjësitë e Nëpunësve Gjinor në Nivel Vendor.....	212
Shtojca 6: Lista e Pjesëmarrësve në Aktivitetet e Rishikimit të Strategjisë.....	216

Lista e Tabelave

Tabela 1: Numri i Rasteve të Raportuara të Dhunës sipas Zhvillimeve në Legjislacion dhe Ndërhyrje.....	60
Tabela 2: Indeksi i Zhvillimit Gjinor dhe Matësi i Fuqizimit Gjinor.....	102
Tabela 3: Plani i Veprimit për Mekanizmin Institucional dhe Ligjor.....	113
Tabela 4: Plani i Veprimit mbi Pjesëmarrjen e Gruas në Vendim – marrje.....	130
Tabela 5: Plani i Veprimit mbi Fuqizimin Ekonomik dhe Shoqëror.....	151
Tabela 6: Plani i Veprimit mbi Zvogëlimin e Dhunës me Bazë Gjinore.....	193

Shkurtime

BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DAP	Drejtoria e Administratës Publike
DPSHBF	Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta dhe Familjes
GNP	Grup Ndërministror i Punës
GTZ	Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit Agjensia Gjermane për Bashkëpunimin Teknik
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
IZHGJ	Indeks i Zhvillimit Gjnor
KKBGJ	Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore
LBGJSH	Ligji “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”
LMD	Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”
LDHF	Ligji “Për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”
MB	Ministria e Brendshme
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MFGJ	Matës i Fuqizimit Gjnor
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MVR	Matrica e Vlerësimit të Rezultateve
NGJ	Nënpunës/e Gjnor/e
OJF	Organizata Jo-Fitimprurëse
PVP	Platforma për Veprim e Pekinit
QZHM	Qëllimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
SKBGJ-DHF	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje

	(i referohet SKBGJ-DHF 2007-2010)
SKBGJ-DHGDHF	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore (i referohet SKBGJ-DHBGJ 2011-2015)
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Agjensia e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UN Women	Agjensia e Kombeve të Bashkuara për Gruan
VKM	Vendim i Këshillit të MinistraveHyrje

Çështjet e barazisë gjinore janë në qendër të politikave sociale të vendeve të Bashkimit European (BE) dhe një nga kërkesat për vendet që kanë hyrë në procesin e integritit european. Përkufizuar si barazi midis burrave dhe grave në të gjitha sferat, si publike dhe private, *barazi gjinore do të thotë akses dhe kontroll i barabartë mbi burimet dhe përfitimet, pjesëmarrje e barabartë në vendim-marrjen politike dhe barazi me ligj për gratë dhe burrat*. Barazia gjinore nuk është vetëm një nevojshmëri demokratike në vetvete, por gjithashtu një nevojshmëri ekonomike, politike dhe shoqërore për uljen e varfërisë dhe integritin e Shqipërisë në BE. Lënia jashtë vëmendjes apo mostrajtimi me kujdes i pabarazive gjinore, do të sillte për pasojë rrezikun e mospërfitimit maksimal të rreth 50% të popullsisë, nga progresi i arritur nëpërmjet reformave shoqërore, politike dhe ekonomike. Pabarazia gjinore, e cila evidentohet në të gjitha aspektet e jetës shoqërore në Shqipëri, nëse nuk do të vihet në qendër të politikave sociale, do të dëmtojë përpjekjet e Shqipërisë për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm, pasi nuk do të shfrytëzohet potenciali i plotë njerëzor i vendit. *Integrimi gjinor, d.m.th., procesi që siguron që perspektiva gjinore dhe qëllimi për barazi gjinore të jenë në qendër të të gjitha aktiviteteve – zhvillim politikash, kërkime, advokim/dialog, legjislacion, shpërndarje e burimeve si dhe planifikim, zbatim dhe monitorim i programeve dhe projekteve, si një strategji për të promovuar dhe arritur barazinë gjinore*, duhet të jetë pjesë e të gjitha politikave sociale, ekonomike dhe politike në Shqipëri. Një strategji e tillë jo vetëm siguron arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm nëpërmjet shfrytëzimit të potencialit të plotë njerëzor të vendit, por edhe garanton që të gjitha grupet shoqërore t'i gëzojnë këto arritje.

Kjo është baza për të kuptuar përse çështjet gjinore po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për shoqërinë shqiptare. Në dekadën e parë të këtij shekulli, ka pasur zhvillime të rëndësishme institucionale dhe strukturore për përparimin dhe emancipimin e mëtejshëm të grave në shoqërinë shqiptare, si dhe për të siguruar pjesëmarrjen aktive të tyre në lloje si burrat në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit. Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë së parë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Eliminimin e Dhunës në Familje (SKBGJ-DHF) 2007-

2010 shënoi një hap cilësor në angazhimin e qeverisë shqiptare për të adresuar çështje që lidheshin jo vetëm me integrimin gjinor në politikat publike, por edhe me mbrojtjen e vajzave dhe grave nga abuzimi dhe dhuna. Në kuadër të zbatimit të strategjisë, u bënë përpjekje për të koordinuar nismat shtetërore me angazhimin gjithnjë në rritje të shoqërisë civile.

Si një strategji ndërsektoriale afatmesme, SKBGJ-DHF 2007-2010 u bë pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013 së bashku me 15 strategji të tjera ndërsektoriale dhe 12 strategji sektoriale që mbulojnë fusha të ndryshme të zhvillimit ekonomik, social, politik dhe kulturor të vendit si dhe përparësitë për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. SKZHI është një dokument që synon t'i përgjigjet dinamikës së zhvillimit të ideve; ajo përfshin interesa dhe qëndrime të reja që përcaktojnë ecurinë e zhvillimeve sektoriale, qoftë në dobi të të gjithë popullatës, qoftë në favor të grupeve të ndryshme shoqërore. Fushat kryesore të veprimit të SKBGJ-DHF 2007-2010 ishin: 1. Mekanizmat ligjorë dhe institucionalë që sigurojnë barazinë gjinore në Shqipëri; 2. Drejtpeshimi gjinor në vendim-marrje; 3. Fuqizimi ekonomik si një ndër kushtet themelore për arritjen e barazisë gjinore; 4. Arsimi cilësor; 5. Mbrojtja sociale; 6. Shëndeti; 7. Media; dhe 4. Reduktimi i dhunës në familje. Arritjet e shënuara nëpërmjet zbatimit të kësaj strategjie shihen si pjesë integrale e përpjekjeve të bëra nga qeveria shqiptare për zhvillimin dhe integrimin e vendit.

Nisma e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) për të rishikuar SKBGJ-DHF 2007-2010 nxitet nga nevoja për të përputhur afatet e veprimtarisë së kësaj strategjie me ato të SKZHI-së dhe si përgjigje ndaj zhvillimeve dhe kërkesave të kohës për të përforcuar veprimet që synojnë krijimin e një shoqërie që bën realitet pjesëmarrjen dhe mbrojtjen e barabartë të qytetarëve shqiptarë, pa dallim seksi, identiteti gjinor, (pa)aftësie, moshe, apo origjine shoqërore.

Rishikimi i kësaj strategjie është fryt i një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, i udhëhequr nga MPÇSSHB, e cila angazhoi institucione të qeverisjes qendrore, lokale, shoqërisë civile, shoqatave

jo-qeveritare, grupe të ndryshme interesi, përfaqësues të forcave politike në vend, përfaqësues të fushës akademike, si dhe donatorë e partnerë ndërkombëtarë. Dokumenti u hartua si rezultat i **pjesëmarrjes së të gjithë aktorëve dhe palëve të interesuara në çështje të barazisë gjinore** (shihni Shtojcën 6 për një listë të aktorëve të përfshirë). Kjo pjesëmarrje e gjerë synoi të rrisë prurjen e informacionit nga shumë drejtime dhe të sigurojë që plani i rishikuar i masave dhe ndërhyrjeve të jetë në përputhje me nevojat dhe mundësitë reale të institucioneve të vendit. Gjithashtu, strategjia është rishikuar për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm qeveritarë (qendrorë e lokalë), donatorëve, shoqërisë civile dhe komunitetit, për të marrë vendime të orientuara dhe drejtuara nga përparësitë që shtron çështja e barazisë gjinore dhe reduktimit të dhunës me bazë gjinore.

Strategjia e rishikuar është konceptuar mbi analizën dhe trajtimin e dy çështjeve të rëndësishme: Barazia Gjinore dhe Reduktimi i Dhunës me Bazë Gjinore. Strategjia synon:

- të bëjë përpjekje drejt arritjes së barazisë gjinore në Shqipëri, nëpërmjet integritit të perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave. Kjo do të thotë pjesëmarrje e barabartë e grave dhe vajzave, burrave dhe djemve në jetën sociale, ekonomike e politike të vendit, si dhe mundësi të barabarta për të gëzuar të gjitha të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në dobi të shoqërisë;
- të përmirësojë mbrojtjen, reagimin e autoriteteve publike dhe mbështetjen për viktimat e dhunës me bazë gjinore, si dhe të theksojë punën parandaluese, duke adresuar shkaqet e dhunës dhe abuzimit në familje dhe shoqëri.

Gjatë procesit të rishikimit të strategjisë, Grupet e Punës u mbështetën në:

- Analizën e arritjeve të SKBGJ-DHF 2007-2010 dhe vlerësimit të situatës socio-ekonomike në Shqipëri, duke marrë në konsideratë treguesit socialë, ekonomikë, arsimorë, shëndetësorë dhe kulturorë;

- Analiza të veçanta për pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në sektorë të ndryshëm, si dhe në strukturat vendim-marrëse në nivel qendror e lokal;
- Mekanizmat ligjorë e institucionalë, si dhe burimet financiare, materiale dhe njerëzore për të hartuar politika efektive që synojnë arritjen e qëllimeve dhe objektivave të vendosura;
- Rivlerësimin e vizionit dhe sfidave kryesore për arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri;
- Rishikimin e Planit të Veprimit për të arritur synimet dhe objektivat e kësaj strategjie;
- Rishikimin e treguesve bazë për matjen dhe vlerësimin e ecurisë në bazë të Udhëzimit të MPÇSSHB Nr.1220, datë 27.5.2010 “*Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të treguesve të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, mbikqyrjen, mbledhjen dhe përpunimin e tyre*”;
- Rishikimin e fushave kryesore të ndërhyrjes për të reduktuar dhunën me bazë gjinore;
- Vërejtjet e Komitetit të Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) dhënë në 2010;
- Detyrimet ligjore dhe orientimet politike të Bashkimit Evropian (BE) në fushën e barazisë gjinore dhe trajtimit të barabartë;
- Raporti i Progresit për Arritjen e Objektivave të Mijëvjeçarit 2010.

Kushtetuta e Shqipërisë sanksionon zyrtarisht barazinë ndërmjet burrave dhe grave, por në praktikë shpesh gratë nuk i gëzojnë njësoj të drejtat e tyre si burrat. Kjo pabarazi është e prekshme në shumë fusha të jetës. Një pjesë e pabarazive mund të adresohen duke i parë me lente gjinore ndërhyrjet në fusha sektoriale si arsimi, shëndetësia, apo mbrojtja sociale; veprimet të tjera kanë natyrë ndërsektoriale, d.m.th., kërkojnë koordinim të përpjekjeve nga më shumë se një institucion të qeverisë qendrore. Konferenca Kombëtare mbi Stereotipet Gjinore mbajtur në qershor 2010 dhe Grupet e mëvonshme Teknike të Punës

gjatë rishikimit të këtij dokumenti konsideruan si të arsyeshëm riprioritizimin e objektivave të SKBGJ-DHF 2007-2010, duke vendosur një numër më të kufizuar prioritetesh strategjike. Këto forume sugjeruan përqendrimin në këto fusha specifike:

1. Mekanizmat ligjorë dhe institucionalë që sigurojnë barazinë gjinore në Shqipëri;
2. Drejtpeshimi gjinor në vendim-marrje;
3. Fuqizimi ekonomik i grave si një ndër kushtet themelore për arritjen e barazisë gjinore;
4. Reduktimi i Dhunës me Bazë Gjinore ndarë sipas kategorive: parandalim, reagim, dhe rehabilitim e ri-integrim.

Objektivat e këtij dokumenti përqëndrohen në:

1. Evidentimin e situatës aktuale të grave dhe vajzave, si dhe mënyrës së trajtimit të barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore në Shqipëri, përmes shifrave dhe fakteve;
2. Detajimin e hapave më të rëndësishëm që duhet të ndërmerren për të adresuar prioritetet lidhur me arritjen e barazisë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore;
3. Identifikimin e institucioneve përgjegjëse dhe partnerëve që do të punojnë bashkarisht për arritjen e qëllimeve të kësaj strategjie.

Duke ndjekur udhëzimet e “Manualit për Përgatitjen e Strategjive Kombëtare, Sektoriale dhe Ndërsektoriale” bashkëngjitur Urdhrit Nr. 134, datë 12.06.2006 të Këshillit të Ministrave “Për Përgatitjen dhe Hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim”, ky dokument përbëhet nga këto pjesë. **Kapitulli 1:** Kushtet aktuale - analizon në vija të përgjithshme situatën aktuale, duke u përqendruar te çështjet të cilat kërkojnë bashkërendim përmes kësaj strategjie ndërsektoriale. Atje ku të dhënat janë të disponueshme, bëhet krahasim midis kohës kur filloi zbatimi i SKBGJ-DHF 2007-2010 në 2007 dhe gjendjes së tanishme. Në të trajtohet edhe çështja e performancës së qeverisë, sektorët ku ajo mund të përmirësohet si dhe arsyet për rishikimin e strategjisë. **Kapitulli 2:** Vizioni, qëllimet dhe prioritetet strategjike - është një shprehje konçize e kuadrit të

përgjithshëm të procesit të planifikimit strategjik në këtë fushë horizontale. Theks i veçantë vendoset te roli i parashikuar i qeverisë në lidhje me aktorët e tjerë të rëndësishëm në zbatimin e strategjisë. **Kapitulli 3:** Politikat - përshkruan politikat kryesore, të cilat do të ndihmojnë për arritjen e qëllimeve të strategjisë. Theks i veçantë vendoset te analiza se si politikat e identifikuar ndihmojnë në arritjen e qëllimeve strategjike dhe strategjitë sektoriale të cilat trajtojnë këto politika. **Kapitulli 4:** Monitorimi - përshkruan treguesit e monitorimit dhe institucionin përgjegjës, i cili do të vlerësojë ecurinë drejt arritjes së qëllimeve strategjike duke u këshilluar me aktorë të ndryshëm të interesuar në arritjen e barazisë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore në Shqipëri.

Strategjia shoqërohet nga Plane Veprimi (të përfshira si Shtojca 1-4) me ndërhyrje dhe tregues të përcaktuar për të gjitha fushat prioritare të sipërpërmendura. Ai bazohet në dhe informohet nga:

- ☞ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- ☞ Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri (LBGJSH);
- ☞ Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD);
- ☞ Ligji për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare (LDHF);
- ☞ Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit 1995, dhe dokumentat pasardhës;
- ☞ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW);
- ☞ Vërejtjet Përfundimtare të ardhura nga Komiteti i CEDAW paraqitur në përfundim të Sesionit të 46 mbajtur në Nju Jork në 12-30 korrik 2010;
- ☞ Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë;
- ☞ Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA);
- ☞ Strategjia e Bashkimit Evropian (BE) për Barazinë midis Grave dhe Burrave 2010-2015;
- ☞ Strategjia lokale për zbatimin e Udhëzimeve të BE mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave dhe luftës së të gjitha formave të diskriminimit ndaj tyre – miratuar nga Drejtuesit e Misionëve të BE-së në Shqipëri.

KAPITULLI 1

KUSHTET AKTUALE

Qeveria Shqiptare miratoi Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Eliminimin e Dhunës në Familje (SKBGJ-DHF) me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 913, datë 19.12.2007. Kjo strategji synoi: (1) të arrijë barazinë gjinore në Shqipëri, nëpërmjet integritit të perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave; si dhe (2) të përmirësojë mbrojtjen, reagimin e sistemit të drejtësisë dhe mbështetjen për viktimat e dhunës në familje. Kohëzgjatja e kësaj strategjie ishte 2007-2010. Në përputhje me Urdhërin Nr. 134, datë 12.06.2006 të Këshillit të Ministrave “*Për Përgatitjen dhe Hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim*”, si dhe për të sinkronizuar kontributet e arritjeve të kësaj strategjie me ato të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) është bërë e nevojshme shtyrja e afatit të saj për të mbuluar periudhën 2011-2015. Shtyrja e afatit solli nevojën e vlerësimit të arritjeve të shënuara nëpërmjet SKBGJ-DHF 2007-2010 si dhe një mundësi për të rishikuar se si ndërhyrjet e parashikuara në këtë dokument adresojnë zhvillimet aktuale në Shqipëri. Ky kapitull analizon në vija të përgjithshme situatën aktuale bazuar në Raportin e Vlerësimit të SKBGJ-DHF 2007-2010, evidenton çështjet që ende mbeten sfidë në arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri dhe komenton ndryshimet e bëra në dokumentin e rishikuar duke u përqendruar dhe theksuar çështjet të cilat kërkojnë bashkërendim përmes kësaj strategjie.

Situata Demografike dhe Struktura Gjinore

Popullsia e Shqipërisë karakterizohet nga një moshë e re, mesatarja e së cilës është 32.7 vjeç, me 32.3 vjeç për meshkujt dhe 33.1 vjeç për femrat. Ndarja e popullsisë sipas seksit është e ekuilibruar, femrat zënë rreth 50% të popullsisë¹. Moshë e re, proceset e urbanizimit, lëvizjet migratore, emigracioni dhe faktorë të tjerë ekonomikë kanë bërë që gjatë 20 viteve të fundit, treguesit demografikë të jenë dinamikë. Kështu, brenda një kohe të shkurtër kanë ndryshuar raportet midis popullsisë rurale dhe urbane. Aktualisht popullsia urbane është rritur në 48.7% nga 35.8% që ka qenë në fillim të viteve '90-të. Rritja e popullsisë urbane ka ardhur si pasojë e zhvendosjes së lirë dhe masive të popullsisë rurale drejt qyteteve të mëdha, por edhe nga lëvizjet nga fshati në qytet brenda të njëjtit rreth. Sipas vlerësimeve të bëra nga INSTAT, jashtë Shqipërisë llogaritet të kenë emigruar rreth 750,000 shqiptarë ose 20% e popullsisë. Një vështrim i thellë në grupmoshat e popullsisë tregon se tranzicioni ndikoi në strukturën e popullsisë shqiptare. Gjithashtu një ndryshim themelor ai ka sjellë edhe përsa i përket strukturës së familjes. Përpjekjet për një jetesë më të mirë kanë bërë që familja shqiptare të mos ndryshojë vetëm vendin ku do të jetojë, por edhe mënyrën se si jeton. Një ndër treguesit që ka ndryshuar vitet e fundit është edhe mosha e martesës, nga 22.6 vjeç në 23.3 vjeç për femra dhe nga 27.2 vjeç në 29 vjeç për meshkuj. Po kështu kanë ndryshuar dhe numri i divorcive nga 9.6 divorce për 100 martesa në 2001 në 17 divorce për 100 martesa në 2008. Që nga viti 1960 indeksi sintetik i fekonditetit ka pësuar rënie të vazhdueshme. Në vitin 1960 ky indeks ishte mjaft i lartë, më shumë se 5 fëmijë për një femër të grupmoshës riprodhuese, ndërsa në vitin 2008 ky indeks u ul në 1.4 fëmijë për një femër të grupmoshës riprodhuese.²

Vlerësimi i Situatës - Arritjet dhe Sfidat

Elementet kyçe të SKBGJ-DHF 2007-2010 ishin avancimi i barazisë gjinore dhe minimizimi i dhunës në familje nëpërmjet politikave dhe procedurave publike në nivel qendror dhe lokal. Zbatimi i kësaj

¹ INSTAT 2010 "Shqipëria në Shifra 2010"

² INSTAT 2010 "Femra dhe Meshkuj 2008"

strategjie u vlerësua nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) në 2010. Rezultatet e këtij vlerësimi u validuan gjatë vitit 2010.

Vlerësimi i SKBGJ-DHF 2007-2010 vuri në dukje që kjo strategji ka shënuar arritje në avancimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave me burrat si vendim-marrës në zhvillimin politik, social dhe ekonomik të vendit, si dhe në ndërgjegjësimin dhe përgjegjshmërinë e instancave shtetërore për dhunën në marrëdhëniet familjare. Vlerësimi vuri në dukje gjithashtu se mbetet ende shumë për të bërë. Ndërsa ndërhyrjet e strategjisë janë fokusuar kryesisht në adresimin e nevojave dhe të drejtave për gruan në zonat urbane, gratë në zonat rurale dhe ato që i takojnë kategorive më të prekshme nga varfëria dhe dhuna, si gratë e pakicave etnike, gratë kryefamiljare, dhe ato me aftësi të kufizuara duhet të vijnë në qendër të veprimeve të ardhshme. Më specifikisht, situata e grave dhe burrave sipas tetë fushave prioritare të përcaktuara në SKBGJ-DHF 2007-2010 analizohen në seksionet e mëposhtme.

Mekanizmi Institucional dhe Ligjor

Kuadri Ligjor. Sanksionimi me ligj i barazisë së të gjithë shtetasve përpara ligjit (Neni 18 i Kushtetutës) bën që burri dhe gruaja, si subjekte të së drejtës, *de jure* të trajtohen përgjithësisht njësoj, në mënyrë të barabartë dhe si pasojë të kenë edhe detyrime të njëjta. Barazia përshkon të gjithë Kushtetutën dhe ligjet e tjera. Ligji Nr. 9970 datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” (LBGJSH) plotësoi më tej kuadrin ligjor lidhur me barazinë gjinore në arsim, punësim dhe vendim-marrje. Qëllimi i këtij ligji është: a) të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë; b) të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet; c) të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore, qendrore dhe vendore, për të hartuar dhe zbatuar aktet normative, si dhe politikat që mbështesin zhvillimin dhe nxitjen e barazisë gjinore në shoqëri. Risitë që sjell ky ligj kanë të bëjnë me futjen e përkufizimeve të reja si: ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë i cili është në përputhje me përkufizimin e

diskriminimit dhënë në CEDAW, integrimi gjinor, përkufizimi dhe ndalimi i ngacmimit për shkak të përkatësisë gjinore, përkufizimi i barazisë gjinore, përkufizimi i përfaqësimit të barabartë gjinor dhe parashikimi i masave të posaçme të përkohshme në vendimmarrjen politike e publike të parashikuara në formën e kuotës neutrale në masën jo më pak se 30% për gjininë më pak të përfaqësuar; përkufizimi dhe lejimi si jodiskriminuese i masave të veçanta të përkohshme; krijimi i strukturave të reja politikëbërëse, ekzekutuese dhe mbrojtëse; futja e masave të posaçme në sistemin arsimor dhe fushën e punësimit; puna e papaguar; si dhe detyrimi për mbledhjen e statistikave gjinore.

Dy ligje të tjera që përbëjnë bazën e ndërhyrjeve për respektimin e barazisë gjinore në Shqipëri janë Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (LDHF) së bashku me amendimet e tij (shihni seksionin për Dhunën me Bazë Gjinore) dhe Ligji Nr 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (LMD).

Një sërë Kodesh të miratuara pas vitit 1995, përmbajnë dispozita në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe sanksionojnë parimin e barazisë burrë-grua. Megjithatë, në kuadër të zbatimit të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje, i cili u nënshkrua nga Qeveria Shqiptare për të mbështetur zbatimin e SKBGJ-DHF 2007-2010, ka përfunduar paketa e rishikimit të disa prej ligjeve. Ky rishikim evidentoi pjesën më të madhe të atyre rasteve kur vetë ligji bën përcaktime diskriminuese ndaj burrave ose grave, kur *de jure* nuk sigurohet përputhja me standardet e kërkuara nga CEDAW, me normat e vendosura nga *acquis communautaire* për trajtimin e barabartë dhe kur këto ligje bien ndesh dhe nuk ndërthuren mirë me përcaktimet e reja që kanë sanksionuar LBGJSH dhe LDHF, si ligje më të përparuara. Nga ana tjetër, ky rishikim ka formuluar propozime konkrete dispozitash që synojnë të amendojnë legjislacionin ekzistues për të siguruar përputhje më të mirë me parimet e barazisë gjinore dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë në këtë fushë.

Vërejtjet e ardhura nga Komiteti i CEDAW për Raportin e Tretë Periodik të Shqipërisë në Qershor 2010 kanë shtruar detyra të reja në lidhje me aplikimin e drejtpërdrejtë të CEDAW në legjislacionin e Shqipërisë dhe harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit aktual me ligjet e reja të barazisë gjinore dhe mbrojtjes kundër diskriminimit si dhe me CEDAW, sidomos se si ato adresojnë forma të ndryshme të diskriminimit që prekin gratë që u përkasin minoriteteve etnike, gratë me aftësi të kufizuara, gratë në zonat rurale, apo dhe gratë e grupeve të tjera të disavantazuara duke forcuar edhe sanksionet për aktet e diskriminimit. Këto vërejtje gjithashtu përqendrohen në bërjen të detyrueshme të CEDAW për të gjitha degët e qeverisjes dhe kërkesën ndaj Parlamentit për të zbatuar këto vërejtje. Kjo kërkon hartimin e Planeve specifike të Punës për fushën që mbulon çdo ministri. Për më tej, është e nevojshme rritja e përpjekjeve për ndërgjegjësim të grave në lidhje me kuadrin ligjor, përdorimin e ligjit për rastet e diskriminimit me bazë gjinore si dhe monitorimin e përpjekjeve të tilla. Në këtë kuadër, bëhet e nevojshme rritja në mënyrë sistematike e njohurive mbi Konventën dhe Protokollin e saj Shtesë si dhe mbi çështjen e barazisë gjinore nëpërmjet trajnimeve dhe programeve të tjera të informimit, sidomos për deputetët, gjyqësorin, dhe zyrtarët e lartë të qeverisë. Këto dokumenta, rekomandon Komiteti i CEDAW, duhet të bëhen pjesë integrale e kurrikulave të arsimit, duke përfshirë dhe arsimin juridik.

Mekanizmat Institucionalë. Mekanizmi Shtetëror i Barazisë Gjinore, i cili përbëhet nga një sërë strukturash shtetërore është ngritur për të nxitur përparimin e barazisë gjinore dhe për të siguruar gëzimin e të drejtave njerëzore të grave. Ky mekanizëm është ngritur në zbatim të rekomandimeve nga CEDAW, Platforma për Veprim e Pekinit (PVP) dhe në zbatim të LBGJSH. Funkzioni i tij kryesor është të monitorojë dhe të sigurojë zbatimin e ligjeve, të parimit të mos-diskriminimit dhe barazisë midis burrave dhe grave. LBGJSH përcakton si autoritet përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore Ministrin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Bazuar në LBGJSH si dhe LDHF, Ministri e kryen funksionin e mësipërm i ndihmuar nga struktura e specializuar brenda dikasterit të tij, Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta dhe Familjen (DPSHBF), e cila funksionon në këtë

Ministri që prej vitit 2006. Misioni kryesor i saj është të nxisë barazinë gjinore dhe një pjesëmarrje të gjerë të gruas në jetën ekonomike, politike e kulturore të vendit si dhe formulimin dhe zhvillimin e politikave për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, e në përgjithësi të dhunës me bazë gjinore. DPSHBF përbëhet nga dy sektorë: Sektori i Barazisë Gjinore dhe Për Masat Ndaj Dhunës në Familje dhe Sektori Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. Pas daljes së LMD, kësaj Drejtorie u ngarkua edhe detyra që të punonte edhe për zbatimin e këtij ligji. Vlerësimi tregoi që ndërsa ky sektor ka kontribuar gjerësisht në bashkërendimin e veprimeve dhe monitorimin e SKBGJ-DHF 2007-2010, kapacitetet e tij politikëbërëse dhe monitoruese duhet të fuqizohen; struktura e tij është e pamjaftueshme për të përballuar volumin e punës.

Në bazë të LBGJSH, propozimi i politikave mbi barazinë gjinore i ngarkohet Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore. Ky këshill ka për detyrë të këshillojë Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për barazi gjinore, me përjashtim të çështjeve që merren në shqyrtim nga Këshilli Kombëtar i Punës dhe të sigurojë integrimin gjinor në të gjitha fushat. Ai është ngritur me VKM Nr. 122, datë 2.2.2009 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore”, drejtohet nga Ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore (aktualisht nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta) dhe në përbërje ka 9 zëvendësministra të MPÇSSHB, Ministrisë së Integritimit (MI), Ministrisë së Financave (MF), Ministrisë së Drejtësisë (MD), Ministrisë së Brendshme (MB), Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS), Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) si dhe tre anëtarë përfaqësues të shoqërisë civile. Këshilli mbledhet jo më pak se dy herë në vit. Ai është mbledhur tri herë, mbledhja e fundit e tij është realizuar në dhjetor 2010. Në këto mbledhje KKBGJ ka miratuar Raportet Monitoruese vjetore të SKBGJ-DHF 2007-2010 si dhe Dokumentin me Treguesit e Harmonizuar Gjinorë për monitorimin e barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave. Për të përmbushur më mirë detyrat e tij këshilluese dhe drejtimit të politikave shtetërore, shtrohet

detyra për rritjen e numrit të Këshillit me përfaqësim të ministrive të tjera, si Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE) dhe Ministrisë së Mbrojtjes (MM).

Miratimi i LBGJSH shtroi edhe detyrimin institucional për emërimin e Nëpunësve Gjinatorë (NGJ) në çdo ministri të linjës dhe në organet e pushtetit vendor. Neni 13/3 përcakton se “Institucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me ministrin përkatës, për shkëmbimin e informacionit dhe lehtësimin e përmbushjes së funksionit të tij.” Ligji shtron detyrimin që nëpunësit për çështjet gjinore të emërohen në Ministri dhe në organet e pushtetit vendor. Në nivel qendror vetëm MSH ka institucionalizuar pozicionin e NGJ me kohë të plotë, siç e kërkon ligji, ndërkohë që në ministrinë të tjera ka pika fokale gjinore, pra persona që mbulojnë detyra të tjera, por u është ngarkuar të merren edhe me çështjet e barazisë gjinore. Në nivel vendor janë zyrtarizuar 12³ NGJ, edhe pse ka pika fokale për barazinë gjinore në 65 njësi vendore⁴. Gjatë vitit 2009 janë zhvilluar trajnimet me temë: “Konceptet bazë të përkatësisë gjinore në qeverisjen lokale” me përfaqësues të pushtetit vendor për Barazinë Gjinore në 36 bashki të vendit duke përfshirë gjithsej 721 përfaqësues të administratës së Bashkive në 36 Bashkitë e vendit.⁵ DPSHBF ka përgatitur Përshkrimet e Punës (Draft) për këta nëpunës; qëllimi i punës së tyre konsiston në monitorimin, zbatimin e angazhimeve të qeverisjes qendrore dhe vendore siç shprehet në strategjitë kombëtare dhe kuadrin ligjor si dhe në konventat dhe deklaratat ndërkombëtare për çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës në familje. Nëpunësi Gjinator gjithashtu mbështet integrimin e çështjeve të barazisë gjinore në politikën, programet dhe ligjet që hartohen nga Ministria apo Bashkia ku punon nëpunësi i barazisë gjinore. Vlerësimi vuri në dukje se ende mbetet shumë për të bërë për të krijuar mjedisin e duhur për funksionimin efektiv të mekanizmit institucional. Përtej statistikave të mësipërme, jo të gjitha institucionet në nivel qendror dhe vendor kanë

³ Shifër e dhënë gjatë takimit të Grupit teknik mbi Mekanizmin Ligjor dhe Institucional

⁴ Intervistë me stafin e projektit Barazi në Qeverisje.

⁵ MPÇSSHB. 2010. “Raporti Vjetor i Monitorimit për SKBGJ-DHF 2007-2010, Janar-Dhjetor 2009.”

burimet e duhura njerëzore, financiare dhe teknike për funksionim efektiv. Kështu, gjatë procesit të vlerësimit të SKBGJ-DHF 2007-2010, nga një vështrim i strategjive, politikave dhe planeve të veprimit të hartuara pas miratimit të LBGJSH, u vu re se dokumentat e përpunuara dhe miratuara nga Ministria e Shëndetësisë, që ka një Nëpunëse Gjinore të emëruar me kohë të plotë, ishin dukshëm më të ndjeshme nga pikëpamja gjinore se dokumente të ngjashme të përpunuara nga dikastere të tjera. Në përputhje dhe me rekomandimet e CEDAW, prania e burimeve të tilla njerëzore mundëson zbatimin efektiv të Strategjisë së rishikuar dhe planeve të veprimit për çdo instancë qeveritare.

Në nivel parlamentar deri në vitin 2009 brenda Komisionit Parlamentar të Punës dhe Çështjeve Sociale, ka funksionuar Nënkomisioni për Minorenët dhe Shanset e Barabarta. Kuvendi i ri që doli nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2009, ka në përbërje Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, i cili shtrin fushat e përgjegjësisë edhe te gruaja dhe familja, veç marrëdhënieve të punës, çështjeve sociale, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësisë⁶. Ky Komision, shqyrton projektligje dhe ndërmer nisma ligjore në fushat e përgjegjësisë së vet dhe ndërton bashkëpunim me MPCSSHBB për çështjet e barazisë gjinore dhe fëmijëve.

Me hyrjen në fuqi të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, u krijua edhe institucioni i Komisionerit, i cili kryen funksionet e një ombudsmani për çështje të diskriminimit për çfarëdo shkak, përfshi gjininë, por edhe identitetin gjinor, shtatzaninë, orientimin seksual, gjendjen familjare apo martesore, përgjegjësinë prindërore, të cilat tipikisht janë të lidhura ngushtë me gjininë e personit. Ky institucion ka kompetencë të shqyrtojë ankesat për diskriminim nga individët, grupet e tyre apo organizatat, të kryejë hetime, të monitorojë zbatimin e këtij ligji, të vendosë sanksione, të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

Integrimi gjinor në politika dhe buxhete. LBGJSH parashikon integrimin gjinor si strategji për arritjen e barazisë gjinore në shoqëri

⁶ http://www.parlament.al/web/Perberja_10065_1.php

nëpërmjet përfshirjes së perspektivës së secilës nga gjinitë në të gjitha proceset ligjvënëse, politikëbërëse, planifikuese, zbatuese e monitoruese. Ndërsa vlerësimi nuk ndeshi në ndërhyrje specifike, Plane Pune për Ministri apo njësi të pushtetit vendor që kanë përfshirë perspektivën gjinore (me përjashtim të Ministrisë së Shëndetësisë), Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore ka qenë një nga kontribuesit kryesorë për të siguruar procesin e integritimit gjinor, veçanërisht buxhetimin gjinor në nivel lokal. Këto ndërhyrje kanë qenë në nivel pilot. Vlerësimi afatmesëm i këtij programi tregoi se është arritur progres modest në zhvillimin e proceseve për të integruar çështje të barazisë gjinore në politika dhe buxhete qendrore dhe lokale. Përvojat lidhur me buxhetimin gjinor në nivel lokal kanë evidentuar nevojën për zhvillimin e kapaciteteve në autoritetet lokale, të tilla që të sigurojnë aplikimin e praktikës së buxheteve gjinore.⁷ Për më gjerë, një analizë gjinore e strategjive sektoriale do të mundësonte adresimin e duhur të nevojave dhe të drejtave të grave dhe të burrave në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe shoqërisë. Si rrjedhojë e ndërhyrjeve të SKBGJ-DHF 2007-2010, një pjesë e kapaciteteve teknike janë ngritur. Përpjekje të mëtejshme do të bëhen për të ndërtuar mbi ekspertizën dhe instrumentet ekzistuese. Një nga mësimet e rëndësishme të mësuara është që këto burime nuk janë shumë shpesh të njohura ose nuk përdoren nga ata që drejtojnë hartimin e politikave, programeve dhe projekteve. Ndaj është e rëndësishme të ndahen informacioni dhe praktikat në forume të ndryshme. MPCSSH e ka nisur këtë përvojë të mirë në bashkëpunim me donatorë si UN Women dhe OSBE.

Monitorimi i legjislacionit dhe politikave/strategjive. Në mbështetje të LBGJSH dhe me Urdhër të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Nr.2498, datë 16.12.2008 i ndryshuar me Urdhrin Nr. 2271 datë 08.12. 2009 u ngrit Grupi i Punës NdërInstitucional (GPNI) si grup këshillimor për evidentimin dhe

⁷UNIFEM 2009. Mid-Term Evaluation of the UN Joint Programme on GE in Albania (July 2008-June 2011) [Vlerësimi Afatmesëm i Programit të Bashkuar të Kombeve të Bashkuara mbi Barazinë Gjinore në Shqipëri (Korrik 2008-Qershor 2011)].

përcaktimin e statistikave gjinore në mbështetje të politikave të monitorimit të barazisë gjinore në Shqipëri. Puna e këtij grupi ndërinstytucional në bashkëpunim të ngushtë me UNIFEM (tashmë UN Women), rezultoi në zyrtarizmin e një seti Treguesish Gjinorë të nevojshëm për monitorimin e barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, të cilët duhet të mblidhen në mënyrë të detyrueshme. Tashmë ka një Udhëzim të Ministrit Nr.1220, datë 27.5.2010 për *Përcaktimin e Treguesve të Vlerësimit dhe të Monitorimit të Treguesve të Barazisë Gjinore dhe Dhunës ndaj Grave, përfshirë Dhunën në Familje, Mbikëqyrjen, Mbledhjen dhe Përpunimin e Tyre*. Që SKBGJ-DHBGJ 2011-2015 të zbatohet sipas parashikimeve, është e rëndësishme që këta tregues të përdoren për të monitoruar dhe vlerësuar rregullisht të gjitha rrugët e ndjekura dhe masat që përdoren për zbatimin e saj, dhe që të vendoset koordinim efektiv midis qeverisë qendrore dhe pushtetit vendor për të arritur objektivat e Planeve të Veprimit të kësaj Strategjie.

Nga ana tjetër, monitorimi konsiston edhe në analizen se sa ndikim ka patur legjislacioni i barazisë gjinore dhe kundër diskriminimit, ç'mospërputhje janë evidentuar dhe si janë adresuar ato për të siguruar që zbatimi i këtij legjislacioni të çojë në eliminim efektiv të diskriminimit kundër grave, sidomos grave që u takojnë grupeve të disavantazuara (gratë e minoriteteve etnike dhe gjuhësore, gratë me aftësi të kufizuara, gratë e moshuara, gratë që jetojnë në zonat rurale ose në zona të largëta, gratë emigrante, gratë që jetojnë me HIV/AIDS, dhe gratë që diskriminohen mbi bazën e orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor).

Sfidat. Megjithë arritjet, SKBGJ-DHBGJ 2011-2015, duhet të adresojë disa sfida për forcimin e mekanizmit institucional dhe ligjor. Në aspektin ligjor, mbetet sfida harmonizimi në vazhdimësi i legjislacionit me standardet ndërkombëtare, si dhe rritja dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit aktual për barazinë gjinore në Shqipëri nëpërmjet inspektorateve të ngarkuara të bëjnë kontrollin e tij, si p.sh. Inspektoriati i Punës, Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektoriati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, etj. . Në aspektin e mekanizmit institucional, sfidat kryesore mbeten burimet e pamjaftueshme njerëzore për integrimin gjinor, emërimi me kohë të

plotë dhe rrjetëzimi i NGJ në nivel qendror dhe lokal, ngritja e kapaciteteve të tyre për të bërë analiza dhe programime sipas parimit të integritimit gjinor, si dhe ndërtimi i një njësie të specializuar për të monitoruar progresin e Strategjisë.

Pjesëmarrja në Vendim-marrje

Barazia gjinore dhe për rrjedhojë, pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave në vendim-marrje është pjesë përbërëse e proceseve demokratizuese. Në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ratifikimi i instrumentave të rëndësishëm ndërkombëtarë si CEDAW dhe Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara për Gruan, Paqen dhe Sigurinë, janë bërë përpjekje sistemike për të adresuar përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e grave në politikë dhe administratën publike. Gjatë zbatimit të SKBGJ-DHF 2007-2010 janë vënë re zhvillimet e mëposhtme.

Pjesëmarrja e gruas në politikë. Krahasuar me vitin 2006, janë shënuar arritje në rritjen e numrit të grave në jetën politike. Kodi Zgjedhor i miratuar në nëntor 2008 sanksionoi përfundimisht zbatimin e kuotave të përfaqësimit gjinor në listat shumë-emërore të partive politike për zgjedhjet e përgjithshme si dhe ato për organet e qeverisjes vendore. Partitë politike shqiptare kanë shprehur angazhimin e tyre politik për të aplikuar kuotat e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në strukturat e tyre drejtuese e vendimmarrëse. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2009, u vu re edhe një tendencë për më shumë vëmendje ndaj problemeve gjinore në platformat zgjedhore dhe daljet publike të përfaqësuesve të partive politike, sidomos në periudhën elektorale të vitit 2009.

LBGJSH, duke përcaktuar kuotat e pjesëmarrjes së grave jo vetëm në politikë, por edhe në administratën publike, nxiti përfshirjen e këtij detyrimi edhe në Kodin e ri Zgjedhor të vitit 2008. Si rrjedhojë, përfaqësimi i grave në Kuvend u dyfishua dhe po vërehet një angazhim i shoqërisë civile për të nxitur respektimin e kuotës gjinore prej 30% në zgjedhjet vendore të majit 2011. Kështu, në Legjislaturën XVIII, të dalë nga zgjedhjet e vitit 2009, ka 23 përfaqësuese gra ose 16.4% krahasuar me 10 gra deputete ose 7.1% në Legjislaturën XVII të dalë nga zgjedhjet e vitit 2005. Që nga 2005, kryetare e Kuvendit të

Shqipërisë është një grua. Që nga 2007, vendet e Kryetares së Gjykatës së Lartë dhe të Prokurores së Përgjithshme i mbajnë dy gra. Në vitin 2010 ka vetëm një grua ministre në kabinetin qeveritar prej 14 ministrash. Janë tetë gra zëvendësministre (22.8%) dhe pesë gra ambasadore (10.2%). Këto prurje vijnë nga bota akademike, politike dhe e shoqërisë civile dhe përbëjnë një hap cilësor në përfaqësimin e grave në instancat e larta qeverisëse. Por në nivel lokal, përfaqësimi i grave mbetet ende i ulët. Në zgjedhjet e fundit për organet e qeverisjes vendore, kandidimi i grave për kryetare bashkie/komune ishte më pak se 3%. Nga 33 gra të kandiduara vetëm 9 prej tyre fituan.⁸

Megjithë mentalitetin patriarkal, pjesëmarrja e grave dhe vajzave në politikë ka filluar të bëhet e pranueshme në opinionin publik shqiptar. Sipas një vrotimi të kryer para zgjedhjeve të vitit 2009, të iniciuar dhe mbështetur nga UNIFEM⁹ (tashmë UN Women) ka një rritje të ndërgjegjësimit të shoqërisë në lidhje me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në politikë. Sipas këtij vrotimi, 73.4% e të intervistuarve mendojnë se ka nevojë për ta rritur praninë e grave në jetën publike. Pjesëmarrësit në studim ishin në mbështetje të idesë së kuotave dhe lënë të kuptohet se gjinia e kandidatit nuk përbën as pengesë dhe as shtysë për të votuar. Në bazë të këtij vrotimi, perceptimi i publikut mbi pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në politikë është pozitiv.

Politika në Shqipëri dominohet nga pjesëmarrje e lartë e meshkujve. Sipas një studimi të 2011, faktorët që influencojnë negativisht vendimet e grave për të hyrë në politikë janë përgjegjësitë familjare, detyrimet në punësimin aktual, si dhe kontaktet e pamjaftueshme me strukturat politike lokale.¹⁰ Ndërsa studimi nuk jep informacion në lidhje me korrelacionin midis përvojave të mëparshme të angazhimit në aktivitete politike dhe civile dhe vendimit për të hyrë në politikë, në vende të tjera të botës është vënë re që mungesa e njohurive në lidhje me funksionimin e jetës politike, mungesa e përvojës në punë të

⁸ ACER&ASET 2011 “The situation of women leaders at the local level in Albania – a baseline analysis” [Situata mbi gratë udhëheqëse në nivel vendor në Shqipëri – analizë e informacionit fillestar], Tiranë, Shqipëri.

⁹ ACER & ASET. 2008. Perceptimi publik në lidhje me pjesëmarrjen e grave në zgjedhje në Shqipëri, mbështetur nga UNIFEM. Tiranë

¹⁰ Po aty.

organizuar dhe fushata mund të bëhen faktorë dekurajues në vendimin që marrin gratë për të mos u bërë pjesë aktive e politikës.

Pjesëmarrja e grave në administratën publike. Megjithëse prania e grave në administratën publike është inkurajuese, janë burrat ata që dominojnë në pozicionet drejtuese. Analiza e punësimit sipas grup-profesioneve (bazuar në klasifikimin ndërkombëtar të profesioneve ISCO 88) dhe gjinisë tregon se për disa grup-profesione ka diferenca të dukshme në punësimin e meshkujve dhe të femrave. Në grupin e ligjvënësve, nëpunësve të lartë dhe drejtuesve, 23.7% e të punësuarve janë femra dhe 76.3% janë meshkuj.¹¹

Pjesëmarrja e grave në efektivat e forcave/misioneve paqeruajtëse dhe policore.¹² Megjithë përpjekjet e vazhdueshme, përfaqësimi i grave në këto efektiva mbetet i ulët. Kështu, në Forcat e Armatosura vetëm 10% janë gra. Sipas gradave, kemi këtë shpërndarje: Grupi I – Gradat për oficere 340 ose 14.5%¹³. Grupi i II – Gradat për nënoficere 453 ose 12.6%¹⁴; Grupi i III – Grada për ushtarë profesioniste, 333 ose 9.6% përfaqësim femëror¹⁵. Në forcat e policisë gjendja paraqitet më optimiste, megjithëse përfaqësimi në instancat e larta ka vend për përmirësim. Në Policinë e Shtetit përfaqësimi femëror sipas gradave është 152 ose 29.23%¹⁶. Përfaqësimi i grave në forcat e paqes apo misionet paqeruajtëse është gjithashtu modest - aktualisht në misionet paqeruajtëse ka 2 femra (1 oficere dhe 1 n/oficere).. Vihet re

¹¹ INSTAT 2010. "Femra dhe Meshkuj 2008."

¹² Ky nënseksion është përgatitur me informacion të marrë nga një prezantim i bërë nga J. Katro 2010 në lidhje me gruan, zhvillimin dhe aplikimin e Rezolutës 1325 të Kombeve të Bashkuara për Gruan, Paqen dhe Sigurinë.

¹³ Ndarja e grupit I sipas kategorive - Kolonele: 2 ose 2.7%; N/Kolonele: 28 ose 28.5%; Majore: 69 ose 11.6%; Kapitene: 23 ose 6.76%; Togere: 130 ose 19.9%; N/togere: 88 ose 26.4%)

¹⁴ Ndarja e grupit II sipas kategorive - Kaptere: 40 ose 19.1 %; Rreshtere: 106 ose 10.6 %; Tetare: 160 ose 12.4%; N/tetare: 147 ose 13.4%

¹⁵ Ndarja e grupit III sipas kategorive - Ushtarë profesioniste grupi 1: 154 ose 11%, Ushtarë profesioniste grupi 2: 179 ose 8.6%

¹⁶ Përfaqësimi i grave në strukturat policore sipas gradave: Drejtues i parë: 1 ose 5.55%; Drejtues: 10 ose 14.49%; K/komisar: 39 ose 19.21%; Komisar: 13 ose 30.23%; N/komisar: 8 ose 22.22%; K/inspektor: 17 ose 42.50%; Inspektor: 3 ose 14.28%; Civil: 61 ose 72.61%.

pjesëmarrje e njëjtë në procedurat e niveleve operacionale përfshirë stërvitje, në shkollat e trupës, në shërbime. Gratë përfshihen në shërbimin 24 orësh në institucion, apo dhe shërbime të tilla profesionale si mjeke, infermiere, inxhinierë rrjetesh, centrale, komunikim tele-faks, me përjashtim të shërbimit 24 orësh në terren. Ndonëse ka raportime në lidhje me situatën e grave në forcat e armatosura dhe policore nga Ministria e Mbrojtjes dhe e Rendit (MMR) në MPCSSHB, këto nuk janë periodike. Për një pasqyrim të saktë të situatës, nevojitet grumbullimi dhe raportimi i rregullt i të dhënave statistikore gjinore nga MMR. Për më tej, përfaqësimi i grave në institucionet përkatëse do të përfitonte nga politika dhe masa të veçanta inkurajuese për rritjen e pjesëmarrjes së grave në strukturat e paqes dhe sigurisë, si dhe nisma ndërgjegjësuere me drejtues të policisë për mundësinë e shanseve të barabarta në vendim-marrje/punësim, por dhe kualifikim të grave punonjëse pranë këtyre institucioneve.

Përfaqësimi i grave në shoqërinë civile. Organizatat Jo-Fitimprurëse (OJF), të njohura si pjesa më aktive e shoqërisë civile, kanë qenë shumë aktive në zhvillimet demokratike edhe pse shpesh u është dashur të operojnë në një shoqëri konservatore dhe me problematika të tranzicionit. Gjatë këtyre viteve është vënë re një bashkëpunim më i fortë midis OJF-ve dhe shtetit si në lidhje me punën për zbatimin e SKBGJ-DHF 2007-2010, për miratimin dhe zbatimin e shumë ligjeve të rëndësishme, si LBGJSH, apo për përmirësimet e LDHF, në tetor 2010. Një bashkëpunim i mirë është vënë re edhe për përfshirjen e kuotave gjinore në Kodin Elektorale dhe miratimin e LMD.

Në Shqipëri janë të regjistruara 614 shoqata,¹⁷ nga të cilat 112 ose 18.24% janë të drejtuara nga gratë. Kjo do të thotë se në këtë sektor gruaja gjen më shumë hapësirë dhe liri për një angazhim aktiv në dobi të çështjeve të grave dhe fëmijëve në veçanti dhe të komunitetit në tërësi. Siç tregojnë vrojtimitet, organizatat dhe grupet e interesit që punojnë në fushën e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave formojnë një grup të rëndësishëm të shoqërisë civile. Ato janë krijuar fill pas organizatave të para për të drejtat e njeriut në fillim të viteve '90, gjë

¹⁷ Të dhëna nga MPCSSHB në SKBGJ-DHF 2007-2010.

që përshtatej me nevojat për adresimin e të drejtave të grave dhe pabarazive gjinore në kushtet e një shoqërie patriarkale.¹⁸

Shoqatat e grave realizuan dhe vazhdojnë të realizojnë një sërë aktivitete lidhur me të drejtat e grave e fëmijëve, përkujdesjen sociale e shëndetësore, zhvillimin ekonomik (kryesisht të biznesit të vogël për gratë dhe vajzat), luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, etj. Që prej vitit 2000, ka nisur dhe është konsoliduar gjithnjë e më shumë një lëvizje kombëtare për fuqizimin politik të gruas, e cila arriti të ketë impakt në klimën politike dhe sociale në vend, në favor të balancës gjinore. Ndikimi progresiv i medias që filloi të ketë në fokus problemet e barazisë gjinore, veçanërisht të pjesëmarrjes së gruas në politikë, kulmoi në fushatën zgjedhore të vitit 2009, me disa programe e debate në mediat kryesore në vend.

Një element i rëndësishëm në rritjen e efektivitetit të punës së OJF-ve të grave është përmirësimi i organizimit të tyre. Pas vitit 1997, vërehet një bashkëveprim më i mirë mes tyre; filloi organizimi në rrjete e koalicione, me programe e aktivitete të përbashkëta. Për to mbetet sfida sigurimi i fondeve të mjaftueshme për të vazhduar dhe konsoliduar punën për çështjen e barazisë gjinore apo mbulimin e nevojave të ndryshme për shërbime sociale për gratë. Vrojtimet dhe analizat tregojnë se pjesa më e madhe e financimeve kanë qenë për periudha të shkurtra, një vit ose më pak dhe se shumica e tyre vijnë nga donatorë të huaj.¹⁹ Në këto kushte, hapja e një linje të posaçme buxhetore nga Këshilli i Ministrave në tetor 2007 “Për mbështetjen e shoqërisë civile” dhe miratimi më pas i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë për mbështetjen e shoqërisë civile” (mars 2009), bartin një potencial të rëndësishëm për mbështetjen e lëvizjes për barazi gjinore në Shqipëri, i cili merret parasysh nga kjo Strategji.

Sfida. Mbetet ende sfida zbatimi rigoroz i Kodit Elektorale në të gjitha nivelet si dhe zbatimi i kuotave siç parashikohet në LBGJSH për të adresuar përfaqësimin e ulët të vajzave dhe grave në pozicione të tjera drejtuese dhe profesionale në të gjitha organet e administratës publike,

¹⁸ Civicus, IDM dhe UNDP Albania, Indeksi i shoqërisë civile për Shqipërinë. Në kërkim të qytetarëve dhe impaktit, 2010.

¹⁹ Po aty

përfshirë përfaqësimin e grave në efektivat e policisë dhe forcat e armatosura. Zbatimi i Kodit dhe masave të veçanta duhen shoqëruar nga sesione informimi dhe trainimi për stereotipet gjinore, barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin. Rritja e pjesëmarrjes së grave në vendim-marrje duhet të shoqërohet me përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues, garantimit të burimeve të vijuara financiare, edhe ngritjes dhe forcimit të kapaciteteve. Trajnimi dhe informimi në masë të gjerë i vajzave dhe grave dhe aftësimi i tyre për pjesëmarrje aktive në jetën politike, si udhëheqje, menaxhim fushatash, përfaqësime në organizime publike (konferenca, biseda) dhe pjesëmarrjen e tyre në votime mbeten ndërhyrje të rekomandueshme për të rritur pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe publike.

Situata Ekonomike, Formimi Profesional dhe Pjesëmarrja në Forcat e Punës

Të drejtat ekonomike të grave përfaqësohen me nivelin e pjesëmarrjes në forcat e punës, mbajtjen e vendit të punës dhe shpërblimin. Punësimi te gratë shqiptare kushtëzohet nga një sërë faktorësh, si detyrimi dhe përgjegjësia për rritjen e fëmijëve, kryerjen e punëve të shtëpisë, niveli arsimor, aksesit i kufizuar në formimin profesional, pronësia dhe mundësia për të përfituar kredi, etj.

Baza ligjore dhe institucionale për punësim dhe formim profesional. Nxitja e punësimit dhe formimi profesional rregullohen nëpërmjet Ligjit Nr. 7995 datë 20.09.1995 “Për nxitjen e Punësimit” dhe Ligjit 8872 datë 29.03.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”. Në nivel qendror është MPCSSHB harton politika në fushën e punësimit dhe formimit profesional. Këtë ministria e realizon nëpërmjet Drejtorisë së Politikave të Punësimit. Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) - krijuar në vitin 1988 - është një shërbim publik autonom, me statusin e një administrate shtetërore qendrore, që përgjigjet para Ministrisë. Organi më i lartë vendim-marrës i tij është Këshilli Administrativ Tripalësh me 13 anëtarë që kryesohet nga Ministri, dy anëtarë të këtij këshilli janë femra. Pranë Zyrave të Punësimit funksionojnë këshillat konsultative trepalëshe, të cilët zhvillojnë konsultime për qëndrueshmërinë e politikave, programeve dhe projekteve të punësimit. Partnerët socialë marrin

pjesë në Këshillat Administrative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Në mbështetje të ligjit Nr. 8872, datë 29.03.2002 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, që në nëntor të vitit 2003, është krijuar Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional. Disa projekt-amendamente të këtij ligji, janë kaluar tashmë në Këshillin e Ministrave dhe pritet t’i dërgohen Kuvendit për miratim. Këto ndryshime parashikojnë mbështetjen që Qeveria do t’u japë bizneseve që bashkëpunojnë dhe mbështesin zhvillimin e arsimit dhe formimit profesional në vend, synojnë të rregullojnë më me hollësi organizimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar dhe krijojnë edhe Agjencinë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional si një institucion që ofron shërbime si në fushën e arsimit dhe të formimit profesional.

Në kuadrin e zbatimit të SKBGJ-DHF 2007-2010, janë bërë propozime gjatë procesit të hartimit të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” lidhur me grupet në risk duke përfshirë këtu mbrojtjen e veçantë për gratë shtatzëna, gratë që sapo kanë lindur dhe nënat me fëmijë në gji në përputhje me direktivën nr.92/85/KE. Në këtë ligj janë marrë në konsideratë propozimet e bëra nga MPÇSSHB dhe UN Women. Gjithashtu Drejtoria Juridike në MPÇSSHB, në konsultim me UN Women ka bërë disa propozime pranë grupit të punës që ka punuar për rishikimin e Kodit të Punës, lidhur me futjen e dispozitave ligjore për njohjen e lejes së paslindjes për baballarët; zgjerimin e konceptit të shqetësimit seksual në vendin e punës; propozime për orarin fleksibël për punonjësit me përgjegjësi familjare etj. Kjo fazë e procesit për rishikimin e Kodit të Punës nën një këndvështrim gjinor ka përfunduar tashmë dhe pritet fillimi i procesit për miratimin e këtyre ndryshimeve të propozuara.

Me mbështetjen e UN Women janë bërë rekomandime për ndërhyrje në Ligjin Nr. 9355 “Për ndihmën ekonomike”. Këto ndërhyrje parashikojnë që tashmë të përfitojnë nga ndihma ekonomike edhe viktimat e trafikimit, familjet me kryefamiljare gra, gratë në proces zgjidhje martesë, por që nuk e kanë marrë akoma vendimin e gjykatës për këtë, gratë viktimat të dhunës në familje dhe familjet në

gjakmarrje. Pra numri i kategorive përfituese të Ndhmës Ekonomike jo vetëm që është rritur, por njëkohësisht i kushton një vëmendje të veçantë mundësisë së grave për të përfituar direkt nga ndihma. Këto ndryshime janë kaluar në Këshillin e Ministrave dhe priten që të dërgohen së shpejti për miratim në Kuvendin e Shqipërisë.

Punësimi. Pjesëmarrja e gruas në tregun e punës ka ardhur duke u ulur. Shkalla e pjesëmarrjes së grave në forcat e punës në vitin 2009 ishte 51.8%, krahasuar me 56.2% në 2007. Gratë në Shqipëri kanë më pak akses se burrat për të filluar një punë, për pasojë niveli i papunësisë tek ato është më i lartë. Shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç për vitin 2009 ishte 53.4%. Ky tregues ishte 64.3% për meshkujt dhe 43.6% për femrat. Niveli i punësimit për gratë ka pësuar rënie nga 2007 kur ka qenë 49.3%²⁰.

Shkalla e papunësisë tek gratë në vitin 2009 ishte 15.9%, në krahasim me 12.2% për meshkujt në të njëjtin vit, ndërsa në vitin 2007, papunësia e grave ishte 12.2%. Treguesit e papunësisë afatgjatë (sipas përkufizimit standard, të papunë afatgjatë janë personat e papunë prej një periudhe prej një viti ose më shumë) tregojnë se gratë kanë më shumë gjasa të qëndrojnë të papuna për një kohë të gjatë se burrat. Dallimi mes tyre është i ndjeshëm, respektivisht 10.6% me 7.8%. Ky hendek është thelluar në vite. Nga viti 2007, papunësia afatgjatë për gratë dhe vajzat ka pësuar një rritje: nga 8.8% në 10.6%. Gjithashtu, në mes të papunëve të dekurajuar, gratë zënë rreth 74.3%²¹, që do të thotë këto gra dhe vajza nuk kërkojnë më të hyjnë në tregun e punës. Shpesh dekurajimi vjen nga mungesa e shërbimeve sociale të kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit.

Edhe punësimi sipas sektorëve paraqet dallime në indekset gjinore. Në sektorin shtetëror ka 54.6% meshkuj dhe 45.4% femra të punësuar, në sektorin privat ka 72.2% meshkuj dhe 27.8% femra dhe në sektorin bujqësor ka 43.8% meshkuj dhe 56.2% femra²². Të dhënat e të punësuarve në sektorin shtetëror tregojnë se gratë zënë përqindjen më

²⁰ INSTAT, Rezultate nga Anketa e Forcave të Punës, 2009,

<http://www.instat.gov.al/graphics/doc/downloads/lfs/Rezultate%20AFP%202009.pdf>

²¹ Po aty

²² Po aty

të lartë të punësimit në profesione të tilla si specialiste apo nëpunëse të thjeshta, pozicione këto më pak të paguara, krahasuar me profesione të tilla si ligjvënës, nëpunës dhe drejtues të lartë, politikëbërës, në të cilat shihen kryesisht burrat si të punësuar. Duke bërë një krahasim të punësimit në dy nivelet, në atë qendror dhe vendor, të dhënat tregojnë se femrat zënë një përqindje më të madhe të punësimit në nivel qendror. Kështu në institucionet e qeverisjes qendrore, 45% e të punësuarve janë femra, ndërsa në administratën vendore kjo shifër rezulton në 31%.

Shifrat e ulëta të punësimit të grave nuk tregojnë realitetin në lidhje me angazhimin e tyre në punë, pasi në këto shifra nuk pasqyrohet roli riprodhues social që ato luajnë në familje, duke filluar nga mirëmbajtja e shtëpisë, gatimi, kujdesi për fëmijët dhe familjarët, aktivitete këto të domosdoshme për vazhdimësinë e jetës dhe që cilësohen si punë e papaguar. Po kështu, edhe pse mund të kenë të njëjtin nivel arsimit apo kualifikimi sikurse dhe burrat, te gratë vihet re një vështirësi për mbajtjen e vendit të punës, apo dhe diferencim në shpërblim, për shkak të posteve të punës që ato kanë. Gratë janë më të rrezikuara për largimin nga puna, apo janë më pak të pëlqyera për t'u punësuar e për t'u ruajtur vendin e punës, veçanërisht në periudhën e shtatzënisë. Në nivelin e ulët të shpërblimit të grave ndikon edhe pjesëmarrja e ulët e tyre në aktivitete private vetëpunësimi, të cilat sigurojnë të ardhura më të larta se sektori publik. Aksesi i ulët ndaj pronës (vetëm 8% e grave zotërojnë ligjërisht pronë²³), si dhe mungesa e politikave favorizuese që nxisin sipërmarrjen private të grave, ka çuar në një nivel të ulët të numrit të atyre që drejtojnë biznese të vogla, të mesme apo të mëdha. Në vitin 2005 vetëm 17% e bizneseve jo bujqësore drejtoheshin nga gra; në vitin 2010 ka një rritje të vogël prej 1% (18%).²⁴ Sigurimi i mundësive të barabarta për punësim të shpërblyer ndikon pozitivisht në nxjerrjen e familjes nga varfëria dhe në rritjen e statusit social të grave dhe vajzave brenda familjes. Nga një analizë e faktorëve që ndikojnë në madhësinë e

²³ Amnesty International: "Albania. Violence against women in the family. It is not her shame"; 2005

²⁴ Albania Country Gender Profile 2010, JICA

shpërblimit, si grup-mosha, niveli i shkollimit dhe gjinia, kjo e fundit rezulton se ndikon më fuqimisht. Gratë janë ndjeshëm më të defavorizuara nga burrat, me një mesatare të pagës prej 35% më të ulët për të njëjtin nivel arsimor²⁵. Një analizë më e detajuar sipas degëve të ekonomisë tregon se paga mesatare mujore neto e burrave është²⁶ dukshëm më e lartë se ajo e grave në të gjitha degët e ekonomisë dhe diferenca është më e theksuar për të punësuarit me pagë në sektorin privat jo-bujqësor.

Sipërmarrjet private. Gratë kanë ngritur bizneset e tyre kryesisht në aktivitete ekonomike të tilla si tregti, shitje me shumicë, dyqane, shërbime të ndryshme si dentist, noteri, avokati, parukeri, agro-biznes, industri, prodhimin e bulmetit, tekstil, botime librash, rrobaqepësi dhe punime artizanale. Sipas statistikave të INSTAT, 18% e drejtuesve të biznesit privat janë gra. Numri më i madh i bizneseve të regjistruara që drejtohen nga gratë është përqendruar në Tiranë (31%), dhe Elbasan (30%). Janë mbështetur nisma për ngritjen e programeve të kreditimit me qëllim nxitjen e biznesit të grave nëpërmjet zbatimit të programeve si ai për Fondin e Garantimit të Kredive për Eksport. Megjithëse rreth 70% e grave që jetojnë në zona rurale punojnë në bujqësi, por vetëm 6% e fermave janë në pronësi apo të menaxhuara prej tyre. Gratë në zonat rurale kanë shumë vështirësi në gjetjen e mundësive të punësimit, kështu që shumica e tyre merret kryesisht me punë në bujqësi. Fermat nuk kanë mundësi prodhimi apo shitjeje dhe marrin shumë pak kujdes dhe mbështetje nga qeveria.

Varfëria. Në një vend si Shqipëria, kultura diskriminuese me bazë gjinore nuk është thjesht një çështje e shkeljes së të drejtave të grave e vajzave, por pabarazia gjinore përfaqëson një pengesë serioze në përshpejtimin e reduktimit të varfërisë. Tradicionalisht, edhe pse gratë mbajnë peshën kryesore të mirëqenies në familje, ato kanë më pak mundësi se burrat në kontrollin e burimeve dhe mjeteve që nevojiten për të përmbushur përgjegjësitë e mësipërme. Niveli i lartë i papunësisë, niveli arsimor i ulët, kryerja e shumë punëve të pakualifikuara, mungesa e mundësive kualifikuese, aksesit i dobët dhe

²⁵ Në përlogaritjet nuk janë peshuar grup-moshat.

²⁶ INSTAT- LSMS 2005

mungesa e lirisë së përdorimit të metodave të planifikimit familjar, të qenit objekt i dhunës, keqtrajttimeve apo veprimeve arbitrare brenda familjes, si dhe përfaqësimi i ulët në strukturat publike drejtuese e politike, ndikojnë në thellimin dhe feminizimin e varfërisë në Shqipëri, në përzgjatjen e saj, sikurse dhe në përfshirjen në të, të më shumë fëmijëve.

Drejtuesimi mes detyrimeve profesionale dhe atyre familjare.

Studime të kryera nga organizata të ndryshme jo-fitimprurëse si dhe disa anketime të kryera nga INSTAT si Anketa Demografike e Shëndetit apo Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës²⁷ tregojnë se puna dhe përkujdesja për familjen mbeten ekskluzivisht përgjegjësi e grave, se ka mangësi në shërbimet sociale (kryesisht të kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit), se tregu informal i punës e shton angazhimin e gruas në kujdesin ndaj familjes. Pjesëmarrja e gruas në vendimmarrjen brenda familjes ndikohet edhe nga aksesit i dobët ndaj informacionit dhe njohurive. Gjithashtu aksesit ndaj informacionit ndikohet negativisht edhe nga bërja e një jete sociale të izoluar.²⁸ INSTAT, me mbështetjen e SIDA-s dhe UNFPA-së (në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje), po realizon Vrojtimin Kombëtar për Përdorimin e Kohës, i cili do të japë të dhëna të vlefshme lidhur me punën e papaguar të grave dhe burrave në familje dhe roleve gjinore në vendimmarrjen brenda saj. Rezultatet e vrotimit priten të dalin brenda vitit 2011.

Programet e nxitjes së punësimit. Për të adresuar pjesëmarrjen e ulët të grave në tregun e punës, në tre vjetët e shkuar, janë zbatuar programe të nxitjes së punësimit, apo në lidhje me formimin profesional nga të cilat kanë përfituar një numër i konsiderueshëm vajzash dhe grash përfshirë dhe ato të kategorive në nevojë. Kështu, gjatë vitit 2008, nga punëkërkesit e papunë që morën pjesë në programet e nxitjes së punësimit 82% ishin femra, ndërsa nga grupet

²⁷ ASC, "Përkujdesja si punë e papaguar-pesha e padukshme që mbartin gratë, 2008, Tiranë

²⁸ ASC, Përkujdesja si punë e papaguar-pesha e padukshme që mbartin gratë, 2008, Tiranë

e veçanta ishin 67% (rome, jetime, të divorcuara, mosha mbi 50 vjeç.) Pranë qendrave publike të formimit profesional u çertifikuan 7,577 persona nga të cilët 58% ishin gra dhe vajza të trainuara. Gjatë vitit 2009 nga punëkërkuesit e papunë që morën pjesë në programet e nxitjes së punësimit 60% ishin femra. Prane qendrave publike të formimit profesional u trainuan 7,751 persona në total nga të cilët 50% ishin femra. Gjatë vitit 2010 u përfshinë në programet e nxitjes së punësimit 1,757 punëkërkues të papunë nga të cilët 70% ishin punëkërkuese femra. Pranë qendrave publike të formimit profesional u trainuan 8,485 persona nga të cilët femrat përbënin 53% të totalit. Pjesëmarrja e femrave ka qenë në nivele të larta në të gjitha programet: në programet e formimit nëpërmjet punës femrat janë deri në moshën 35 vjeç dhe të përfaqësuara kryesisht në aktivitete të tilla si konfeksione (veshje dhe këpucë); në programet e subvencionit të punësimit për pjesën e sigurimeve shoqërore janë mbi moshën 35 vjeç (kryesisht në aktivitete si përpunim peshku dhe kultivim fidanesh).

Ligji për Nxitjen e Punësimit parashikon mbështetjen e punëdhënësve që krijojnë vende të lira pune dhe punësojnë kandidatë të ofruar nga Zyrat e Punësimit. Në mbështetje të këtij ligji, aplikohen pesë programet e nxitjes së punësimit: (1) programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë; (2) programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë nëpërmjet formimit në punë; (3) programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit institucional; (4) programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë femra; (5) programi i nxitjes së punësimit për studentët që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit²⁹.

Sfida. Ngushtimi i hendekut të papunësisë dhe rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës mbetet një sfidë e qenësishme. Studime të gjithanshme që tregojnë vendin që zënë gratë në tregun e punës, sfidat që ato ndeshin përfshirë diferencimet në paga krahasuar me burrat, kontributin e tyre në Prodhimin Bruto Vendas dhe përdorimin e kohës janë të rëndësishme për hartimin e politikave që nxisin pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.

²⁹ Burimi: MPCSSHB

Që të zhvillohen politika të përshtatshme për të nxitur fuqizimin ekonomik të grave, është e rëndësishme të përcaktohet se ç' do të thotë fuqizim ekonomik dhe të njihet lidhja e tij me atë lloj modeli të zhvillimit ekonomik, i cili tregon kujdesin e duhur ndaj qytetareve. Fuqizimi ekonomik i gruas mund të rezultojë në fuqizimin shoqëror, politik dhe kulturor dhe anashjelltas. Arsimi, si ai i përgjithshëm dhe profesional, ashtu sikurse dhe aksesin e përmirësuar në shërbimet sociale bazë janë para-kushte për rritje të mundësive për punësim dhe rrjedhimisht për fuqizimin ekonomik të grave.

Rritja e pjesëmarrjes së gruas në tregun e punës dhe promovimi i sipërmarrjes ekonomike nga ana e saj është e një rëndësie të madhe duke patur parasysh diferencimet në punësimin e grave dhe vajzave dhe shkallën e papunësisë në Shqipëri, por nuk është e mjaftueshme. Është po aq e rëndësishme të adresohet e drejta për punë dinjitoze në përputhje me standartet e punës. Por është edhe më e rëndësishme të promovohen politika dhe programe që njohin vlerën e kontributit të gruas në shoqëri nëpërmjet punës së tyre të paguar dhe të papaguar.

Ndërsa gratë duhet të kenë akses të barabartë në mikrofinancë, është thelbësore që të njihet fakti që mikrofinanca shumë shpesh fokusohet te gratë, ndërkohë që investimet synojnë fusha që janë të dominuara nga burrat dhe sjellin përfitime të pabarabarta për gratë dhe burrat. Krijimi i shërbimeve të përshtatshme për të siguruar akses të barabartë të grave në kredi dhe shërbime bankare, adresimi i dallimeve të mëdha në pronësi të aseteve materiale nga burrat dhe gratë (p.sh., toka dhe shtëpi), janë disa drejtime ku duhet punuar. Qeveria, në bashkëpunim me OJF-të dhe sektorin privat do të angazhohet për nxitur krijimin e kushteve të tilla të tregut që mund të ndihmojnë gratë të përdorin në maksimum potencialin e tyre. Një gjë e tillë duhet të përfshijë si gratë në zonat urbane dhe ato në zonat rurale dhe në veçanti të lidhë gratë rurale si prodhuese me tregjet urbane. Vëmendje specifike meritojnë gratë kryefamiljare dhe gratë e grupeve në nevojë (gratë me aftësi të kufizuara, gratë Rome, etj.). Forma inovatore si kooperativat e grave (sipërmarrje sociale) në zonat urbane dhe ato rurale kanë potencialin të ndryshojnë disekuilibrin mes punës së paguar dhe asaj të papaguar

të grave.³⁰ Investimet duhet të marrin në konsideratë çështjet gjinore dhe t'i përgjigjen në mënyrë të drejtë nevojave të burrave dhe grave (si në infrastrukturë dhe në investime që përqendrohen në krijimin e mundësive të reja, të barabarta për punë).

Rishikimi i legjislacionit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të krijuar hapësira për përfitim nga gratë në zonat rurale dhe ato që humbën vendet e punës si pasojë e ndryshimit të sistemit në fillim të viteve 90 është domosdoshmëri. Edhe zgjerimi i rrjetit të shërbimit të punësimit dhe formimit profesional për gratë në nevojë, përfshirë gratë të reja, kryefamiljare dhe ato me aftësi të kufizuara do të krijojë një tablo të re ekonomike.

Zhvillimi i kapaciteteve, trajnimi dhe ri-trajnimi, njësoj i aksesueshëm nga gratë dhe burrat ka munguar. Rritja e shanseve të riaftësimit për punë, në praktikë do të thotë që nënat e reja të kenë akses në shërbime të përballueshme financiarisht të kujdesit për fëmijët— kjo është e rëndësishme pasi i lejon ato të marrin pjesë në trainim dhe të punojnë. Masat aktive për tregun e punës duhet të jenë të ndjeshme nga perspektiva gjinore dhe të marrin në konsideratë nevojat specifike të grave, veçanërisht të grave të reja me familje. Çështja e ndarjes horizontale dhe vertikale në punë duhet adresuar duke krijuar hapësira punësimi për gratë në fusha të dominuara nga burrat (dhe anasjelltas), duke siguruar në të njëjtën kohë mundësi të barabarta për gratë dhe burrat për rritje në karrierë dhe akses në pozicione drejtuese.

Për më tej, duhen adresuar çështje që lidhen me sigurinë në punë, diskriminimin në punë, ngacmimin e vazhdueshëm e sistematik të një individi nga kolegët apo drejtuesit, shqetësimin seksual në vendin e punës, si edhe masa për të adresuar drejtpeshimin midis detyrimeve profesionale dhe atyre familjare. Mbrojtja në punë, si një fushë që kërkon përmirësim të qenësishëm, kërkon forcimin e rolit të Inspektoriatit të Punës për të trajtuar çështjet që lidhen me barazinë gjinore në punë dhe respektimin e kushteve të punës që garantojnë

³⁰ Kjo në praktikë do të thotë që disa nga aktivitetet që gratë kryejnë si punë të papaguar, si kujdes për fëmijët, për të moshuarit dhe për personat me aftësi të kufizuara duhet të njihen si të rëndësishme në nivel komunitar dhe kontributi i grave për këtë punë të rëndësishme të mund të rimbursohet.

pacënueshmërinë e integritetit individual. Pjesëmarrja jo-proporcionale e grave në ekonominë informale, përfshirë dhe punën në kushte të vështira dhe të pambrojtura, duhet të adresohen nga Inspektorati i Punës dhe organet e sigurimeve shoqërore.

Arsimi

Arsimi është fusha në të cilën ka patur arritje të mira në drejtim të aksesit për femrat dhe meshkujt. Në vitin 2010 mbaruan arsimin 9-vjecar dhe moren dëftesë lirimi 52029 nxënës, nga të cilët 49% vajza dhe 51% djem. Në arsimin e mesëm vazhdon të mbetet më i lartë numri i femrave (53.8%) kundrejt meshkujve që përbëjnë 46.2%.

Në arsimin e mesëm profesional meshkujt mbizotërojnë me 69% të të rregjistruarve.

Në arsimin jo publik femrat përbëjnë 48.5%. Femrat në arsimin e lartë përbëjnë 55.1% të numrit të përgjithshëm të studentëve të rregjistruar si në arsimin publik dhe atë privat dhe 56.6% të studentëve të rregjistruar në arsimin e lartë publik (viti akademik 2009-2010).

Në fakultete të ndryshme, raporti femra - meshkuj është i ndryshëm. Nëse studiojmë strukturën sipas 8 fushave të gjëra të studimit në arsimin me kohë të plotë, vihet re që femrat janë më të prirura të vazhdojnë studimet në shkencat shoqërore. Këtu femrat përbëjnë 73% të studentëve të fushës së arsimit, 68% të fushës së shëndetësisë dhe 61% të shkencave humanitare dhe arteve. Meshkujt zënë pjesën më të madhe të studentëve në fushën e inxhinierisë, ku përbëjnë 70% si dhe shkencave natyrore, duke ndryshuar përparësitë nga viti paraardhës ku një nga fushat ku merrnin pjesë më shumë ishte edhe bujqësia. Në vitin 2008, të diplomuarat në arsimin e lartë me kohë të plotë përbënin 67%.³¹

Femrat përbëjnë 78% të studentëve të fushës së arsimit, 71% të fushës së shëndetësisë, 65% të shkencave humanitare dhe arteve, 60% të fushës së shkencave natyrore dhe 55% të fushës së shkencave sociale, biznes dhe drejtësi. Meshkujt vazhdojnë të zënë pjesën më të madhe të studentëve në fushën e inxhinierisë, ku përbëjnë 74%, në fushën e bujqësi-veterinarisë, ku përbëjnë 66%, dhe në fushën e shërbimeve, ku

³¹ INSTAT, Femra dhe Meshkuj, 2009

përbëjnë 63%. Në vitin akademik 2009-2010, në arsimin e lartë me kohë të plotë, femra janë 66% e të diplomuarve në ciklin I (DNP), 59% në ciklin II (DND+DIND). Në Master profesional janë diplomuar 1501 femra, ose 77% e numrit të përgjithshëm, ndërsa në Master të nivelit II janë diplomuar 243 femra, ose 64% e numrit të përgjithshëm.

Në sistemin parauniversitar (parashkollor, nëntëvjeçar dhe të mesëm), përfaqësimi i grave është i konsiderueshëm. Mësueset femra përfaqësojnë 68% të stafit mësimdhënës në arsimin 9-vjeçar, ndërsa kjo përqindje në arsimin privat është 61%. Në arsimin e mesëm publik dhe privat femrat mësuese përbëjnë 62% të stafit. Në arsimin e lartë publik, përqindja e femrave në stafin efektiv mësimdhënës rritet nga viti në vit duke zënë 50.4%, në krahasim me 47.2% që ka qenë më parë. Në arsimin e lartë privat femrat pedagoge me dhe pa tituj përbëjnë 27.4% të stafit mësimdhënës.

Në arsimin e lartë publik e privat, me titullin “Profesor i Asociuar” ka 145 femra dhe 309 meshkuj, me titullin “Profesor” ka vetëm 141 femra dhe 398 meshkuj.

Po ndërsa regjistrimi i vajzave në shkolla është në nivele të konsiderueshme, dukuritë gjinore si braktisja konkrete apo braktisja e fshehtë e shkollës janë të pranishme. Ndërkohë studime të tjera nga organizatat joqeveritare, ndonëse jo kombëtare, por të përqendruara në rajone të caktuara, evidentojnë shifra më problematike.³² Infrastruktura ose e shkatërruar ose jo-ekzistente që çon në pasigurinë e udhëtimit, mungesa e mjediseve sanitare të sigurta (tualetet) dhe mungesa e ujit të pijshëm, janë disa nga faktorët që i detyrojnë vajzat të braktisin shkollën, apo prindërit që t’i largojnë vajzat nga shkolla. Nuk ka studime të mirëfillta që tregojnë arritjet e vajzave në aftësitë bazë të shkrimit dhe leximit, apo dhe më gjerë, por raportet e organizatave jo-fitimprurëse dhe atyre komunitare tregojnë se numri i vajzave që rrezikohen nga analfabetizmi është i lartë. nga ish-

³² Një studim i Organizatës Ndërkombëtare për Solidaritet, mbështetur nga Qeveria Spanjolle raporton shifra deri në 15% të braktisjes së shkollës pas përfundimit të ciklit të ulët në qarkun e Tiranës dhe Shkodrës. Të dhënat e studimit janë bërë publike në shtypin e përditshëm në nëntor 2008.
<http://ëëë.shekulli.com.al/neës/194/ARTICLE/36699/2008-11-26.html>

Agjencia Kombëtare e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve (AVA), sot Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), në përfundim të provimeve të lirimit dhe të provimeve të maturës shtetërore, për çdo vit shkollor hartohen dhe botohen: “Raporti i rezultateve të provimeve të lirimit” dhe “Raporti i rezultateve të provimeve të maturës shtetërore”. Nga të dhënat nga Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës (2008) vihet re se për grupmoshën nën 54 vjeç, shkalla e analfabetizmit është përgjithësisht më e lartë tek meshkujt sesa te femrat. Nga ana tjetër, vihet re me shqetësim që me uljen e moshës vihet re një rritje e shkallës së analfabetizmit. Kështu ndërkohë që për grupmoshat 45-54 shkalla e analfabetizmit qendron në shifrat 1% dhe 0.5% për meshkujt dhe femrat përkatësisht, për grupmoshën 15-24 vjeç shifrat shkojnë në 1.8% dhe 1% përkatësisht, ndërkohë që për grupmoshën 25-34 këto shifra paraqiten akoma dhe më të larta.³³ Një sfidë reale për ndjekjen e shkollës janë kostot “joformale” për arsimim, të cilat u japin familjeve të varfëra një ngarkesë financiare që mund të lidhet me mos shkuarjen në shkollë të fëmijëve sidomos në zonat rurale dhe më të varfëra të vendit. Për më tepër, realiteti shoqëror dhe kulturor mbështet konkluzionin se vajzat më shpesh dhe më shpejt se djemtë braktisin shkollën për të kontribuar në ekonominë familjare, apo për t’u martuar në moshë tepër të re.

Në kuadër të zbatimit të strategjisë 2007-2010, arsimit publik ka arritur të shënojë hapa drejt institucionalizimit të barazisë gjinore: është rishikuar Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar nga këndvështrimi gjinor (IZHA, 2008), janë përpunuar Standardet e Mësuesit nga këndvështrimi gjinor (IZHA, 2008), është shpallur kriteri i barazisë gjinore si një nga kriteret e përzgjedhjes së teksteve shkollore (Altertekst, MASH, 2008). Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar dhe Standardet e Mësuesit ndërthurin angazhime të edukimit për barazinë gjinore me elemente të tjera kurrikulare, duke mundësuar përdorimin e metodologjive interaktive në mësimdhënie. Në sistemin e trajnimit në punë të mësuesve të arsimit fillor, nëntëvjeçar dhe të mesëm është ndërhyrë me manuale mbi barazinë

³³ INSTAT, Statistikat socio-demografike në Shqipëri – tematika të përzgjedhura dhe zhvillime të mëtejshme. 2010

gjinore për mësuesit dhe nxënësit dhe janë zhvilluar trajnime respektive për përdorimin e tyre. Edhe universitetet publike ku përgatiten mësues kanë luajtur rolin e tyre. Kontributi i OJF-ve si bashkëpunëtorë në këtë sektor është i ndjeshëm.³⁴

Ndërhyrjet për përfshirjen e dimensionit gjinor në arsim forcojnë potencialin bashkëpunues të strukturave brenda sistemit të arsimit. Studimet, trajnimet dhe rishikimet e kurrikulës janë kryer nga aktorë të brendshëm të sistemit të arsimit parauniversitar dhe universitar, të mbështetur nga donatorë strategjikë. Për ndërhyrjet në kurrikula dhe në kriteret e miratimit të teksteve shkollorë, MASH, Instituti i Kurrikulës dhe Trajnimeve (sot Instituti i Zhvillimit të Arsimit) dhe Bordi i Miratimit të Teksteve (sot Komisioni i Miratimit të Teksteve) punoi i asistuar nga UNDP dhe SIDA. Në universitetet publike, kryesisht në programet e përgatitjes së mësuesve, psikologëve shkollorë, sociologëve e punonjësve socialë, studimet dhe analizat gjinore, reflektimet dhe ndërhyrjet në kurrikulat universitare janë kryer në bashkëpunim me burime të brendshme dhe donatorë ndërkombëtarë. Çelja e programit “Master në Studime Gjinore” në UT u asistua nga UNDP dhe ekspertiza e huaj. Në të gjitha universitetet publike ku përgatiten mësues ka patur inpute dhe *follow-up* për çështjet gjinore përmes rrjetit të trajnerëve gjinorë dhe qendrave të edukimit qytetar demokratik pranë tyre. Në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe profesional, po krijohen modele të replikueshme të angazhimit të arsimit profesional në çështje të barazisë gjinore. Të dhënat e studimeve kanë nxitur produkte të reja kurrikulare në shkollë.³⁵

Sot ka një kornizë kurrikulare të arsimit parauniversitar të ndjeshme në aspektin gjinor, miratimi i teksteve të arsimit parauniversitar bëhet edhe mbi kriteret e barazisë gjinore, kurrikula e trajnimit të mësuesve në punë është e vëmendshme drejt aspektit gjinor, ka një masë kritike përvojash të angazhimit të arsimit të mesëm profesional në çështje të edukimit me barazinë gjinore. Në universitetet publike të vendit (Universitetet e Tiranës, Elbasanit, Gjirokastrës, Korçës, Durrësit dhe

³⁴ Draft Raporti i vlerësimit të SKBGJ-DHF, Objektivi i arsimit, 27.12.2011

³⁵ Ibid.

Shkodrës) janë bërë rishikime të kurrikulave të përgatitjes fillestare të mësuesve. Në këto universitete, kryesisht në degët e Shkencave Sociale dhe Mësuesisë zhvillohen lëndë dhe module të veçanta për barazinë gjinore. Në Universitetin e Tiranës dhe Elbasanit, ka programe të veçanta studimi të përgatitjes së punonjësve gjinorë në nivelin “Bachelor” dhe “Master”. Sot ka angazhime të universiteteve publike në drejtim të studimit të çështjeve të barazisë gjinore dhe dhunës në familje. Në programet e përgatitjes së mësuesve, punonjësve socialë, sociologëve dhe psikologëve janë shtuar kërkimet sasimore dhe cilësore për çështje të përkatësisë, identitetit, stereotipave dhe barazisë gjinore. Edhe në sektorin privat të arsimit të lartë po përfshihen lëndë të studimeve gjinore në kurrikula.³⁶

Në sistemin, parashkollor, nëntëvjeçar dhe të mesëm, përfaqësimi i grave është i konsiderueshëm. Mësueset femra përfaqësojnë 69% të stafit mësimdhënës në arsimin 9 vjeçar publik, ndërsa kjo%je në arsimin privat rreth 81%. Në arsimin e mesëm si publik dhe atë privat, femrat mësuese përbëjnë 60% të stafit. Në arsimin e lartë publik,%ja e femrave në stafin efektiv mësimdhënës rritet nga viti në vit duke zënë 47,2%. Por këtu duhet të përmendim se gratë dhe vajzat zënë një%je të konsiderueshme në nivel pedagogu, ku kemi respektivisht 925 gra dhe 729 burra. Ndërkohë, duke filluar dhe ngjitur gradat, vërehet se kjo tendencë ndryshon menjëherë. Me titullin Profesor i Asociuar ka 105 gra dhe 237 burra, me titullin Profesor ka vetëm 61 gra dhe 281 burra. Në pozicionet drejtuese në arsimin e lartë publik ka 10 rektorë burra dhe asnjë grua, ka 10 zv/rektorë burra dhe 3 gra, janë 29 dekanë burra dhe 11 gra dhe 105 përgjegjës departamentesh burra dhe 47 gra.

Sfidat. Megjithë arritjet, mbetet sfida përfaqësimi i ulët i grave në pozicione drejtuese administrative në arsim; aplikimi i masave të veçanta për të nxitur prurjet e vajzave në arsimin e mesëm profesional; bërja e politikave të përfshirjes së vajzave me aftësi të kufizuara, vajzave të zonave të largëta rurale, të komuniteteve të veçanta gjuhësore dhe etnike, kryesisht Rome; përgatitja e mësuesve, ekspertëve gjinorë në fushën e arsimit, punonjësve socialë, psikologëve dhe sociologëve për të adresuar nevojat e veçanta të

³⁶ Draft Raporti i vlerësimit të SKBGJ-DHF, Objektivi i arsimit, 27.12.2011

vajzave dhe djemve në arsimim; si dhe zvogëlimin e stereotipisë gjinore nëpërmjet procesit arsimor.

Mbrojtja Sociale

Reformat politike dhe ekonomike të viteve '90-të u shoqëruan me rritje të numrit të personave të ekspozuar ndaj varfërisë dhe përjashtimit social. Për zbutjen e tyre është ndërtuar një sistem i posaçëm i mbrojtjes sociale, i bazuar në programet e (1) sigurimeve shoqërore, (2) ndihmës ekonomike, (3) mbështetjes me të ardhura të personave me aftësi të kufizuar, dhe (4) shërbimeve shoqërore. Vlerësimi i vulnerabilitetit dhe problemeve sociale të individëve (grave dhe burrave) shpesh nënkupton përkufizimin e shkallës së përjashtimit të tyre social nga jeta normale e shoqërisë, mungesën e politikave dhe masave për mbrojtjen e të drejtave të tyre, si dhe mungesën e mundësisë për t'i përdorur shërbimet që ekzistojnë në komunitetin e tyre. Renditja e vulnerabilitetit i ka përkufizuar gratë e papuna si një nga grupet kryesore në rrezik dhe me probleme sociale. Papunësia ndër gratë e bën të vështirë për to të shkëputen nga një partner i dhunshëm dhe është konsideruar si faktori kryesor që çon në dukuri të tjera si divorci. Vitet e fundit është rritur numri i grave kryefamiljare, kryesisht nga divorci (ku shkalla e divorcit në 2009 është 17 për 100 martesë në krahasim me 9 për 100 në 2001.³⁷) Gratë kryefamiljare përfitojnë ndihmë ekonomike apo pensione familjare, kur bashkëshorti ka qenë i punësuar, si dhe ndihma humanitare dhe shërbime punësimi nga OJF-të. Në fund të Dhjetorit 2010 numri i grave të papuna ishte 72,857; trajtoheshin me pagesë papunësie 4,692 gra. Numri i familjeve me kryefamiljare gra që marrin ndihmë ekonomike ishte 5,666, ndërsa numri i familjeve me kryefamiljare gra që marrin përfitime të veçanta nga pushteti vendor përveç ndihmës ekonomike ishte 556.

Shërbimet shoqërore për gratë janë ngritur në bazë të parimit se shteti i mirëqenies sociale siguron mbrojtjen sociale përmes përmirësimit të plotësimit të nevojave njerëzore për arsimim, shëndetësi, strehim dhe siguri sociale. Ato kanë synuar ruajtjen, rehabilitimin dhe zhvillimin e

³⁷ Faqja e Internetit INSTAT

mundësive individuale të grave, kryesisht të nënave me shumë fëmijë, nënave rrome dhe egjiptjane, nënave/familjeve me fëmijë jetimë, jetimëve pas moshës 18 vjeç, etj. Kjo ndihmë këto vite është siguruar përmes dy mekanizmave kryesorë: transfertave cash në formën e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve publike apo private për gratë në nevojë.

Ndërkohë që transfertat kesh për sigurimin shoqëror jepen në formën e pensioneve familjare për personat në varësi të titullarit të sigurimit, programi i ndihmës ekonomike siguron mbrojtje sociale për familjet e varfra. Nëpërmjet këtij programi garantohet mbështetje financiare minimale për plotësimin e nevojave më elementare të jetesës për familjet pa të ardhura ose me të ardhura nën nivelin e përcaktuar si “vija zyrtare e varfërisë”. Prioritet në përfitim të ndihmës ekonomike dhe përfitimeve të tjera të përkohshme sociale janë familjet me kryefamiljare gra, nënat me shumë fëmijë dhe familjet që kanë në përbërje fëmijë jetimë apo të lindur jashtë martesë (nëna vajza).

Prioritizimi i nevojave të grave si gra me shumë fëmijë, apo të papuna, apo të moshuara, etj. ekziston në disa bashki e komuna, por nuk shoqërohet me politika mbështetëse për to. Shërbime të specializuara sociale për gratë në rrezik dhe në nevojë shpeshherë jepen në qendra kombëtare shërbimesh, gjë që e bën të vështirë aksesin në to. Tabloja sociale e grave të moshuara dhe atyre me paaftësi është thuajse e munguar. Gjendja e tyre ekonomike, shërbimet për jetesë normale, për burime ushqimi dhe mjekimi janë të paevidentuara. Politikat lokale dhe shërbimet e ardhura nga OJQ të ndryshme tipikisht për gratë e moshuara dhe ato me paaftësi janë sporadike.

Edhe mbështetja sociale e grave në karrierë përmes politikave favorizuese institucionale për të lehtësuar punën e tyre me fëmijët dhe familjarët, është një gjë ende e heshtur. Gratë në karrierë e gjejnë veten tejet të rënduar, gjë që ul ritmet e rritjes së tyre profesionale. Shërbimet sociale synojnë grupet vulnerabil dhe jo aq mirëqenien sociale të grupeve të tjera.³⁸

³⁸ Draft Raporti i vlerësimit të SKBGJ-DHF, Objektivi i Mbrojtjes Sociale, 27.12.2011

Me mbështetjen e UNIFEM ³⁹(tashmë UN Women) janë bërë rekomandime për ndërhyrje në Ligjin 9355 *Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore*. Këto ndërhyrje parashikojnë që tashmë të përfitojnë nga ndihma ekonomike (NE) edhe viktimat e trafikut, familjet me nëna kryefamiljare dhe viktimat e dhunës në familje. Pra NE nuk do të jepet me vetëm për familjet, por edhe për individët. ⁴⁰ Ndryshimet e propozuara në këtë projektligj u miratuan në mbledhjen e qeverisë më datë 26 janar 2011. Ndërmjet të tjerave projektligji parashikon si kategori të re përfituesish të NE, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe jetimët që nuk janë në institucione. Projektligji ka parashikuar edhe mbështetjen e atyre familjeve ku bashkëshortët janë në proces zgjidhje martesë, duke u garantuar mbështetje me ndihme ekonomike. Deri tani këto raste nuk mbështeteshin nga ky program. Numri i rasteve, sipas një vrojtimi është 500 në vit. Me këtë përmirësim, do të ketë dy masa të llogaritjes së ndihmës ekonomike, pasi të dy bashkëshortët do të marrin rolin e kryefamiljarit. Në masën që do të përfitojë secili do të llogariten edhe personat që ata kanë praktikisht në ngarkim. ⁴¹

Sfida. Sfidë mbetet kombinimi i dhënies së ndihmës sociale dhe ekonomike me shërbime konkrete si punësimi, trainimi, trajtimi mjekësor, mbështetja për personat me aftësi të kufizuar me qëllim që gratë në skemat e përfutimit të shërbimeve të kenë mundësi të dalin nga këto skema. Mbeten ende të paadresuara nevojat e grave të moshës së tretë (të papuna që në fillim të viteve 1990) për të cilat nuk ka shërbime konkrete mbështetëse.

Kujdesi Shëndetësor dhe Shërbimet Shëndetësore

Për Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) mbrojtja e shëndetit të gruas përbën një prioritet. Për këtë arsye, politikat dhe strategjitë e saj, të mbështetura dhe nga UNFPA si një nga donatorët kryesorë në këtë fushë, e vendosin gruan në qendër të shërbimeve të shëndetit riprodhues duke synuar të integrojnë këto shërbime në tre nivelet e

³⁹ ACER & ASET. 2008. Perceptimi publik në lidhje me pjesëmarrjen e grave në zgjedhje në Shqipëri, mbështetur nga UNIFEM. Tiranë

⁴⁰ Grupi Teknik për Sigurinë Ekonomike të Grave.

⁴¹ Faqja e internetit e MPÇSSH.

kujdesit shëndetësor, me prioritet kujdesin shëndetësor parësor. Përmirësimi i vazhdueshëm i shëndetit si për gratë ashtu edhe për burrat mbetet një sfidë e madhe. Marrja e një kujdesi shëndetësor cilësor është faktor kyç për mirëqenien, zhvillimin dhe ecurinë e përgjithshme të të gjithë shoqërisë.

Përgjithësisht, theksi i trajtimit të dallimeve dhe çështjeve gjinore vihet në dallimet biologjike, që ekzistojnë ndërmjet burrave dhe grave. Por nga ana tjetër është shumë e rëndësishme të kuptohet se në jetën e përditshme gratë dhe burrat kryejnë veprimtari të ndryshme, janë pjesë e realiteteve jetësore të ndryshme si dhe kanë nevoja dhe ushtrojnë përgjegjësi të ndryshme nga njëri-tjetri. Duke e analizuar në kontekstin e kujdesit shëndetësor, gratë dhe burrat për shkaqet e sipërpërmendura janë të ekspozuar në mënyra të ndryshme ndaj ndërlikimeve shëndetësore. Kjo lidhet jo vetëm me specifika të sëmundjeve dhe ndërlikimeve shëndetësore që janë të ndryshme për të dyja gjinitë, por edhe me hapësirat sociale, ekonomike, kulturore, madje dhe politike, që ndikojnë në mënyra të ndryshme në shëndetin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave. Është e rëndësishme të theksohet se cilësia e jetesës së individëve duhet parë jo vetëm në perspektivën e ndryshimeve biologjike, por edhe të roleve të ndryshme të pritura nga shoqëria për ta. Nga ana tjetër këto pabarazi ndërthuren dhe me efektet e formave të tjera të ndarjes sociale si klasa, etnia apo vendndodhja. Duke patur parasysh këtë mund të themi se ka një dallim të ndjeshëm në faktin se si gratë dhe burrat e grupeve të ndryshme sociale ndikohen nga çështjet e kujdesit shëndetësor. Koncepti i barazisë gjinore në sektorin e shëndetësisë ka të bëjë më tepër me drejtësinë në trajtimin shëndetësor të të gjithë individëve, sesa me trajtimin e barabartë. Duke patur në fokus drejtësinë e shpërndarjes dhe të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, është e mundur shmangia dhe zhdukja e disavantazhit në kujdesin shëndetësor të grave dhe burrave. Në 20 vitet e fundit shëndetësia është ndeshur me sfidat për të dhënë shërbime të përshtatshme për meshkujt dhe femrat.

Studime të fundit të kryera në Shqipëri hedhin dritë mbi disa nga sfidat specifike që ndeshin burrat dhe gratë në marrjen e shërbimit shëndetësor.⁴²

Shëndeti riprodhues dhe planifikimi familjar. Shërbimet bazë të planifikimit familjar u futën në vendin tonë në vitin 1992, pas një vendimi të Këshillit të Ministrave që e konfirmoi planifikimin familjar si një të drejtë njerëzore bazë. Që nga janari 1993, me urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë kontrceptivët shpërndahen falas në të gjitha shërbimet shëndetësore shtetërore dhe marketingu social i kontrceptivëve zbatohet në të gjithë vendin. Aktualisht, kontrceptivët ofrohen nga tre sektorë: sektori publik (falas), programet e marketingut social (me çmime të subvencionuara), si dhe sektori tregtar fitimprurës (me çmime tregu). Sektori publik ofron falas pilula, prezervativë mashkullorë dhe injeksione në mbi 431 pika shëndetësore – maternitete, poliklinika, qendra shëndetësore dhe në disa ambulanca fshati – si dhe lidhjen e tubave (sterilizimin femëror) dhe Dispozitivin Intrauterin (DIU) në qendra me obstetër dhe gjinekologë të specializuar. Sistemi Kombëtar i Informacionit të Menaxhimit Logjistik grumbullon statistika për shërbimet si dhe informacion logjistik mbi kontrceptivët, të cilat i japin mundësi Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) që të përlogarisë kërkesat kombëtare për kontrceptivë dhe të monitorojë mbarëvajtjen e programit kombëtar të planifikimit familjar.

MSH është në pararojë të përpjekjeve që po bëhen për forcimin e sigurisë së kontrceptivëve për të siguruar një furnizim afatgjatë për të gjithë shqiptarët që kanë nevojë për to. Si pjesë e këtyre përpjekjeve, në vitin 2003, MSH miratoi strategjinë kombëtare për sigurinë e kontrceptivëve. Në zbatim të kësaj strategjie, MSH ka bërë rregullimet e nevojshme të politikave të planifikimit familjar dhe buxheteve për të arritur sigurimin e kontrceptivëve. Kjo është bërë duke rritur në mënyrë graduale kontributin e saj financiar për prokurimin e kontrceptivëve për sektorin publik. Pjesa e kontrceptivëve e siguruar nga UNFPA, i vetmi donator i

⁴² Këto të dhëna i referohen Anketës demografike dhe shëndetësore 2008-2009 të kryer nga INSTAT dhe Instituti i Shëndetit Publik

kontraktivëve për sektorin publik, është ulur në përpjestim me këtë rol. Në vitin 2009, MSH mbulonte 80% të kostove të prokurimit të kontraktivëve për sektorin publik.

Njohuritë e planifikimit familjar janë pothuajse gjithëpërfshirëse në Shqipëri, ku 99% e femrave dhe pothuajse 100% e meshkujve të moshës 15-49 vjeç dinë së paku një metodë të planifikimit familjar. Në një vërtetim mbi planifikimin familjar, gratë e martuara raportuan se njohin 6 metoda kontraktive dhe burrat e martuar raportuan se dinë 4 metoda të planifikimit familjar. 91% e grave të martuara deklarojnë se kanë përdorur ndonjëherë një metodë të planifikimit familjar dhe vetëm 33% deklarojnë se kanë përdorur një metodë moderne të planifikimit familjar. 69% e grave të martuara raportuan se ato aktualisht janë duke përdorur një metodë të planifikimit familjar: 11% janë duke përdorur metoda moderne të planifikimit familjar dhe 59% janë duke përdorur metoda tradicionale. Deri tani, mënyra më e zakonshme, që përdoret aktualisht në gratë e martuara është tërheqja (58 %), ndjekur nga prezervativi mashkullor (4 %), sterilizimi femëror (3%) dhe pilula (2%). Gratë në zonat urbane kanë më shumë të ngjarë të përdorin metoda të planifikimit familjar, se sa gratë në zonat rurale (74% dhe 66%, përkatësisht), ato kanë gjithashtu më shumë gjasa të përdorin metoda moderne të planifikimit familjar (12% dhe 10%, përkatësisht).

Përdorimi metodave të planifikimit familjar rritet në përpjestim të drejtë me nivelin e arsimit – një përqindje më e madhe e grave të arsimuara me universitet përdorin metoda moderne (18%) krahasuar me ato me arsim të mesëm, profesional ose teknik (12%), ose arsim 8-vjeçar (9%).

Si rezultat i aktiviteteve të parashikuara nga SKBGJ-DHF 2007-2010, MSH hartoi dhe miratoi një Strategji për Shëndetin Riprodhues 2009-2015 dhe një Plan Veprimi që e shoqeron atë, të cilët adresojnë çështjet më prioritare të kujdesit shëndetësor për burrat dhe gratë, duke u kushtuar vëmendje të veçantë ndryshimeve biologjike dhe gjinore mes tyre. Sfidë për SKBGJ-DHBGJ 2011-2015 është koordinimi me strukturat e shëndetësisë për të siguruar zbatimin e saj, dhe raportimin e arritjeve dhe sfidave të asaj Strategjie edhe të

MPÇSSHB, si autoriteti me përgjegjësinë kryesore për koordinimin e ndërhyrjeve në fushën e barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore.

Kujdesi para dhe pas lindjes. Në Shqipëri, kujdesi para dhe pas lindjes janë pjesë përbërëse e sistemit të kujdesit shëndetësor parësor, që është i organizuar në nivel prefekturë dhe rrethi. Gratë shqiptare mund ta përfitojnë lirisht kujdesin para dhe pas lindjes. Në qytete, kujdesi para dhe pas lindjes ofrohet nga konsultoret e grave dhe qendrat e grave në maternitete. Në fshatra, një kujdes i tillë ofrohet nga mjekët e familjes (mjekë të përgjithshëm) dhe infermiere/mami në qendrat shëndetësore. Sipas inventarit vjetor të Sektorit të Statistikave Shëndetësore në Ministrinë e Shëndetësisë ekzistojnë 108 konsultore grash në qytete dhe 582 qendra shëndetësore në fshatra.

Shqipëria ka një sistem të mirë shëndetësor, të zhvilluar, me një infrastrukturë të gjerë të institucioneve që ofrojnë shërbime të kujdesit të nënës. Në përgjithësi, nivelet e kujdesit para lindjes dhe ndihma e ofruar janë në nivele të larta. Pothuajse të gjitha gratë shtatzëna (97%) në Shqipëri kanë marrë kujdesin para lindjes nga një ofrues i kualifikuar, të paktën një herë gjatë shtatzënisë. Gjashtëdhjetë e shtatë përqind e grave kishin një numër të rekomanduar të vizitave ANC (kujdes para lindjes) (4 ose më shumë) gjatë shtatzënisë. Përqindja e grave që kishin katër ose më shumë vizita ANC është shumë më e ulët në zonat rurale krahasuar me ato urbane (57% krahasuar me 82%). Thuajse të gjitha femrat në Shqipëri me një lindje të gjallë në pesë vitet përpara ADHS 2008- 09 kanë marrë kujdes para lindjes (97%) dhe ndihmë gjatë lindjes (99%) nga një profesionist shëndetësor dhe 83% e këtyre femrave morën kujdes pas lindjes brenda dy ditësh nga lindja.

Kujdesi në lindje. Sipas statistikave të MSH⁴³, 93% e lindjeve kryhen në institucione shëndetësore, ndërsa 7% kryhen në shtëpi. Por edhe nga këto lindje që kryhen në shtëpi, 6.2% kryhen me ndihmën e personelit shëndetësor. Tetëdhjetë e gjashtë përqind e lindjeve që kryhen në një strukturë shëndetësore janë ndjekur nga një obstetër/gjinekolog dhe 14 përqind janë ndjekur nga një infermiere

⁴³ <http://www.moh.gov.al/faqet/reproductivehealth/S/Situationanalysisinthereproductivehealthsector.pdf>

apo mami. Përqindja e lindjeve të kryera me *sectio-cesarea* është rritur nga 13% në vitin 2002, në 19%⁴⁴.

Vdekshmëria feminare. Për pesë vitet e fundit, shkalla e vdekshmërisë për fëmijët nën pesë vjeç është 22 vdekje për 1,000 lindje dhe e vdekshmërisë foshnjore është 18 vdekje për 1,000 lindje. Të dhënat nga ADHS 2008-09 tregojnë se ka pasur një rënie të vdekshmërisë së fëmijëve, gjatë pesë viteve të fundit para studimit. Për shembull, vdekshmëria foshnjore ka rënë nga 26 vdekje për 1,000 lindje të gjalla për periudhën 1992-2002 në 18 vdekje për 1,000 lindje të gjalla për periudhën 2005-2009. Po kështu, një rënie e ngjashme raportohet dhe për vdekshmërinë nën pesë vjeç, nga 32 në 22 vdekje për 1,000 lindje. Studimi nxjerr në pah se nivelet e vdekshmërisë foshnjore ishin më të larta në zonat rurale (24 për 1,000 lindje) se sa në ato urbane (12 për 1,000 lindje). Nivelet e vdekshmërisë foshnjore janë më të larta ndër fëmijët e grave të varfra (24 për 1,000 lindje) sesa në fëmijët e grave që janë në indeksin më të lartë të gjendjes ekonomike (17 për 1,000 lindje).

HIV/AIDS. Niveli i ulët aktual i infeksionit HIV në Shqipëri ofron mundësinë për ndërhyrje të hershme dhe për parandalimin e përhapjes së mëtejshme të sëmundjes. Shumica e rasteve me HIV në Shqipëri kanë qenë diagnostikuar midis grave dhe burrave në grupmoshën 25-44 vjeç. Megjithatë që nga viti 2000, një përqindje në rritje e grave janë infektuar me HIV/AIDS.

Problemet lidhur me marrjen e kujdesit shëndetësor. Pothuajse nëntë në dhjetë femra (87%) të moshës 15-49 vjeç dhe katër në pesë meshkuj (80%) të moshës 15-49 vjeç raportojnë të paktën një problem në marrjen e kujdesit shëndetësor. Problemet më të zakonshme të raportuara nga gratë dhe burrat lidhen me marrjen e parave nën dorë nga ana e personelit shëndetësor (56 dhe 62%, përkatësisht), shqetësimin se nuk ka furnizim ose pajisje në dispozicion (63 dhe 55%, përkatësisht), shqetësimi se nuk ka medikamente në dispozicion (54 dhe 52%, përkatësisht), shqetësimi dhe se nuk ka staf shëndetësor në dispozicion (50 dhe 45%, përkatësisht). Nga vëzhgimet në terren

⁴⁴ Albanian Demographic Health Survey 2008-09

është evidentuar që shumë aparatura si për shembull mamografët, janë të ndërtuar në mënyrë të tillë që nuk mund të aksesohen nga gratë me aftësi të kufizuara që përdorin karriget me rrota.

Vendim-marrja për kujdesin shëndetësor. Dy në tre gra (66%) raportojnë se i marrin vendimet së bashku me burrin ose partnerin në lidhje me kujdesin e tyre shëndetësor dhe 61% marrin së bashku vendime mbi blerjet e rëndësishme të familjes. Pesëdhjetë e shtatë përqind e grave të martuara thonë se ato marrin kryesisht vendime në lidhje me blerjet e përditshme në familje, ndërsa 63% vendosin së bashku me burrin e tyre lidhur me vizitat te familjarët apo të afërmit.

Sigurimet Shëndetësore. Sipas Anketës Demografike dhe Shëndetësore 2009, tre në katër femra dhe meshkuj (79% dhe 71%, përkatësisht) nuk mbulohen nga asnjë lloj sigurimi shëndetësor. Pesëmbëdhjetë përqind e meshkujve dhe 21% e femrave mbulohen nga sigurimet shëndetësore shtetërore, ndërsa më shumë se një në dhjetë femra (11%) dhe meshkuj (13%) mbulohen nga sigurimet shoqërore shtetërore. Tre përqind e femrave dhe 5% e meshkujve kanë sigurime shëndetësore vullnetare, si shtesë, dhe vetëm 2% e femrave dhe meshkujve janë të mbuluar nga sigurime shoqërore private. Femrat dhe meshkujt më të moshuar kanë më shumë gjasa të jenë të mbuluar nga sigurimet shëndetësore sesa ata në moshë më të re. Një e treta e të intervistuarve që jetojnë në zona urbane dhe ata që jetojnë në Tiranën urbane janë të mbuluar nga sigurimet shëndetësore, në krahasim me 11% të femrave dhe 21% e meshkujve që jetojnë në zonat rurale, dhe 17% e femrave dhe 26% e meshkujve në zonat malore. Punësimi i paguar i femrave është i lidhur ngushtë me mundësinë për të pasur sigurime shëndetësore, ndërsa për meshkujt, kjo lidhje nuk është aq e fortë.

Sfida. Disa nga sfidat që ndeshen kanë të bëjnë me faktin që reformat në sektorin e kujdesit shëndetësor ende janë në proces. Skema e sigurimeve shëndetësore duhet të rishikohet për vaksimim falas të grave kundër HPV dhe të sinkronizohet më mirë me shërbimet mjekësore. Mjetet informuese për mënyrën se si funksionojnë shërbimet mjekësore publike dhe krijimin e kulturës së ruajtjes së shëndetit duhet të jenë të disponueshme. Duhet përmirësuar edukimi

seksual i djemve dhe vajzave adoleshente; duhen intensifikuar përpjekjet për parandalimin e shtatëzanive të padëshiruara të hershme, kontrollit për parandalimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS. Përpos këtyre, në nivelin e politikave duhet të rriten kapacitetet për përdorimin e të dhënave statistikore për politikë-bërësit dhe vendimmarrësit.

Media

Situata aktuale në media është vështirë të jepet e plotë pasi studimet më të fundit janë para vitit 2007 kur nisi punën SKBGJ-DHF 2007-2010. Nga këto të dhëna, media shqiptare pasqyron fare pak ose aspak problemet që shqetësojnë gruan shqiptare, të tilla si mundësia për arsimim, punësim, problemet e dhunës në familje, shqetësimeve seksuale, edhe kur këto dukuri bëhen pjesë e debatit publik. Karakterizimi i figurës së femrës shpesh shoqërohet me leksik joetik, fyes dhe denigrues. Ndodh që publikimi i ngjarjeve reale bëhet nën dritën e paragjykimit dhe ngjarjet pasqyrohen nën ndikimin e stereotipave negativë. Figura e femrës, në më të shumtën e rasteve, paraqitet në pozicionin e viktimës ose të objektit të tërheqjes seksuale dhe rrallë ndodh që ajo të paraqitet si një individ që kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, jo vetëm për hir të perqindjes që zë në raport me popullsinë, por veçanërisht për vlerat që ajo mbart. Stereotipet tradicionale për gruan, aplikohen dukshëm në media, ku figura e kësaj pjese të shoqërisë paraqitet si e varur ekonomikisht dhe emocionalisht, e dobët, e pazonja profesionalisht, nga njëra anë dhe nga ana tjetër, shtëpiake e përkushtuar, familjare, nënë e bashkëshorte e denjë. Vihet re një tendencë e medias që, kur nevojitet përdorimi i burimeve apo prononcimeve dhe opinioneve të figurave të fushave të ndryshme, iu referohet meshkujve, veçanërisht në fushën e politikës, ekonomisë, sportit, etj. Dhe zëri i gruas profesioniste zë fare pak vend dhe citohet shumë rrallë nga media.

Pasqyrimi i roleve gjinore. Nga monitorimi i katër organeve me tirazh më të lartë të medias së shkruar në periudhën janar-mars 2009⁴⁵ vihet

⁴⁵ Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim, Trajtimi i problematikave sociale në media – perspektivë gjinore. 2009

re se 140 shkrime u janë kushtuar problemeve që lidhen me gruan, nga të cilat 95 i përkisnin gruas në vendimmarje dhe politikë dhe 45 të tjera punësimit dhe diskriminimit në vendin e punës. Gjithashtu u vu re se gjatë periudhës së vëzhguar, pati një tendencë në rritje të paraqitjes së problemeve të gruas në media, duke arritur në 87 artikuj në muajin mars. Kjo ndoshta lidhet edhe me aktivitetet e shtuara të organizatave jofitimprurëse në periudhën parazgjedhore, të cilat në bashkëpunim me Kombet e Bashkuara dhe donatorë të tjerë, intensifikuan përpjekjet për rritjen e pjesëmarrjes së gruas në zgjedhje, qoftë si kandidatë, qoftë si votuese. Trajnimet e shumta të gazetarëve në fushën e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje, në zbatim të SKBGJ-DHF (2007-2010) duket se kanë patur ndikimin e tyre pozitiv në faktin se nga monitorimi i medias së shkruar në tremujorin e parë të vitit 2009 u vu re që media arrin të pasqyrojë që gruaja ka potencial dhe ekspertizë të mjaftueshme që mundëson përfshirjen e saj në proceset vendimmarrëse e politikëbërëse, që është e aftë të sigurojë dhe përhapë informacion të saktë dhe koherent dhe që gruaja e përfaqësuar ushtron presion mbi klasën politike dhe qeverisjes, duke i bërë publike problemet. Por prapëseprapë, pavarësisht zhvillimeve pozitive, ende nëpër media mbeten dominuese gjuha seksiste, stereotipat gjinorë dhe paragjykimet mbi gruan.

Raporti gazetarë/gazetare në media. Problematike për median shqiptare mbetet jo vetëm pasqyrimi në të i realitetit maskilist të shoqërisë dhe i deformimit të roleve gjinore, por edhe fakti që realiteti shqiptar gjen pasqyrim në vetë strukturën e ndërtimit dhe funksionimit të medias. Kështu, ende raporti gazetar/gazetare është dukshëm në favor të të parëve dhe sa më lart të ngjitesh në hierarkinë e drejtimit të medias aq më i madh është ky raport. Nga një sondazh i raportuar nga Tamo dhe Karaj i vitit 2006, i cili u referua në SKBGJ-DHF (2007-2010) rezultonte se, raporti gazetarë/gazetarë socialë është 55% /45%; kulturë-sport 45% /55%; politike 35% /65%; ekonomi 40% /60%, analistë 8% /92% në favor të meshkujve. Në total, %ja e femrave që punojnë si gazetare në median e shkruar është rreth 40%, ndërsa në median vizive ato përfaqësojnë 60% si prezantuese, 68% si reportere. Gazetaret femra ngarkohen të trajtojnë tema sociale, për mjedisin, edukimin dhe kohët e fundit, kanë filluar të ndryshojnë raportet në

favor të tyre edhe në fushën politike, por ky raport gjithsesi vazhdon të ketë vlera të ulëta kur flitet për fushën ndërkombëtare ose analizën politike, të cilat vazhdojnë të mbeten pronë e meshkujve. Monitorimi i medias në 2009 nga Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim vuri në dukje se nga 140 artikujt e monitoruar 17 ishin shkruar nga femra, 40 nga meshkuj, ndërsa pjesa tjetër nuk mund të identifikoheshin për shkak se ose kishin përdorur iniciale, ose nuk kishin fare emër. Megjithëse, në fakultetet e gazetarisë trajtohen tashmë tema të ndryshme që lidhen me barazinë gjinore, monitorimi i vitit 2009 tregoi se vetëm në 29% të rasteve gratë ishin intervistuar; në shkrimet e tjera ishin përmendur si pjesë përbërëse e lajmit ose ishin përmendur nga të tretë, duke dëshmuar kështu për lënien në hije të fjalës së gruas.⁴⁶ Nga ky monitorim shihet se axhenda e lajmeve është e dominuar nga procesi zgjedhor, drejtësia, politika dhe integrimi, çështje “të forta” që zënë 79.2% të lajmeve, përkundrajt 20.8% që zënë çështjet që konsiderohen “të buta” ose më pak të rëndësishme për t’u pasqyruar në media, siç janë: çështjet sociale, arsimi, shëndetësia, etj.

Një tjetër problem shqetësues që shfaq tregu mediatik shqiptar është puna e zezë e gazetarëve. Shumica e tyre punojnë pa kontrata pune dhe janë të pasiguruar. Sipas një studimi të MPCSSH (2003): 75% e gazetarëve nuk kanë kontrata pune; ndërsa në prill të vitit 2006 Sindikata e Gazetarëve të Shqipërisë deklaronte se ky numër arrin në 90%. Gazetarët e terrenit rezultojnë më të diskriminuarit dhe të pambrojturit dhe është e kuptueshme se ata që nuk arrijnë të mbrojnë dhe të përfaqësojnë të drejtat e tyre, nuk do të jenë në gjendje të pasqyrojnë dhe të mbrojnë sa duhet të drejtat dhe interesat e një shoqërie apo grupi të caktuar shoqëror. Studime të mëvonshme për pasqyrimin e kësaj situate nuk ka.

Sfida. Duke patur parasysh që media duhet të jetë një partner në të gjitha angazhimet e qeverisë në lidhje me barazinë gjinore, rekomandohet që veprimet të ndikojnë në përmirësimin e marrëdhënieve midis institucioneve zbatuese të strategjisë dhe mediave. Këto lidhen me bashkëpunim më të mirë midis tyre për shpërndarjen e informacionit, programacion ndërgjegjësues dhe

⁴⁶ Po aty

informues mbi çështjet gjinore dhe kuadrin ligjor përkatës nëpërmjet futjes së njoftimeve mbi shërbimet publike. Rishikimi i Ligjit të Medias nën perspektivën gjinore, krijimi i politikave editoriale me këndvështrim gjinor nga vetë mediat dhe trainimi i vazhdueshëm i gazetarëve mbi barazinë gjinore do të mundësonte trajtim më të mirë të çështjeve gjinore dhe zbatueshmërisë së ndërhyrjeve strategjike në sektorë të tjerë të mbuluar nga qeveria.

Dhuna në Familje

Sipas legjislacionit shqiptar “Dhunë në familje” është çdo veprim apo mosveprim i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik. Dhuna në familje është krim që shpesh është i fshehur.

Në vitin 2009, INSTAT së bashku me UNDP dhe UNICEF ndërморën një vërtetim kombëtar mbi dhunën në familje⁴⁷. Ky ishte vërtetimi i parë kombëtar, i cili ofroi shifra të plota e të detajuara mbi dhunën në familje. Ai tregoi se nga 2590 gra të intervistuar, të paktën 56% pohuan se kishin pësuar një nga format e dhunës në familje. Lidhur me faktorët e riskut, vërtetimi nxori në pah se gratë të cilat nuk punonin jashtë shtetësisë kishin dukshëm shumë më tepër mundësi të përjetonin abuzim emocional sesa gratë të cilat punonin jashtë shtetësisë në kohën e vërtetimit (82,5% kundrejt 74,3%); gratë me arsim universitar (46,0%) kishin më pak gjasa të përjetonin abuzim psikologjik krahasuar me gratë me arsim të mesëm (56,2%), me arsim nëntëvjeçar (56,9%), me arsim fillor (62,5%) dhe me ato të paarsimuara (66,7%). Po ashtu gratë me arsim universitar kishin shumë më pak gjasa të keqtrajtoheshin fizikisht apo të abuzoheshin emocionalisht nga bashkëshorti/partneri i tyre krahasuar me gratë me një nivel më të ulët arsimor. Gratë me arsim fillor (70,4%) ishin ato që raportuan më së shumti dhunën fizike të ushtruar ndaj tyre nga bashkëshorti/partneri i tyre. Gratë në zonat rurale, dëshmonin më shumë për dhunën emocionale dhe fizike, sesa gratë që jetonin në qytet.

⁴⁷ INSTAT, 2009. « Dhuna në familje në Shqipëri – Vërtetim kombëtar »

Është e dokumentuar më së miri se gratë e dhunuara nuk përjetojnë vetëm një formë të dhunës në familje, – emocionale, psikologjike, fizike ose seksuale – por shpeshherë ato përjetojnë njëherazi forma të shumëfishta të dhunës. Gratë e abuzuara emocionalisht shpeshherë përjetojnë edhe abuzim psikologjik, gratë e abuzuara emocionalisht dhe/ose psikologjikisht shpeshherë janë të dhunuara edhe fizikisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim. Në lidhjet abuzive, gratë e dhunuara seksualisht shpeshherë janë të dhunuara edhe fizikisht, si edhe të abuzuara emocionalisht dhe psikologjikisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim.⁴⁸ Abuzimi emocional është një parashikues i llojeve të tjera të abuzimit dhe dhunës në martesën ose lidhjen intime. 82% deri në 88% e grave të cilat kishin përjetuar dhunën në familje raportuan se dhuna – emocionale, psikologjike, fizike dhe/ose seksuale – kishte filluar brenda tre viteve të para të martesës ose të bashkëjetesës me bashkëshortin ose partnerin intim. Nga gratë që raportuan paaftësi për të punuar për shkak të prerjeve, mavijosjeve dhe dhembjeve, 81,6% kishin vuajtur paaftësi të përkohshme për punë për një deri në katër ditë.

Gratë e dhunuara nuk kërkojnë ndihmë nga organe të specializuara. 90,7% kanë kërkuar ndihmë nga familja e tyre, 34,0% kanë kërkuar ndihmë nga familja e bashkëshortit/ partnerit të tyre dhe 13,9% kanë kërkuar ndihmë nga të afërm të tjerë. Pra, nga ky vrojtim vihet re ende një hezitim i grave për ta ngritur problemin e tyre përtej rrethit familjar. Dhuna në familje ndaj grave nuk ndodh gjithmonë nga bashkëshortët/partnerët aktualë ose të mëparshëm. Anëtarë të tjerë të familjes (p.sh., prindërit, vëllezërit, motrat, krushqit dhe të afërm të tjerë) kryejnë akte të dhunës fizike ndaj grave. Edhe pse shpeshherë dhuna pakësohet me zgjidhjen e martesës, 60% deri në 67% e grave të divorcuara ose të ndara, raportuan se aktualisht ato përjetonin një nga format e abuzimit emocional, krahasuar me 85% deri në 96% të grave të martuara ose të atyre që jetonin me një partner intim.

⁴⁸ 60,6% e grave të abuzuara emocionalisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim ishin gjithashtu të abuzuara edhe psikologjikisht. Veç kësaj, 44,9% e grave të abuzuara emocionalisht ishin të dhunuara edhe fizikisht. 15% ishin të dhunuara edhe seksualisht nga bashkëshorti/partneri i tyre intim.

Shpesh dhuna ndaj grave dhe ajo ndaj fëmijëve bashkëjetojnë në familje. Fëmijët janë viktimat e harruara të dhunës në familje. Në vërtetim u konstatua se prej 146 fëmijëve që kishin qenë të pranishëm në akte dhune në familje, vetëm 23,6% i kanë thënë dikujt për këtë dhunë. Nga i njëjti vërtetim raportohet se nga 991 fëmijët e anketuar, 57,7% raportuan se ishin rrahur fizikisht nga një anëtar i familjes. Fëmijët në zonat rurale (66,4%) kishin më shumë gjasa që të goditeshin me shuplakë, me grusht ose me shkelm nga një anëtar i familjes krahasuar me fëmijët në zonat urbane (50,4%). Në dhunën e ushtruar ndaj fëmijëve u vunë re edhe dallime gjinore. Kështu, djemtë kishin më shumë gjasa se vajzat të përjetonin dhunë fizike në familje. Në përputhje me konkluzionet e literaturës botërore se gratë e dhunuara kanë më shumë gjasa të dhunojnë fëmijët e tyre sesa gratë që nuk përjetojnë dhunë, vërtetimi vuri në dukje se dhuna ndaj fëmijëve ushtrohej kryesisht nga nëna (ose njerka), e pasuar nga babai (ose njerku) dhe vëllezërit e motrat. Kjo e dhënë mund të flasë gjithashtu edhe për normën stereotipe dominuese në shoqërinë shqiptare ku kujdesi dhe edukimi i fëmijës shihen kryesisht si punë të nënës dhe gruas. Gjithashtu, vihet re se baballarët dhunojnë më shumë djemtë e tyre sesa vajzat, ndërsa nënat dhunojnë më shumë vajzat, sesa djemtë, gjë që mund të jetë një tregues i ndarjeve gjinore të roleve të prindërve në “disiplinimin” e bijve apo bijave të tyre.

Nje fakt tjetër me rëndësi që u evidentua nga vërtetimi kombëtar i dhunës ishte lidhja mes nivelit arsimor të bashkeshortit me dhunën ndaj gruas. Grate të cilat raportojnë se nuk dhunoheshin emocionalisht, psikologjikisht, fizikisht apo seksualisht nga bashkeshorti, me se shumti raportojnë edhe se bashkeshorti i tyre ishte me arsim të lartë.

Fatkeqësisht, në Shqipëri nuk ekzistojnë ende studime që mund të japin një tablo të qartë në lidhje me dhunën kundër djemve dhe burrave. Studime në vende të tjera si dhe vëzhgimet sporadike nga media në Shqipëri tregojnë që stereotipikisht: (1) Burrat zakonisht trajtohen sikur e kanë të trashëguar në lindje agresivitetin dhe dhunën; atyre nuk u lejohej të jenë elastikë, por të përshtaten me përcaktimin e të qenit “mashkull”. Nëse ata nuk i përshtaten këtij përcaktimi ata etiketohen si “të dobët”, apo “gra”; (2) Dhuna ndaj burrave pranohet

po aq lehtë ose edhe më lehtë se dhuna ndaj grave. Megjithë ndërgjegjësimin në rritje të shoqërisë që dhuna kundër grave është e pajustificuar, është ende e pranueshme që të dëmtosh ose të vrasësh burra nëse arsyet janë të justifikueshme; (3) Burrat trajtohen sikur ata nuk ndejnë dhimbje apo provojnë emocione si gratë. Nëse kërkohet që dikush të japë ose të vërë në rrezik jetën, burrat zgjidhen për këtë qëllim. Kur ata dëmtohen në punë ose duke luajtur, ata pritet që ta injorojnë dhe të vazhdojnë sikur asgjë nuk ka ndodhur; puna apo loja është më e rëndësishme se ndjenjat e tyre. Vlera e jetës së burrave në kontekste të caktuara mund të merret si lehtësisht e zëvendësueshme (4) Djemtë dhe burrat nuk pritet që të kenë nevojë për afërsi, siguri, vëmendje, pasi kjo është e rrezikshme për vendin dhe rëndësinë e tyre në botë. Nëse djemtë ose burrat kërkojnë ndihmë, ata shihen si të dobët dhe të varur, dhe shahen, sepse sillen sikur të ishin gra; (5) Burrat trajtohen sikur nuk e përmbajnë dot veten në lidhje me shprehjen e seksualitetit të tyre. Mendohet që burrat nuk e kanë veten në dorë në mënyrën si mendojnë, ndejnë, duken apo veprojnë në një kontekst seksual kundrejt çdokujt, një arsye që shpesh shoqërohet me përdhunimin apo provokimin nga femra të seksualizuara.

Ligji për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare. Baza ligjore për adresimin e dhunës është Ligji për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare Nr.9669, datë 18.12.2006. Miratimi dhe hyrja në fuqi e këtij ligji në 2006 dhe amendimeve të tij më 2007 dhe me tej më 2010 është një hap i rëndësishëm drejt plotësimit të kuadrit ligjor në fushën e dhunës në familje. Ky ligj ka dy drejtime të rëndësishme: Së pari ai sanksionon organet shtetërore që kanë detyrime dhe kompetenca për t’iu përgjigjur dhunës në familje. Së dyti, ligji u jep mundësi gjykatave të lëshojnë urdhra mbrojtjeje kundër dhunuesit, një mjet juridik shtesë në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje. Në tetor 2010 Kuvendi i Shqipërisë miratoi disa amendamente në ligjin “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*” të mbështetura nga Rrjeti i Shoqatave kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe Trafikimit, UNDP dhe UNIFEM ⁴⁹(tashmë UN Women). Këto amendamente kanë të bëjnë me, midis të tjerave, ngritjen e një strehëze kombëtare për viktimat e dhunës në familje, si dhe rregullimin ligjor të sistemit të reagimit të koordinuar dhe të referimit ndaj rasteve të dhunës në familje.

⁴⁹ ACER & ASET. 2008. Perceptimi publik në lidhje me pjesëmarrjen e grave në zgjedhje në Shqipëri, mbështetur nga UNIFEM. Tiranë

Mekanizmi qeveritar që adreson dhunën në familje. LDHF përcakton dy lloj autoritetesh përgjegjëse, ato administrative dhe gjyqësore. **MPCSSH** është autoriteti kryesor përgjegjës me rol koordinues, mbështetës dhe mbikqyrës. Autoritetet e tjera përgjegjëse, si *Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe qe me amendamentet e vitit 2007 edhe Ministria e Arsimit* adresojnë rastet e dhunës në familje nëpërmjet strukturave në varesi të tyre dhe sipas kompetencave që ky ligj u parashikon. Veç këtyre organeve qendrore, ligji u rezervon një sere detyrash edhe organeve që pushtetit vendor.

Gjykatat. Përgjegjësitë e gjykatave janë të lidhura ngushtë me shqyrtimin e kërkesave për Urdhërin e Mbrojtjes dhe Urdhërin e Mbrojtjes së Menjëhershme; zbatimin e LDHF dhe ligjeve të tjera.

Nismat e ndërmarra dhe problemet në parandalimin e dhunës në familje dhe asistencës ndaj viktimave të saj. Gjatë periudhës 2007-2010 ka patur zhvillime të dukshme në drejtim të luftës kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, si në çështje të rritjes së ndërgjegjësimit në lidhje me parandalimin për dhunën në familje, ashtu edhe me përgjigjen e strukturave ndaj rasteve të dhunës. Së pari, me mbështetjen edhe të UNDP-së ka patur pasurim të kuadrit ligjor kundër dhunës në familje edhe me akte nënligjore, të cilat janë një parakusht për zbatimin e tij. Vlejnë për t'u përmendur me këtë rast aktet e nxjerra nga Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Brendshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Kjo ka bërë që si përgjigja e këtyre institucioneve ndaj rasteve të dhunës, ashtu edhe mbajtja e të dhënave dhe regjistrimi i këtyre rasteve të jetë më i strukturuar dhe orientuar. Në ditët e fundit të dhjetorit 2010, Prokurorja e Përgjithshme nxori një qarkore për prokurorët, për të tërhequr vëmendjen dhe dhënë orientime lidhur me zbatimin e drejtë të Ligjit për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare si dhe legjislacionit penal që gjen zbatim në këto raste.

Së dyti, në zbatim të Planit të Veprimit, janë ngritur njësitë, sektorët apo seksionet përgjegjëse për çështje të dhunës në familje pranë institucioneve përkatëse të Ministrisë Brendshme, Policisë së Shtetit dhe MPCSSH, të cilët, në zbatim të planit të veprimit të SKBGJ-DHF (2007-2010) janë trainuar në lidhje me dukurinë e dhunës, shkaqet e saj si dhe detyrimet që u lindin këtyre strukturave nga Ligji për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare.

Së treti, trainime janë zhvilluar edhe për nëpunës të tjerë civilë në organet e qeverisjes vendore, punonjës të shëndetësisë dhe arsimit, të organizuara

nga Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta pranë MPÇSSHB, Ministria e Shëndetësisë dhe nga Instituti i Trainimeve të Administratës Publike, në bashkëpunim me UNDP dhe UNFPA në kuadrin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje. Trainime të posaçme për kuptimin dhe zbatimin e drejtë të Ligjit për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare janë kryer edhe për një masë të madhe gjyqtarësh dhe disa prokurorë.

Si rezultat i trainimeve në shkallë të gjerë, edhe puna e këtyre strukturave ka treguar disa arritje. Është rritur numri i individëve që i drejtohen gjykatës për arsye të dhunës si dhe numri i urdhërmbrojtjeve të lëshuara prej tyre⁵⁰. Vihet re që ndër vitet e zbatimit të SKBGJ-DHF 2007-2010, ka patur një zgjerim të numrit të gjykatave që kanë lëshuar urdhëra mbrojtjeje për viktimat e dhunës në familje, duke mos mbetur vetëm në gjykatat e qyteteve të mëdha, por edhe në ato të rretheve më të vogla. Shtimi i numrit të vendimeve për urdhrat e mbrojtjes të lëshuara nga Gjykata tregon se është rritur ndërgjegjësimi, reagueshmëria dhe besimi i viktimave të dhunës në sistemin e mbrojtjes. Mirëpo, shpejtësisë së gjykatës nuk i përgjigjen strukturat e përmbarimit, të cilat duket se e gjejnë të vështirë në terren zbatimin e vendimeve gjyqësore. Përmbaruesit, stafi administrativ i gjykatave, specialistët mjeko-ligjorë, avokatët dhe inspektorët e Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, janë disa nga profesionet që nuk kanë marrë trajnime të mjaftueshme lidhur me zbatimin e LDHF, gjë që mbetet një sfidë për t'u adresuar në Strategjinë e re.

Po kështu, një rritje pozitive që nga 2007, vit i hyrjes në fuqi të LDHF dhe i fillimit të zbatimit të SKBGJ-DHF 2007-2010, evidentohet për rastet që denoncohen në polici. Kështu, të dhënat zyrtare nga Sektori i Mbrojtjes së të Miturve dhe kundër Dhunës në Familje pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, dëshmojnë për një rritje të konsiderueshme, si të rasteve të dhunës në familje të raportuara në polici, ashtu edhe një rritje të numrit të kërkesave për urdhra mbrojtjeje të përgatitura dhe dërguara nëpër gjykata nga strukturat policore.

⁵⁰ Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Civil Rights Defenders, Raport – Zbatimi i Ligjit për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, 2010

Tabela 1: Numri i Rasteve të Raportuara të Dhunës sipas Zhvillimeve në Legjislacion dhe Ndërhyrje

Viti	2005	2006	2007	2008	2009	9-mujori i parë i 2010
Lidhja me daljen e ligjit dhe zbatimin e Strategjisë	Nuk kishte ligj të posaçëm për DHF	Me mbështetje në donatorëve fillojnë disa fushata ndërgjegjësimi që i paraprinë miratimit të LDHF në fund të këtij viti	LDHF hyn në fuqi dhe miratohet SKBGJ-DHF 2007-2010	Përgatiten akte nënligjore dhe fillon trainimi për disa disiplina	Përfundon trainimi i policisë, gjyqtarëve, prokurorëve. Vazhdojnë trainimet për punonjësit e shëndetësisë	Përfundon trainimi i shërbimeve sociale, punonjësve të arsimit, nëpunësve civilë nëpër bashki të ndryshme
Nr. i rasteve të raportuara në polici	94	208	274	822	1217	1423
Nr. i kërkesave për urdhërmbrojtje të përgatitura nga policia				377	841	859

Shpesh pohohet se është shtuar besimi i qytetarëve tek organet e policisë, gjykatat dhe OJF-të që ofrojnë shërbime ligjore, sociale, psikologjike e mjekësore për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Së katërti, veç punës me profesionet e veçanta, në zbatim të Planit të Veprimit të SKBGJ-DHF 2007-2010 po bëhen përpjekje për krijimin e sistemeve të reagimit të koordinuar dhe referimit të rasteve të dhunës të përbërë prej aktorësh qeveritarë të disiplinave të ndryshme dhe aktorësh joqeveritarë që ofrojnë shërbime të ndryshme në komunitet për të prekurit nga dhuna. Kjo është një strategji që

përcakton metodologjinë e trajtimit të dhunës. Një sistem i tillë referimi është instaluar në nëntë qytete pilot dhe po instalohet edhe në tetë të tjerë. Mbështetur në përvojën e këtyre përvojave pilot, po punohet për ta shtrirë këtë model edhe në të gjitha njësitë e tjera të qeverisjes vendore. Për këtë qëllim, amendimi i ligjit mbi krijimin e rrjetit të reagimit të koordinuar ndaj dhunës sapo u krye dhe po përgatitet një akt nënligjor për ta vënë atë në zbatim. Me miratimin e këtij akti, sfida do të mbetet ngritja e sistemit në të gjithë bashkitë e tjera, dhe sidomos i krijimit të një bashkëpunimi të tillë ndërdisiplinor edhe në komuna, ku nuk është pilotuar asnjëherë më parë. Qëllimi i këtij sistemi është që dhuna të trajtohet aty ku ndodh.

Edhe komuniteti ka shtuar ndjeshmërinë ndaj dhunës në familje. Roli i pushtetit lokal ka filluar të ndjehet. Deri me tani, pranë disa njësive të pushtetit vendor janë ngritur struktura informuese mbi dhunën në familje, të përfaqësuara nga administratorë socialë, përshkrimi i punës së të cilëve parashikon përgjegjësitë për ndjekjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Mbi baza projektsh, disa bashki e kanë përfunduar punonjësin gjinor dhe kanë filluar punën për ngritjen e strukturave dhe shërbimeve për parandalimin e dhunës dhe trajtimin e viktimave, të tilla si strehime të perkohshme apo linja telefonike falas. Mbetet sfida qëndrueshmëria e tyre pas përfundimit të projekteve, gjë që ben të nevojshme mbështetjen financiare të atyre bashkive të pakta që kanë vendosur tashme shërbime të tilla. Buxheti i pamjaftueshem për organet e qeverisjes vendore shpesh përmendet nga aktore të ndryshme që punojnë në fushën e dhunës në familje, si shkak për mungesën e shërbimeve sociale dhe mbështetese për viktimat.

Në 37 bashki dhe 23 komuna janë emëruar administratorët socialë në përshkrimin e punës së të cilëve përfshihen edhe çështje të parandalimit të dhunës në familje dhe trajtimit të viktimave të saj. Është bërë verifikimi i OJF-ve të licënuara që merren me trajtimin e dhunës në familje me qëllim që të bashkërendohet puna për krijimin e një rrjeti reagimi dhe referimi ndaj dhunës në familje. Mungesa e linjave telefonike në shumicën e njësive të qeverisjes vendore për të raportuar rastet e dhunës është bërë pengesë në kushtet kur është rritur ndërjegjësimi për denoncimin e rasteve. Një tjetër sfida për Strategjinë e re mbetet instalimi i një linje telefonike kombëtare 24-

orëshe për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, e cila të vendosë më pas lidhjen me linjat rajonale, vendore që janë më pranë vendit ku ndodh dhuna.

Së pesti, për të adresuar pamjaftueshmërinë e theksuar të shërbimeve të strehimit për të mbijetuarit nga dhuna në familje dhe në zbatim të planit të veprimit të SKBGJ-DHF, MPÇSSHB, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror dhe Këshilli i Qarkut të Tiranës, me mbështetjen teknike dhe financiare të UNDP-së përfunduan në 2010 përgatitjen e një godine për të pritur 30-40 persona të mbijetuar të dhunës në familje. Mbetet sfidë për këtë Strategji ofrimi i një shërbimi të standardeve ndërkombetare në këtë Qender, mbështetja e vazhdueshme e saj me fonde për të siguruar mirëfunksionimin e shërbimeve të ofruara prej saj dhe hapja e shërbimeve të reja rezidenciale dhe rehabilituese edhe në zona të tjera të vendit, për të plotësuar kërkesat e larta të qytetarëve dhe standardet e Këshillit të Europës. Gjithashtu, një detyrë e re në kuadrin e planit të veprimit të kësaj Strategjie mbetet finalizimi i tërë kuadrit rregullator për funksionimin e kësaj Qendre, i formuluar në kuadër të zbatimit të SKBGJ-DHF (2007-2010).

Në rrjetin e shërbimeve sociale për gratë është rritur numri i psikologëve për të trajtuar pikërisht traumën e dhunës në familje. Trajnimi specifik i tyre për trajtimin e grave dhe fëmijëve të dhunuar po vjen në vëmendjen e specialistëve. Mbetet sfidë për këtë Strategji vendosja e specialistëve të tillë pranë strukturave të shërbimit shëndetësor, me qëllim që të realizohet detyrimin ligjor (sipas LDHF) i strukturave shëndetësore për të ofruar edhe ndihmë psikologjike, vec asaj shëndetësore për traumat që pësojnë viktimat e dhunës në familje.

Edukimi i fëmijëve dhe të rinjve. Sistemi arsimor është evidentuar si tejet i rëndësishëm në ndryshimin e qëndrimeve të brezit të ri. Analiza e aktivitetit në këtë fushë tregon se në sektorin e kurrikulave në MASH nuk ka politika të qarta për krijimin e një modeli të organizuar, që të orientojë specialistët e kurrikulës dhe teksteve shkollore, mesuesit dhe specialistet e tjerë në arsim për trajtimin e problemit të dhunës në familje. Trajtimi i dhunës në familje jepet si rekomandim për t'u zbatuar në shkolla, por në programet shkollore nuk janë

vendosur njohuritë për dhunën (si abuzimi i fëmijëve dhe incesti, abuzimi ndaj të moshuarve, abuzimi fizik/emocional, abuzimi seksual) si pjesë e njohurive të përgjithshme. Për më tej, jo të gjithë mësuesit zotërojnë metodologjinë e duhur që të japin njohuritë, aftësitë dhe sjelljet e nevojshme që nxënësit të dallojnë dhunën dhe të reagojnë ndaj saj. Megjithatë, zbatimi i SKBGJ-DHF solli perparime edhe në angazhimin e strukturave dhe personelit arsimor në lufte kundër dhunës në familje. Veç perparimeve në fushën e përgatitjes së materialeve specifike që synojnë integrimin e perspektives gjinore në çdo lende, programeve trajnuese për përfshirjen e perspektives gjinore në procesin mesimor, tekste dhe në mbare sistemin, të realizuar me arsimtare, drejtues të institucioneve arsimore, hartues tekstesh, pedagogje të fakulteteve pedagogjike dhe autoriteteve çertifikuese të teksteve shkollore, janë zhvilluar trajnime 369 punonjësve të arsimit lidhur me edukimin e nxenesve kundër dhunës në familje, por edhe me hapat që mund të ndermarrin institucionet shkollore në mbrojtje të nxenesve të tyre nga dhuna. Në këto trajnime morën pjesë arsimtare, psikologe dhe drejtues institucionesh arsimore nga 4 qarqe të vendit, Tiranë, Durrës, Korçë dhe Berat. Mirepo këto sesione trajnuese duhet të vazhdojnë për të mbuluar edhe qarqet e tjera. Dhuna e ushtruar të fëmija identifikohet, adresohet, trajtohet nga punonjësi social, edukatori, prindi, por jo kudo ata i kanë të qarta institucionet dhe shërbimet e specializuara që i ofrohen fëmijës. Roli i psikologut dhe punonjësit social nuk është i përfshirë sa duhet në veprimtarinë edukative në shkollë.

Me ndryshimet e fundit të LDHF, iu dha mundësia edhe personave që kanë për detyrë të kujdesen për fëmijën të ngrenë kërkesë padi në gjykatë për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të mbrojtjes së menjëhershëm për të miturit. Njohja e personelit arsimor me këtë mundësi dhe fuqi të re ligjore që u vihet në dispozicion do të rrisë angazhimin dhe rolin e tyre në mbrojtje të fëmijëve të dhunuar dhe parandalimin e episodeve më të rënda të dhunës ndaj tyre.

Megjithatë, për ndergjegjesimin e nxenesve, mësuesve, prindërve si dhe komunitetit rreth shkollave, prej disa vitesh, e veçanërisht pas miratimit të SKBGJ-DHF janë kryer fushata masive për edukimin e tyre me konceptet e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje, si

dhe për informimin e tyre lidhur me mundësitë e reja ligjore që ofron LDHF. Këto fushata të përvitshme, ku ka bashkëpunuar MPÇSSH me drejtoritë arsimore dhe sidomos Kombet e Bashkuara, janë lidhur kryesisht me fushatën globale të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas (25 nëntor-10 dhjetor). Besohet se rritja e numrit të rasteve që paraqiten në gjykata dhe prokurori, pjesërisht është ndikuar edhe nga këto fushata informimi dhe edukimi.

Modele pozitive për edukimin e nxënësve me mundësitë e barazisë gjinore dhe kundër dhunës me baze gjinore paraqesin dy tekste, për nxënësit dhe për mësuesit perkatesist, të hartuar nga shoqëria civile, në bashkëpunim me specialiste të fushave të ndryshme dhe me mbështetjen e donatoreve, të cilat paraqesin potencial për edukimin në vazhdimësi të rinisë shkollore me koncepte të drejta mbi perkatesinë gjinore në raport me mjedisin, median, dhunën në familje, shëndetin riprodhues, integrimin evropian, etj.⁵¹ Në zbatim të LDHF dhe duke njohur rolin e rëndësishëm të sistemit arsimor, kjo Strategji orienton adresimin e dhunës me baze gjinore dhe edukimin me konceptet e barazisë gjinore në Strategjinë e sektorit të arsimit dhe planin perkates të veprimit, duke ruajtur marrëdhënien koordinuese me këtë Strategji dhe duke lehtësuar rolin monitorues dhe koordinues të MPÇSSH në këto fushë.

Përparime ka patur edhe në fushën e arsimit të lartë dhe konkretisht në futjen e lendeve, moduleve apo temave të ndryshme në fushën e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje në fakultetet e drejtësisë, mjekësisë, infermierisë, shkencave sociale, Shkolles së Magistratës dhe Akademisë së Policisë. Megjithatë, duke qenë lende të reja, ato kanë nevojë për konsolidim dhe përmirësim të mëtejshëm, si dhe të rritet bashkëpunimi mes tyre dhe institucioneve publike dhe politikeberëse, ku studimet dhe kërkimet të furnizojnë me informacion dhe ide proceset e formulimit të politikave.

Dhënia e ndihmës shëndetësore me fokus parandalimin. Një ndër synimet e sektorit të shëndetit publik shqiptar gjatë zbatimit të

⁵¹ Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, 2009. «Përkatësia gjinore dhe të drejtat e njeriut, qytetaria, dhuna në familje, integrimi evropian, media, shëndeti riprodhues, zhvillimi i karrierës, mjedisi. (Libër për nxënësit dhe libër për mësuesit).

SKBGJ-DHF 2007-2010 ka qenë adresimi i dhunës brenda familjes si çështje e shëndetit publik. Për këtë qëllim, gjatë zbatimit të Strategjisë ka patur përpjekje të konsiderueshme për të përmirësuar përgjigjen e kujdesit shëndetësor ndaj dhunës në familje nëpërmjet politikave publike, edukimit shëndetësor dhe përpjekjeve parandaluese. Urdhrat e MSH në bazë dhe për zbatim të LDHF kanë arritur këto rezultate:

1. Kanë vendosur detyrimin edhe për spitalet (jo vetëm për qendrat shëndetësore dhe urgjencat mjekësore) që të ofrojnë shërbim për viktimat e dhunës në familje, edhe kur këto nuk janë në skemën e sigurimeve shëndetësore;
2. Kanë përcaktuar rregullat lidhur me dokumentimin dhe regjistrimin e rastit, gjë që e ka vendosur në një bazë të rregullt mbajtjen e statistikave lidhur me dhunën në familje;
3. Kanë dhënë udhëzime si do të plotësohet raporti mjekësor që do t'i lëshohet viktimës, i cili mund të paraqitet prej saj në gjykatë ose mund t'i paraqitet gjykatës me kërkesën e kësaj të fundit.

Gjithashtu, MSH ka hartuar edhe protokollin standard për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, si për çdo lloj sëmundshmërie. Siç u përmend më lart, për njohjen dhe zbatimin e drejtë të këtyre kërkesave ligjore dhe nënligjore, MSH, në bashkëpunim me donatorë të ndryshëm ka realizuar sesione trainuese, nga të cilat kanë përfituar 2400 mjekë, infermierë dhe mami në qendrat e kujdesit parësor, urgjencat mjekësore dhe maternitetet. Ky program trainimi ka qenë ndër të parët që është akredituar nga institucionet kompetente për trainimin profesional dhe çertifikimin e punonjësve të shëndetësisë. Sfidë për Strategjinë e rishikuar mbetet aftësimi i Drejtorive të Shëndetit Publik për të realizuar me burimet e veta dhe në bashkëpunim me organizatat ndërkombetare të specializuara në këtë fushë, trainimin e punonjësve të tjerë shëndetësorë nën varësinë e këtyre drejtorive si dhe monitorimi i shtrirjes dhe cilësisë së këtij procesi.

Së fundi, siç u përmend edhe më lart në lidhje me ofrimin e kujdesit shëndetësor në kushtet e barazisë mes grave dhe burrave dhe me ndryshimin ndaj ndryshimeve gjinore dhe seksuale mes tyre, MSH

ka theksuar si një nga qëllimet strategjike të Strategjisë për Shëndetin Riprodhues edhe Parandalimin dhe Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës me Bazë Gjinore, në veçanti gratë dhe fëmijët, duke e orientuar punën deri në vitin 2015 në drejtim të plotësimit dhe përmirësimit të mëtejshëm të akteve nënligjore në fushën e dhunës, rritjes së shkallës së përfitimit të viktimave nga shërbimet që ofron sistemi shëndetësor, përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave mbi dhunën me bazë gjinore në të gjitha strukturat e sistemit shëndetësor dhe rritjes së ndërgjegjësimit publik kundër dhunës në familje. Sfidë për Strategjinë e rishikuar mbetet koordinimi i mirë i strukturave të ndryshme dhe konsolidimi i mëtejshëm i rolit mbikqyrës dhe koordinues i MPCSSH B si autoritet kryesor përgjegjës.

Nismat e Ndërmarra dhe Problemet në Drejtësi dhe Mbrojtje. Në zbatim të SKBGJ-DHF 2007-2010 nisi dhe u hartua një paketë dokumentacioni, e cila përmban një analizë të hollësishme të legjislacionit nga pikëpamja e barazisë gjinore dhe dhunës në familje. Ky raport shoqërohet me projekt propozime për ndryshime të ligjeve të ndryshme për të siguruar përputhje me standardet e CEDAW-t, legjislacionit të BE dhe një harmonizim më të mirë të ligjeve të tjera me LBGJ dhe LDHF. Paketa, ndër të tjera përmban edhe propozime për ndryshimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale për të siguruar ashpërsim të sanksioneve kundër dhunës në familje dhe përdhunimit martesor, si dhe rrisin kompetencat për organet e ndjekjes penale në trajtimin e këtyre rasteve, siç u rekomandua edhe nga Komiteti i CEDAW-t gjatë raportimit të fundit të Shqipërisë në verën e vitit 2010. Sfidë për Strategjinë e rishikuar përbën organizimi i procesit konsultativ të këtyre projekt-amendamenteve, miratimi i tyre, si dhe përgatitja e profesionistëve të drejtësisë për zbatimin dhe interpretimin e tyre.

Dy zhvillime të reja në fushën e drejtësisë, si hyrja në fuqi e ligjit “Për ndihmën ligjore falas” dhe krijimi i Shërbimit të Provës ofrojnë mundësi të reja në luftën kundër dhunës në familje. Ofrimi i ndihmës ligjore falas për viktimat e dhunës në familje paraqitet i vonuar dhe një ndër synimet e kësaj Strategjie është realizimi i këtij detyrimi ligjor deri në vitin 2015.

Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave lidhur me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore paraqet gjithashtu një sfidë për Strategjinë e rishikuar, kjo me qëllim që të ndikojë në përmirësimin e politikave të sistemit të drejtësisë ndaj dukurisë, por edhe për të rritur shkallën e monitorimit dhe llogaridhënies në këto struktura.

Shpeshherë përgjigja e sistemit të drejtësisë ndaj rasteve të dhunës në familje, kërkon burime të reja dhe mirorganizim të burimeve ekzistuese. Për këtë qëllim, po realizohet një studim për kostimin e dhunës në familje, i cili do të hapë rrugën për veprime të mëtejshme shtetërore, në kuadrin e planit të veprimit të kësaj Strategjie të rishikuar, i cili duhet rishikuar dhe rinfreskuar çdo vit, mbështetur mbi arritjet e vitit paraardhës dhe sfidat e evidentuara nga raporti i progresit të përvitshëm të kësaj Strategjie.

Riintegrimi/rehabilitimi. Një sfidë për Strategjinë e rishikuar është rritja e raportit të vendimeve gjyqësore që përcaktojnë largimin e dhunuesit nga banesa, krahasuar me largimin e viktimës, kjo me qëllim që të përforcohet natyra e paligjshme e veprimeve të dhunuesit dhe vendosjen e sanksioneve mbi të, por edhe me qëllim që të përmirësohen kushtet për viktimën dhe fëmijët e saj që të zhvillojnë një jetë me siguri më të madhe ekonomike, që shoqërohet me shanse më të pakta për t'u rikthyer në një marrëdhënie të dhunshme.

Ndryshimet më të fundit të LDHF vendosen detyrimin mbi reagimin e koordinuar, jo vetëm për t'u përgjigjur rastit, por edhe për të punuar lidhur me rehabilitimin e viktimave të abuzimit në familje. Strehëza kombëtare për të mbijetuarat e dhunës në familje, do të ketë programe që synojnë rehabilitimin e tyre, mirëpo mbetet ende problematike çështja e riintegritit të tyre në një jetë të zakonshme, të pavarur nga dhunuesi dhe kësaj të lirë nga dhuna e mëtejshme. "...derisa qeveria të trajtojë çështjen e diskriminimit sistematik institucional dhe social të grave, përfshirë fushat e mundësive për punësim, strehim dhe përkujdes shëndetësor, shumë gra dhe fëmijët e tyre nuk do të jenë në gjendje të largohen dhe t'i shpëtojnë dhunës në familje." – shprehet raporti i Amnesty International i vitit 2010.

Për këtë qëllim, Strategjia e rishikuar, përpiket të adresojë çështjet e buxhetimit përmes studimit të kostimit dhe duke analizuar mundësinë

e ngritjes së një fondi të veçantë për dhunën me bazë gjinore dhe përdorimit të qëllimshëm të fondeve ekzistuese, si Fondit për Zhvillimin e Shoqërisë Civile dhe fondeve të pashpërndara në dispozicion të institucioneve shtetërore për qëllime të luftës kundër dhunës në familje.

Teksa theksi vihet në vënien përpara përgjegjësisë, civile dhe penale të dhunuesit, kjo shihet e kombinuar me nevojën për shërbime rehabilitimi edhe për dhunuesit, për të siguruar largimin e tyre nga sjellja e dhunshme në të ardhmen.

Sfidat. Disa nga sfidat kryesore mbeten ndërgjegjësimi i vazhdueshëm për tolerancën zero ndaj dhunës, konsultimi dhe miratimi i sugjerimeve lidhur me përmirësimet ligjore në Kodin Penal (KP) dhe në Kodin e Procedurës Penale përse i përket ndjekjes penale të dhunës në familje, duke parashikuar në KP dispozita specifike lidhur me dhunën në familje dhe duke ashpërsuar dënimin, sidomos ndaj atyre që kryejnë vrasje në emër të nderit apo përdhunojnë bashkëshorten/ ish-bashkëshorten. Mbetet gjithashtu sfidë sigurimi në praktikë i asistencës ligjore dhe psikologjike falas për viktimat e dhunës, Për më tej, përmirësimi i shërbimit të përmbarimit në lidhje me ekzekutimin e Urdhrit të Mbrojtjes dhe Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes do të ishte një mbështetje e nevojshme për vajzat dhe gratë e dhunuara. Në këtë kuadër, vazhdimi i trainimit të punonjësve publikë dhe zgjerimi i rrethit, veçanërisht në drejtim të trainimit të përmbaruesve gjyqësorë, punonjësve dhe funksionarëve të ndryshëm në sistemin e drejtësisë, punonjësve të shërbimit shëndetësor, punonjësve socialë dhe mësuesve që të njohin format e dhunës në familje dhe të reagojnë ndaj saj do të rrisë efektshmërinë e ndërhyrjeve. Më gjerë, duhet vazhduar puna për rritjen e ndërgjegjësimit që dhuna ndaj grave është një çështje ndërsektoriale që kërkon vëmendje shumë-disiplinore, por në të njëjtën kohë, ajo është kërcënim serioz për shëndetin publik; rritjen e kuptueshmërisë së dhunës ndaj grave, përfshirë trafikimin, nëpërmjet mbledhjes dhe analizimit të të dhënave dhe informacionit të besueshëm; shpërndarje të saktë dhe të duhur të informacionit nëpërmjet medias dhe rritje të rolit të medias në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë; Rritjen e rolit të djemve dhe burrave në parandalimin e dhunës kundër grave.

Së fundi, vendosja e grave të dhunuara në programe trainimi dhe dhënia e mundësive për të gjetur punësim si dhe përfshirja e dhunuesve në programe rehabilitimi dhe për punë janë dy ndërhyrje programatike që adresojnë mundësitë për një jetë të denjë pa dhunë nga të gjitha palët.

Performanca Aktuale e Qeverisë dhe Drejtimet për Përmirësim

SKBGJ-DHF 2007-2010 ishte përpjekja e parë e gjithanshme e qeverisë për të adresuar barazinë gjinore dhe dhunën në familje. Por praktika e strategjive ndërsektoriale është relativisht e re dhe si e tillë ajo shoqërohet me sfida të shumë niveleve. Megjithë udhëzimet, ajo ka ende nevojë të kuptohet nga njësitë zbatuese dhe monitoruese (ku ekzistojnë) në nivel qendror dhe lokal. Me gjithë arritjet, vlerësimi tregoi që efektiviteti i SKBGJ-DHF 2007-2010 ka qenë modest dhe jo i njëtrajtshëm; qëndrueshmëria e rezultateve të arritura e brishtë. Sfidat e zbatimit dhe të rezultateve u përcaktuan nga një seri kufizimesh. Më specifikisht, vlerësimi gjeti që në të ardhmen duhet të adresohen çështjet e mëposhtme:

Menaxhim më efektiv dhe partneritet. Ndërtuar dhe zbatuar në bashkëpunim me shumë aktorë të shoqërisë shqiptare, praktika tre-vjeçare tregoi që qeveria mund të marrë një rol udhëheqës dhe të zbatojë veprimet për një përgjigje të mirë-koordinuar kur ka vullnet dhe angazhim politik. Megjithatë, natyra ndërsektoriale e strategjisë ka patur nevojë të kuptohej më mirë. Ndërsa prioritetet e vendosura ishin relevante për kohën, një pjesë e ndërhyrjeve mund të realizoheshin në kornizën e një strategjie sektoriale, sidomos ato që lidhen me arsimin, shëndetin dhe mbrojtjen sociale; çështje të pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në vendim-marrje jo vetëm në politikë, por në të gjitha fushat e jetës profesionale dhe shoqërore duhet të përshkujnë si tema ndërfaqshore të gjitha ndërhyrjet e monitoruara me anë të kësaj strategjie. Për më tej, struktura e zbatimit të strategjisë ishte e pamjaftueshme përse i përket stafit dhe burimeve administrative për të mbështetur nivelin e lartë të ndërhyrjeve të strategjisë. Mungesa e një Plani Veprimi të orientuar nga menaxhimi mbi bazën e rezultateve e ka bërë të vështirë matjen e progresit të SKBGJ-DHF 2007-2010. Vlerësimi gjeti që, megjithë përpjekjet,

partneriteti dhe dialogu i dyanshëm me aktorë të tjerë të interesuar si organizatat joqeveritare vendase dhe ndërkombëtare, apo media kanë nevojë të forcohen.

Programim kundrejt ndërhyrjeve specifike. Vizioni i SKBGJ-DHF 2007-2010 dhe fushat prioritare informuan dhe orientuan veprimtarinë e qeverisë dhe donatorëve të ndryshëm në lidhje me barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje. Arritjet në shumë drejtime i dedikohen masave specifike të përshkruara në strategji. Megjithatë kjo veprimtari ka mbetur në nivelin e projekteve dhe pak herë është organizuar rreth nismave programatike. Në fakt, nismat programatike kanë ardhur vetëm nga donatorët, si për shembull, “Barazi në Qeverisje” nga Agjensia e Zhvillimit Austriak. Mungesa e nismave programatike ka çuar në arritje të rezultateve në bazë projektesh dhe nuk ka mundur marrjen e një tabloje të qartë ecurish dhe sfidash në secilën fushë prioritare.

Koordinim i financimit nga qeveria dhe donatorët e huaj. Duke qenë se strategjitë ndërsektoriale nuk kanë mekanizma financiarë të tyret, por varen nga disponueshmëria e fondeve brenda programeve buxhetore të secilës ministri, ishte e nevojshme që të kishte një koordinim të kontributeve të ardhura nga secili institucion. Po kjo strategji nuk arriti të krijojë dialog të mjaftueshëm për të adresuar kostot e ndryshme dhe përfitimet e promovimit të barazisë gjinore dhe dhunës në familje si në nivelin lokal dhe atë qendror; strategjia mbeti e pambuluar mirë financiarisht dhe e varur nga kontributet e donatorëve si për shembull Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara mbi Barazinë Gjinore.

Monitorimi i treguesve të barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorimi i Strategjisë u bë në bazë të raporteve vjetore të progresit. Mungesa e Treguesve të qartë të Monitorimit dhe Matricës së Vlerësimit të Performancës (të dyja të aprovuara vetëm në 2010) e bëri monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë sfidues. Zhvillimi i një kuadri logjik në Strategjinë e re në mënyrë të tillë që të përcaktojë tregues të qartë performance në nivelin e produkteve, dhe rrjedhojave është tejet i nevojshëm.

Ndryshimet Kryesore në Strategjinë e Rishikuar

Zhvillimet, arritjet dhe sfidat e ndeshura në zbatimin e SKBGJ-DHF 2007-2010, sollën rishikimin e këtij dokumenti me qëllim që drejtimet dhe ndërhyrjet e parashikuara në të, të reflektojnë realitetin aktual të Shqipërisë, rekomandimet e ardhura nga partnerë të ndryshëm vendas dhe ndërkombëtarë, si dhe rekomandimet e Komitetit të CEDAW (2010). Rishikimi orientohet edhe nga dokumenta të tjerë të rëndësishëm me rezonancë aktuale si Rezoluta 1325 e Kombeve të Bashkuara për Paqen dhe Sigurinë, Strategjia e BE për Gratë dhe Burrat, 2010-2015 dhe Strategjia Lokale për Zbatimin e Udhëzimeve të BE mbi Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave dhe Luftës së të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Tyre 2010 miratuar nga Drejtuesit e Misioneve të BE-së në Shqipëri.

Procesi i rishikimit të SKBGJ-DHF 2007-2010 filloi me Konferencën Kombëtare mbi Stereotipet Gjinore mbajtur në qershor 2010. Në të morën pjesë rreth 150 përfaqësues të organeve qendrore dhe vendore si edhe OJF me aktivitete në të gjithë vendin. Të ndarë në katër grupe pune, përkatësisht (1) Fuqizimi Ekonomik, Arsimit dhe Shkenca; (2) Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale; (3) Mekanizmi Institucional dhe Kuadri Ligjor; dhe (4) Dhuna ndaj Grave, pjesëmarrësit dhanë rekomandimet e para në lidhje me rishikimin e dokumentit. Në shtator-tetor 2010, dhe në Janar-Shkurt 2011 u organizuan një seri prej tetë konsultimesh teknike në të cilat morën pjesë përfaqësues të qeverisë qendrore dhe vendore, OJF-ve, donatorëve dhe parterëve ndërkombëtarë. si edhe 50 intervista individuale që përfshinë përfaqësues nga qeveria qendrore dhe lokale, Organizata Jo-Fitimprurëse (OJF), organizata ndërkombëtare dhe fusha akademike. Qëllimi i këtyre konsultimeve ishte të sigurohej që të gjithë aktorët që ushtrojnë veprimtari në fushën e barazisë gjinore dhe dhunës bien dakord në lidhje me fokusin e strategjisë dhe që kanë mundësinë të kontribuojnë në formulimin e saj. Ndryshimet e bëra dhe ndërhyrjet e rishikuara në dokumentin e ri lidhen, si dhe në strategjinë e mëparshme, drejtpërdrejt me të tre prioritetet strategjike të përshkruara në SKZHI: (1) Integrimi në Bashkimin Evropian (BE); (2) Zhvillimi dhe konsolidimi i shtetit demokratik bazuar në liritë dhe të drejtat themelore të të gjithë individëve; si dhe (3) Arritja e një

zhvillimi të shpejtë, të balancuar dhe të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror e njerëzor. Më poshtë jepen ndryshimet e bëra në dokumentin e rishikuar.

Titulli i Strategjisë

Në versionin e rishikuar është zgjeruar hapësira për adresimin e dhunës përtej dhunës në familje. Bazuar në komentet dhe sugjerimet e organizmave të ndryshme, Strategjia e Rishikuar fokusohet në Dhunën me Bazë Gjinore (DHBGJ) si një koncept më gjithëpërfshirës që përfshin si dhunën në familje, ashtu edhe dhunën ndaj grave. DHBGJ jo vetëm i rrok çështjet që lidhen me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, por nuk është përjashtuese. Të dhëna, megjithëse raporte joformale, tregojnë se pavarësisht numrit të vogël, burrat dhe djemtë gjithashtu preken nga dhuna. Kjo vijë logjike ndjek edhe parimet e strategjisë për diversitet dhe adresim të nevojave të të gjithë individëve pa dallim përkatësie gjinore. DHBGJ lejon adresimin shumë-dimensional të dhunës së ushtruar duke përfshirë praktikën zakonore dhe traditat, dhunën në familje, dhunën në vendin e punës dhe në hapësirat publike, si dhe dhunën ndaj personave me orientime të ndryshme seksuale. Ndaj dhe dokumenti i rishikuar mban emrin Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore (SKBGJ-DHBGJ), e përdorur në tekst prej këtej e tutje edhe si Strategjia).

Vizioni dhe Parimet e Strategjisë

Gjatë procesit të konsultimit, nga aktorë të ndryshëm është reflektuar propozimi që Strategjia e rishikuar të kishte një vizion të qartë, të përmbledhur dhe gjithëpërfshirës që lidhet me angazhimin e qeverisë për adresimin e barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore, prandaj dhe vizioni i Strategjisë është rishikuar për t'u përputhur me këtë kërkesë. Në mënyrë të qartë ai përfshin gratë dhe burrat, për të theksuar se çështja e barazisë gjinore nuk është një çështje e gruas, por e mbarë shoqërisë. Bashkëngjitur këtij vizioni janë parimet (të munguara në SKBGJ-DHF 2007-2010) të cilat ndihmojnë drejt realizimit të vizionit. Këto parime do të udhëheqin dhe do të qëndrojnë në themel të të gjitha hapave që ndërmerren për të zbatuar ndërhyrjet në Strategji dhe duhet të përqafohen nga të gjithë aktorët që

përfshihen në zbatimin e këtyre ndërhyrjeve. Kapitulli i Dytë prezanton vizionin dhe parimet e Strategjisë.

Riprioritizimi i Fushave

Në këtë Strategji është reduktuar numri i fushave prioritare për ndërhyrje nga tetë në katër për një përqendrim më të mirë të burimeve dhe përmirësim të monitorimit të zbatimit të Strategjisë. Këto janë: (1) Mekanizmat ligjorë dhe institucionalë që sigurojnë barazinë gjinore në Shqipëri; (2) Drejtpeshimi gjinor në vendim-marrje; (3) Fuqizimi ekonomik i grave si një ndër kushtet themelore për arritjen e barazisë gjinore; (4) Reduktimi i Dhunës me Bazë Gjinore ndarë sipas kategorive: parandalim, reagim, rehabilitim dhe ri-integrim.

Arsimi, Mbështetja Shoqërore dhe Shëndeti (caktuar si fusha prioritare të veçanta në SKBGJ-DHF 2007-2010) janë përfshirë në Fuqizimin Ekonomik të Gruas pasi ndërhyrjet në të tri këto fusha ndikojnë drejtpërsëdrejti në fuqizimin ekonomik të gruas. Arsimi është një nga mjetet më të mira për të fuqizuar gratë në marrjen e njohurive, aftësive dhe vetëbesimin, aq të nevojshëm për pavarësinë ekonomike dhe pjesëmarrjen aktive në zhvillimin e vendit. Ndaj ndërhyrje që lidhen me rritjen e kapitalit human të gratë, si: rritja e aksesit të grave në arsimin cilësor dhe pjesëmarrja e tyre në degë studimi që stereotipizohen si jo-tradicionale për to, janë bërë pjesë e prioritetit të fuqizimit ekonomik të gruas.

Mbrojtja sociale u jep grave në situata në nevojë siguri ekonomike. Kombinimi i programeve të punësimit dhe mbrojtjes sociale, të cilat janë të ndjeshme ndaj përkatësisë gjinore mundësojnë zbutjen e efekteve të reformave në grupet në nevojë, rëndom gratë. Siç tregohet në analizën e situatës aktuale, shumë gra përjashtohen nga përfitimet e papunësisë, pensionet që vijnë me moshën e thyer dhe përfitimet për kujdesin ndaj fëmijëve, ose kanë vetëm përfitime minimale. Mbrojtja sociale duhet të përmbushë të drejtat ekonomike të grave në situata, ku për arsye të ndryshme, gratë janë më të prekura. Ndaj, ndërhyrje të tilla, si përmirësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen sociale janë bërë pjesë e prioritetit për fuqizimin ekonomik të gruas.

Së fundmi, Shëndeti është bërë gjithashtu pjesë e prioritetit strategjik të fuqizimit ekonomik të grave, sepse mungesa e aksesit në shërbime të përgjegjshme të kujdesit shëndetësor dhe shëndetit riprodhues ndikojnë drejtpërdrejt në angazhimin ekonomik të grave. Megjithëse jetojnë më gjatë, gratë janë më të ekspozuara ndaj sëmundjeve dhe abuzimit; duke qenë se ato luajnë rol primar në dhënien e kujdesit për pjesën tjetër të familjes dhe shpenzojnë më shumë kohë për të rritur cilësinë e jetës për fëmijët dhe familjen sesa për vete, kanë më pak kohë të angazhohen në punësim që sjell përfitime dhe pavarësi ekonomike. Fertiliteti dhe mirë-ushqyerja lidhen direkt me arsimimin dhe gjenerimin e të ardhurave, ndaj ndërhyrje që përmirësojnë aksesin, njohuritë dhe praktikën për shëndet të mirë të grave dhe burrave janë bërë pjesë e këtij prioriteti.

Prioriteti i shtatë i SKBGJ-DHF 2007-2010, Media, është integruar në të gjitha prioritetet aktuale të Strategjisë. Duke njohur rolin e fuqishëm ndërgjegjësues të medias, Strategjia parashikon median jo vetëm si aleat në dhënien e njohurive mbi legjislacionin dhe realitete të tjera shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore, por edhe luftimin e stereotipeve që ndeshen rëndom në shoqërinë shqiptare. Nëpërmjet ndërhyrjeve horizontale, Strategjia synon t'i krijojë më shumë mundësi medias për të ndihmuar me këtë mision nëpërmjet rishikimit të ligjit për median, inkurajimit të rishikimit të politikave editoriale, dhe rregullimit të balancave gjinore në radhët e gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të medias.

Përmirësimi i Sistemit të Monitorimit mbi Bazën e Rezultateve

Vlerësimi i tregoi që duke qenë se zbatimi i asaj Strategjie ishte më shumë i orientuar drejt produkteve sesa rrjedhojave që këto ndërhyrje apo produkte duhet të sillnin, kjo e bën monitorimin në nivelin e rrjedhojave të pamundur. Në përputhje me përpjekjet e Qeverisë Shqiptare për të monitoruar jo më në bazë të produkteve, por të rrjedhojave, Strategjia aktuale rimerr qëllimet për secilën fushë prioritare dhe i lidh ato me objektiva specifike dhe rrjedhoja. Treguesit e rrjedhojave u vendosën në bazë të informacionit fillestar që doli nga procesi i vlerësimit të SKBGJ-DHF 2007-2010 dhe arritjeve të synuara deri në fund të vitit 2015. Për këtë arsye, ky dokument shoqërohet dhe me një Kuadër Logjik që paraqet në mënyrë konçize çfarë pritet të arrihet në vitet e veprimit të Strategjisë.

KAPITULLI 2

VIZIONI, PARIMET, QËLLIMI DHE PRIORITETET STRATEGJIKE

Vizioni i Strategjisë

Vizioni i Strategjisë lidhet me angazhimin afatgjatë të Qeverisë Shqiptare, i cili udhëheq zbatimin e kësaj Strategjie, por njëkohësisht shkon përtej kohëzgjatjes së saj. Ky vizion do të shërbejë si busull për të orientuar përpjekjet e vazhdueshme, jo vetëm të qeverisë, por të shoqërisë shqiptare në përgjithësi drejt arritjes së barazisë gjinore dhe reduktimit të dhunës me bazë gjinore. Ky vizion është: “Një shoqëri në të cilën barazia gjinore respektohet dhe vlerësohet, mësohet, mbështetet dhe nxitet, ku dhuna me bazë gjinore e çdo lloj forme nuk tolerohet, por dënohet, ku të prekurit prej saj përkrahen dhe mbrohen dhe ku barazia në mundësi dhe trajtim është realitet për të gjithë, pavarësisht përkatësisë gjinore.”

Parimet

1. Barazia gjinore ndërthuret me realizimin e të drejtave njerëzore: njohja dhe respektimi i barazisë gjinore është parakusht për realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga angazhimet e Shqipërisë për të respektuar të drejtat e njeriut.

2. Barazia gjinore si faktor ndërsektorial zhvillimi. Ndërsa fuqizimi dhe autonomia e grave, përmirësimi i statusit të tyre politik, social, ekonomik dhe shëndetësor janë qëllime të rëndësishme në vetvete përparimi i grave gjithashtu shihet si një faktor kryesor në zhvillimin e gjithanshem të vendit dhe për rrjedhojë përshkon të gjitha fushat e jetës politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

3. Ndjeshmëri ndaj nevojave të të dyja gjinive: respektim dhe përgjigje e përshtatur ndaj nevojave të vajzave dhe grave, djemve dhe burrave të të gjitha kategorive. Gratë dhe burrat kanë nevoja dhe kryejnë role të ndryshme në shoqëri, kanë përvoja të ndryshme, dhe përballen me forma të ndryshme të diskriminimit dhe disavantazhit, ndaj dhe promovimi i barazisë në mundësi duhet të përshtatet me këto nevoja dhe përvoja.

3. Diversiteti: njohja dhe vlerësimi i diversitetit midis vajzave dhe grave, djemve dhe burrave për sa i përket moshës, aftësisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, origjinës etnike dhe shoqërore, praktikave fetare dhe zgjedhjeve jetësore, konsiderimi i tij, duke shmangur kështu stereotipinë në bazë të karakteristikave të grupit;

4. Pacënueshmëria e dinjitetit dhe integritetit njerëzor: respektim, dhënie e garancisë dhe mbështetje që jeta e gjithkujt të jetë e sigurt; dhunimi i çdo forme është sulm mbi dinjitetin njerëzor dhe shkelje e të drejtave të njeriut, ndaj nuk duhet të tolerohet;

5. Partneriteti institucional dhe natyra ndërsektoriale e përkatësisë gjinore: promovimi i partneritetit në të cilin organet qeveritare, shoqëria civile dhe sektori privat duhet të punojnë së bashku për të adresuar pabarazitë dhe padrejtësitë me bazë gjinore për gratë dhe burrat. Çështjet gjinore nuk i përkasin dhe nuk adresohen vetëm nga një sektor apo institucion të caktuar. Ato vlejnë për të gjithë, në mjediset nga më të ndryshmet, shkollat, institucionet e kujdesit shëndetsor, gjykatat, qendrat e votimit. Si e tillë, është po aq e rëndësishme që Grupet sektoriale që punojnë në çështjet e shëndetesise, arsimit, drejtësisë dhe ndërtimit të demokracisë, si dhe grupe të tjera të kenë të gjithë përgjegjësitë e tyre “për të ndërmarrë” veprime të përshkruara në Strategji. Në Planin e Veprimit janë përcaktuar strategjitë përkatëse dhe partnerët që do të ndihmojnë; ndërkohë që ministritë e linjës, qeverisja vendore dhe partnerë të tjerë inkurajohen, si pjesë e angazhimit të tyre institucional, që në bazë të Planit të Veprimit të SKBGJ-DHBGJ, të hartojnë plane pune që adresojnë çështje të barazisë gjinore në sektorët përkatës. MPÇSSHB do të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar zbatimin e këtyre planeve nëpërmjet monitorimit të rregullt.

Qëllimi i Strategjisë

Si strategji ndërsektoriale, SKBGJ-DHBGJ tregon rrugët dhe mekanizmat institucionalë për përfshirjen e çështjeve gjinore në politikat publike, për zbutjen e dallimeve gjinore dhe parandalimin dhe luftën ndaj dhunës me bazë gjinore. Synimi është që veprimet e ndërmarra në kuadrin e kësaj Strategjie të kontribuojnë drejt arritjes së katër rrjedhëve specifike afatgjata, të cilat nga ana e tyre ndikojnë në përmbushjen e vizionit të Strategjisë:

Rrjedhoja 1. Qytetarët shqiptarë gëzojnë lirinë nga dhuna dhe të drejtat e tyre njerëzore në praktikë dhe marrin mbi vete përgjegjësi në shoqëri pa dallim të përkatësisë gjinore;

Rrjedhoja 2. Qytetarët shqiptarë kanë punësim dhe aktivitete ekonomik, shoqëror dhe politik në përputhje dhe përshtatje me aftësitë dhe përvojat e tyre, pa dallim të përkatësisë gjinore.

Rrjedhoja 3. Institucionet dhe praktikat shtetërore mbrojnë qytetarët shqiptarë nga dhuna dhe i mbështesin ata për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri, pa dallim të përkatësisë gjinore.

Rrjedhoja 4. Qytetarët shqiptarë kontribuojnë në zhvillimin dhe integrimin ekonomik, shoqëror dhe politik të vendit, pa dallim të përkatësisë gjinore.

Prioritetet dhe Objektivat Strategjike

Baza e strategjisë së rishikuar janë ndërhyrjet në katër fusha prioritare veprimi që përkthehen në rezultate specifike, të matshme, të arritshme, realiste dhe të kufizuara në kohë. Këto janë:

- Forcimi i Mekanizmit Institucional dhe Ligjor;
- Rritja e Pjesëmarrjes së Grave në Vendim-marrje;
- Fuqizimi Ekonomik i Vajzave dhe Grave;
- Zvogëlimi i Dhunës me Bazë Gjinore.

Në bazë të këtyre fushave prioritare janë vendosur Objektivat e mëposhtëm strategjike:

Forcimi i Mekanizmit Shtetëror të Barazisë Gjinore. Qëllimi strategjik në këtë fushë prioritare është: Të fuqizohet Mekanizmi Institucional dhe Ligjor për të nxitur përparimin e barazisë gjinore dhe siguruar gëzimin e të drejtave njerëzore të të gjithë qytetarëve shqiptarë pa dallim përkatësie gjinore.

Ai arrihet nëpërmjet këtyre objektivave: (1) Të përmirësohet Mekanizmi Shtetëror në nivel qendror dhe vendor për të përmbushur detyrat e tij, siç parashikohet nga LBGJSH; (2) Të rishikohet legjislacioni shqiptar nga këndvështrimi gjinor në përputhje me dokumentat ndërkombëtarë dhe kombëtare të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit; si dhe (3) Të rriten kapacitetet e autoriteteve qendrore dhe vendore për zbatimin dhe monitorimin e legjislacionit dhe strategjisë për barazinë gjinore në Shqipëri.

Në fund të 2015 arritja e këtyre objektivave do të sjellë këto rezultate te pritshme:

- (1) Barazia gjinore e integruar në politikat, strategjitë dhe programet sektoriale;
- (2) Burime financiare, njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për veprime ndërsektoriale mbi integrimin gjinor;
- (3) Të gjitha institucionet shtetërore dhe punonjësit shtetërorë (burra dhe gra) ndajnë përgjegjësitë për progres drejt arritjes së barazisë midis burrave dhe grave;
- (4) Të dhëna të përditësuara në lidhje me përparimin e meshkujve dhe femrave në shoqëri.

Rritja e Pjesëmarrjes së Grave në Vendim-marrje. Qëllimi i këtij prioriteti strategjik është: Të fuqizohen vajzat dhe gratë nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje.

Ky qëllim do të arrihet nëpërmjet këtyre objektivave: (1) Të merren masa për të siguruar aksesin dhe pjesëmarrjen e plotë të vajzave dhe grave në politikë; (2) Të rritet shkalla e përfaqësimit dhe e pjesëmarrjes së grave në vendim-marrje të paktën deri në 30% në të gjithë sektorët vendim-marrës nëpërmjet masave të veçanta të perkohshme; (3) Të rritet pjesëmarrja e grave dhe vajzave në

forcat/misionet paqeruajtëse dhe ato policore; si dhe (4) Të rritet aftësia e grave si qytetare për të marrë pjesë në vendim-marrje dhe drejtim.

Në fund të 2015 arritja e këtyre objektivave do të sjellë këto rezultate të pritshme:

- (1) Në të gjitha nivelet e larta të vendim-marrjes politike dhe proceseve zgjedhore zbatohet kuota e përfaqësimit 30% për gjininë më pak të përfaqësuar;
- (2) Në të gjitha nivelet e larta të vendim-marrjes zbatohet kuota e përfaqësimit 30% për gjininë më pak të përfaqësuar;
- (3) Rreth 30% e efektivit të Policisë dhe forcave/misioneve paqeruajtëse janë femra;
- (4) Mbështetja dhe rritja e kapitalit social të grave lehtëson angazhimin e tyre qytetar.

Fuqizimi Ekonomik. Qëllimi i këtij prioriteti strategjik është: Të sigurohet fuqizimi ekonomik i grave dhe burrave nëpërmjet adresimit të pabarazive gjinore që çojnë në varfëri dhe promovimit të përfshirjes sociale.

Ai do të arrihet nëpërmjet këtyre objektivave: (1) Të rritet pavarësia ekonomike e grave nëpërmjet shtimit dhe përmirësimit të aksesit në kreditim, programeve dhe strukturave mbështetëse për kujdes dhe mbrojtje shoqërore; (2) Të vazhdojë të nxitet formimi profesional dhe punësimi i grave dhe vajzave nëpërmjet masave që mbështesin pjesëmarrjen e grave në tregun e punës; si dhe (3) Të nxitet zgjerimi i programeve për punësimin e grave dhe vajzave.

Në fund të 2015 arritja e këtyre objektivave do të sjellë këto rezultate të pritshme:

- (1) Pjesëmarrja e femrave në forcat prodhuese të punës do të rritet me 21% (nga 44% në 65%);
- (2) Zvogëlimi i papunësisë në 10% (për femrat nga 16% në 10% dhe për meshkujt nga 12% në 10%);

(3) Ulja e varfërisë në zonat rurale me 10% dhe përafrimi i niveleve të varfërisë me ato të qytetit;

(4) Rritja e pjesëmarrjes së grave në sektorin privat me 30%.

Zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtij prioriteti strategjik është: Të rritet ndërgjegjësimi ndaj dukurisë së dhunës me bazë gjinore, mbrojtja ligjore dhe administrative, si dhe mbështetja me shërbime për viktimat e dhunës dhe dhunuesit.

Ky qëllim arrihet nëpërmjet këtyre objektivave: (1) Të ashpërsohet dënimi i dhunës nëpërmjet një kuadri ligjor me tolerancë zero ndaj dhunës; (2) Të parandalohet dhuna me bazë gjinore nëpërmjet ndërgjegjësimit të vazhdueshëm në çdo hallkë të shoqërisë shqiptare; (3) Të mbrohen dhe të mbështeten viktimat e dhunës dhe dhunuesit nëpërmjet shërbimeve të ndjeshme ndaj dhunës dhe të përshtatura për viktimat, pa dallim aftësie; si dhe (4) Të ngrihen kapacitetet e administratës publike në nivel qendror dhe vendor për çështjet e dhunës me bazë gjinore.

Në fund të 2015 arritja e këtyre objektivave do të sjellë këto rezultate të pritshme:

(1) Kuadër ligjor i ashpër për tolerancë zero ndaj dhunës;

(2) Kulturë e përmirësuar kundër dhunës nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit;

(3) Masa dhe shërbime të përshtatshme për të mbijetuarit/at e dhunës – duke iu referuar shërbimeve mbështetëse, këshilluese dhe shërbimeve të tjera të sistemit, sistemit të referimit;

(4) Punonjësit në strukturat shtetërore i përgjigjen nevojave/ të drejtave të viktimave të dhunës dhe dhunuesve dhe i adresojnë ato;

(5) Sistemi i ngritur i mbledhjes së të dhënave dhe monitorimit të DHBGJ.

Grupet e Synuara me Përparësi

SKBGJ-DHBGJ është e ndjeshme ndaj nevojave dhe të drejtave të të dyja gjinive dhe bën përpjekje të adresojë këto nevoja dhe të drejta me ndërhyrje gjithëpërfshirëse. Megjithëse nga studimet e situatës

tregohet që gratë kanë disavantazhe më të mëdha në të gjitha fushat, kjo nuk do të thotë që djemtë dhe burrat janë më të privilegjuar në çdo aspekt të jetës shoqërore në Shqipëri. Për më tej, grupe të caktuara të grave provojnë disavantazh me të theksuar që rrjedh nga situata të lidhura me aftësitë e kufizuara, origjinën shoqërore dhe etnike apo orientimin e tyre seksual. Ndërsa strategjia adreson nevojat e të gjitha grave dhe burrave, më poshtë bëhet një analizë e shkurtër për grupet që janë lënë në hije nga ndërhyrjet e SKBGJ-DHF 2007-2010 dhe që do të kenë një vëmendje të posaçme në SKBGJ-DHBGJ 2011-2015.

Gratë me aftësi të kufizuara. Megjithë përpjekjet e nisura për të adresuar nevojat dhe të drejtat e vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara me politika dhe programe shtetërore, situata e tyre duhet të fitojë më shumë dukshmëri shoqërore dhe vëmendje politike. Sipas statistikave të MPÇSSHB janë 18.880 vajza gra me aftësi të kufizuara që përfitojnë nga skema e invalidëve të punës. Në vijim, mungojnë të dhënat në lidhje me gjendjen e tyre, nevojat specifike që ato kanë për shërbime shëndetësore dhe sociale, për edukim, punësim, për aktivitete⁵². Për të ndrequr këtë situatë, në këtë strategji nevojat e vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara janë të shprehura specifikisht ose janë të integruara në të gjitha aspektet e fushave prioritare. Kjo strategji inkurajon gjithashtu rishikim të adresimit të nevojave të vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara në strategjitë sektoriale që duhet të adresojnë ndjeshëm edhe këto nevoja.

Gratë në zonat rurale. Gratë në zonat rurale e gjejnë veten në një situatë më të vështirë përballe diskriminimit në krahasim me ato në zonat urbane. Popullsia që jeton në zonat rurale nuk përfshihet në të dhënat e papunësisë së vendit, për sa kohë që forca punëtore në këto zona konsiderohet si e vetë-punësuar në ekonomitë familjare bujqësore dhe si rezultat nuk mund të përfitojnë nga skemat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Gratë janë veçanërisht të prekura nga kjo dukuri. Realiteti tregon se kontributi i tyre në familjen bujqësore shihet nga anëtarët e saj jo si punësim, por si veprimtari mbështetëse e familjes, pra si punë e papaguar. Kjo, e ndërthurur me

⁵² (Grupi i Grave Intelektuale me Aftësi të Kufizuara, 2009)

përfshirjen e ulët të grave rurale në vendimmarrjen familjare⁵³ sjell për pasojë mospagimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe rrjedhimisht varfërinë dhe pasigurinë ekonomike të këtyre grave me arritjen e moshës së pensionit. Edhe ato gra që punojnë në sipërmarrje private në fshat rëndom nuk kanë sigurime shoqërore. Gjithashtu, gratë humbën më shumë vende pune sesa burrat gjatë ndryshimeve strukturore të ekonomisë dhe pasuritë që më parë zotëroheshin nga shteti ose kooperativa, pas viteve '90-të, u regjistruan përgjithësisht në emër të burrave. Si pasojë, gratë janë të varura financiarisht gjithnjë e më tepër nga burrat. Në të njëjtën kohë, për shkak të përgjegjësive shtëpiake, përfshirë kujdesin për fëmijët dhe të moshuarit, ato nuk mund të punësohen në biznese të tjera. Gratë fermere janë si prodhuese të ushqimeve, ashtu edhe tregtare ashtu si dhe përkujdesëset e familjes. Ato luajnë një rol të rëndësishëm si në komunitet ashtu edhe në ekonominë kombëtare. Megjithatë puna e tyre nuk kompensohet financiarisht. Gratë rurale nuk kanë mundësi reale për t'u bërë pjesë e pasurive sociale siç mund të jenë rrjetet, shoqatat apo kooperativat. Kjo e dobëson shumë pozicionin e tyre për të ushtruar ndonjë ndikim mbi proceset vendim-marrëse dhe mbi përfaqësimin kolektiv (për një informacion të detajuar, shikoni Çela & Arqimandriti, 2010). Nëse nuk specifikohet ndryshe, SKBGJ-DHBGJ përfshin edhe nevojat e vajzave dhe grave në zonat rurale në tre fushat prioritare, të pjesëmarrjes në vendim-marrje, fuqizimit ekonomik dhe reduktimit të dhunës me bazë gjinore.

Vajzat dhe gratë në nevojë. Në këtë grup përfshihen me përparësi vajzat dhe gratë nga komuniteti rom dhe egjiptian, vajza dhe gra të trafikuar, të dhunuara, gra kryefamiljare në zonat urbane dhe rurale ose grate e prekura nga HIV/AIDS. Megjithëse nuk ka studime specifike për këto grupe, nga raporte të ndryshme të zhvillimit njerëzor, vajzat dhe gratë në këto kategori kanë mundësi më të lartë për të qenë në varfëri dhe në varfëri ekstreme si pasojë e arsimimit të ulët, mos-pjesëmarrjes në tregun e punës apo emigracionit të bashkëshortëve, ndërmjet arsyeve të tjera. Puna e nisur nëpërmjet SKBGJ-DHF 2007-2010 për fuqizimin e grave në këtë kategori do të

⁵³ INSTAT, Anketa Demografike e Shëndetit, 2009

vazhdojë nëpërmjet ndërhyrjeve të ndryshme përfshirë programe të formimit profesional dhe nxitjes së punësimit.

Djemtë dhe burrat. Shumë prej politikave që synojnë barazinë gjinore synojnë fuqizimin e grave dhe lënë në hije rolin e burrave në këtë proces. Por vajzat dhe gratë nuk mund të arrijnë barazi gjinore pa bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e burrave. Përvoja të pakta në Shqipëri kanë treguar që djemtë dhe burrat duan të përfshihen dhe janë përfshirë në ndërhyrje që synojnë barazinë gjinore. Nga përvoja e OJF-ve është vënë re gjithashtu që kur burrave që drejtojnë jetën komunitare, sidomos në fshatra, u jepet informacion dhe të dhëna për situata të caktuara, si për shembull kujdesi për fëmijërinë e hershme, apo dhunën me bazë gjinore ata bëhen aleatë në ndërhyrje. Megjithatë, deri më sot përfshirja e djemve dhe burrave ka qenë sporadike dhe e lënë në dorë të rastësisë. Nuk ka studime që tregojnë se si mund të përfshihen burrat në arritjen e qëllimeve të barazisë gjinore dhe studime që tregojnë efektin e normave sociale që përforcojnë perceptime tradicionale që lidhen me ç'do të thotë të jesh burrë në realitetin shqiptar. Për shembull nga vlerësimi i situatës, u pa që një tendencë e fundit është ulja e numrit të djemve në ndjekjen e arsimit të lartë dhe futja e tyre në tregun e punës, krahasuar me vajzat. Është e mundur që sistemi arsimor të inkurajojë sisteme të ndryshme vlerash për djemtë dhe vajzat çka mundëson pritshmëri të ndryshme për të dyja gjinitë. Por këto deri më sot kanë mbetur në nivelin e konstatimeve.

Nëpërmjet ndërhyrjeve të parashikuara, Strategjia bën përpjekje për të inkurajuar djemtë dhe burrat të tejkalojnë kufinj të prerë të ndarjes sipas përkatësisë gjinore në shtëpi, në punë dhe në komunitet. Strategjia inkurajon që studimet e planifikuara për gratë në Shqipëri të integrojnë ose të paralelizojnë edhe studime që tregojnë se si djemtë dhe burrat dëmtohen jo pak nga stereotipet gjinore. Sesionet ndërgjegjëse që bëjnë çështjet gjinore të dukshme dhe të rëndësishme për burrat do të synojnë të vënë në dukje përfitimet që kanë dhe burrat si anëtarë të familjeve dhe të komuniteteve nga barazia gjinore. Strategjia planifikon veprime ndërgjegjëse në lidhje me efektet e diskriminimit gjinor në njerëzit e tyre të afërt, bashkëshortet, partneret, ose fëmijët; adoptimin nga ana e burrave e

roleve gjinore më fleksibël për të ndërtuar një të ardhme më të qëndrueshme, stresi që përjetojnë gratë nga ndarja e padrejtë e punës, dhe efekti i kësaj në shëndetin e tyre dhe të grave, prindërimi.

Roli i Parashikuar i Qeverisë në Lidhje me Palët e Interesuara

Ndërhyrjet në fushat e përcaktuara prioritare të Strategjisë nuk mund të kryhen vetëm nga qeveria qendrore dhe vendore. Një shoqëri me barazi gjinore dhe e lirë nga dhuna kërkon angazhimin e shumë aktorëve të tjerë. Qeveria Shqiptare i inkurajon këta aktorë të përfshihen aktivisht në arritjen e qëllimeve të kësaj strategjie. Shkurtimisht, roli i këtyre aktorëve dhe marrëdhëniet që parashikon qeveria në nivel qendror dhe lokal me to përshkruhen më poshtë.

Sektori Privat

Sektori privat është një aleat i ngushtë në zbatimin e Strategjisë. Qeveria inkurajon aktorët në sektorin privat të promovojnë në praktikat e tyre dhe kodet e përgjegjësisë dhe etikës sociale parimet dhe vlerat e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit. Është koha për sektorin privat që të krijojë një mjedis aftësues që përdor potencialin dhe talentet e grave dhe të burrave dhe të zhvillojë strategji të burimeve njerëzore që lejojnë për politika të ndjeshme ndaj familjes edhe në kontekstin e veprimtarive ekonomike 24-orëshe në sektorin privat. Shoqëritë tregtare duhet të marrin parasysh përdorimin e kohës dhe modelet jetësore të grave dhe burrave, përgjegjësitë e tyre për kujdesin ndaj fëmijëve dhe familjeve si dhe kërkesat si rrjedhojë e aftësive të tyre të kufizuara dhe të krijojnë hapësira që akomodojnë këto nevoja. Këto rregullime kanë nevojë të zhvillohen në partneritet me shtetin dhe aktorë të tjerë.

Sigurisht, një përjasje gjinore në aktivitetin ekonomik ndikon pozitivisht në rritjen e prodhimit. Megjithatë, zbatimi i parimeve të barazisë gjinore nuk kufizohet vetëm këtu; ky parim nënkupton edhe që marketimi i mallrave dhe shërbimeve nuk duhet të bazohet në imazhe që denigrojnë apo përjashtojnë gruan dhe të propozojnë modele që riprodhojnë stereotipet lidhur me atë se çfarë duhet të bëjnë burrat dhe gratë, sidomos në punët e shtëpisë. Sektorin privat mundet që në mënyrë pro-aktive të vendosë tonin për marketing të ndjeshëm

gjinor dhe të angazhohet në një projekt kombëtar për të transformuar mendësitë dhe qëndrimet. Kjo gjithashtu do të thotë që shoqëritë tregtare të zgjedhin për të sponsorizuar edhe në mënyrë të përshtatur veprimtari të tilla si ato sportive që në mënyrë të dukshme përpiqen të rrisin profilin e vajzave dhe grave në sporte dhe të promovojnë akses të barabartë gjinor në sporte dhe aktivitete kulturore.

Media


Media luan rol kyç në arritjen e barazisë gjinore dhe ndërgjegjësimin në lidhje me dhunën me bazë gjinore. Mediat mund të rrisë shkallën e informimit për gra të shumë kategorive, të cilat ndeshen me mungesa në këtë fushë. Për shembull, njohja e grave rurale dhe grave me aftësi të kufizuara me të drejtat e tyre ligjore dhe institucionet ku duhet të drejtohen në raste që kërkojnë ndërhyrje juridike ndikon në rritjen e aksesit të tyre në sistemin e drejtësisë. Ky informim bëhet përmes informacionit të shpërndarë nëpërmjet medias së shkruar dhe elektronike, në një formë të tillë që të jetë i përshtatshëm edhe për gratë me aftësi të kufizuara, përfshirë ato në shikim, dëgjim, apo probleme mendore. Media mund të kontribuojë gjithashtu duke prezantuar një tablo realiste të aftësive dhe potencialit të grave dhe burrave në shoqërinë shqiptare dhe të shmangë portretizimin e tyre në një formë denigruese, fyese dhe veçuese. Qeveria shqiptare fton dhe inkurajon organizatat mediatike të luajnë një rol më aktiv, jo vetëm në zbatimin e parimeve të Strategjisë, por edhe të bëhen aktorë kryesorë në ndryshimin e qëndrimeve dhe mendësive. Kjo mund të bëhet duke dhënë mesazhe, duke krijuar forume për dialog gjithpërfshirës mbi transformimin e marrëdhënieve gjinore, duke ngritur pyetje në lidhje me stereotipet, duke shërbyer si monitorë për të nxitur llogaridhënien e strukturave publike në respektimin dhe krijimin e kushteve për realizimin e të drejtave të grave, si dhe për zbatimin efektiv të Strategjisë. Si të gjithë aktorët e tjerë, qeveria i fton mediat të zhvillojnë politikat e tyre gjinore gjithpërfshirëse, të bashkëpunojnë me kolegë dhe shoqata profesionale për të hartuar udhëzime për industrinë e medias, si dhe të inkurajojnë dhe vlerësojnë aplikimin e tyre.

Partitë Politike

Partitë politike kanë përgjegjësinë e veçantë për të shpejtuar aplikimin e masave për të rritur proporcionin e grave jo vetëm si kandidatë, por edhe si parlamentare të zgjedhura dhe si ministre si dhe në qeverinë lokale. Në të gjitha partitë dhe brenda Parlamentit duhet të ketë tolerancë zero ndaj gjuhës dhe sjelljes që është abuzive, përjashtuese dhe nënvlerëson gratë, si dhe sulmeve personale ndaj kandidatëve që në mënyrë të dukshme shprehin një kahje kundër grave. Programet e partive duhet të përfshijë dukshëm pozicionin e tyre në lidhje me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në të gjitha fushat tematike dhe sektoriale. Kandidatët meshkuj dhe femra duhet të informohen në lidhje me politikën mbi barazinë gjinore gjithpërfshirëse dhe fuqizimin e grave.

Organizatat Jo Fitimprurëse

Organizatat Jo-Fitimprurëse (OJF) dhe grupet e tjera të interesit luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e SKBGJ-DHBGJ. OJF-të, sidomos organizatat e grave, kanë qenë në krye të aksioneve dhe mobilizimit për të arritur të drejtat e grave dhe për të hartuar axhendën për barazi gjinore, për të denoncuar dhe për të bërë fushatë për dhunimin e të drejtave të grave, përfshi edhe dhunën dhe abuzimin me bazë gjinore. Ato luajnë një rol të rëndësishëm brenda Strategjisë për të krijuar një tërësi pro-aktive, të fortë dhe vibrante për barazinë gjinore gjithpërfshirëse, për t'i kërkuar llogari qeverisë për angazhimet për barazinë gjinore, për të zhvilluar aleanca të gjera për të adresuar çështje që lidhen me përfaqësimin e ulët të gruas në sfera të ndryshme të jetës publike, pjesëmarrjen e tyre pa dallim aftësie në zhvillimin ekonomik të vendit, për të komentuar dhe të paraqitur propozime në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e ndërhyrjeve programatike të qeverisë. OJF-të mund të jenë partnerë strategjikë në hartimin e programeve pjesëmarrëse gjinore gjithpërfshirëse për zhvillim lokal dhe kombëtar. Në zbatimin e Planit të Veprimit, autoritetet publike do të vazhdojnë të punojnë në partneritet me këta aktorë. Qeveria vlerëson kontributin e tyre dhe është e bindur që një partneritet efektiv mund të ndihmojë qeverinë për të arritur objektivat e saj. Një shprehje e këtij vlerësimi është edhe mbështetja dhe delegimi i shërbimeve të parashikuara nga shteti për t'u ofruar nga OJF-të. Ku është e përshtatshme, fondet do të jepen nga qeveria si pjesë e marrëdhënies financuese me OJF-të në vend.

**Modeli Logjik i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me
Bazë Gjinore 2011-2015**

KAPITULLI 3

POLITIKAT

Ky kapitull përshkruan dhe analizon politikat kryesore sipas prioriteteve strategjike të cilat do të ndihmojnë për arritjen e qëllimit të Strategjisë. Ai përmend edhe strategjitë sektoriale të cilat janë të lidhura me këto politika.

Përqasja në zbatimin e kësaj strategjie është integrimi gjinor. Në zbatim të Deklaratës dhe Planit të Veprimit të Pekinit dhe në zbatim të LBGJSH, integrimi gjinor kërkon ndryshime në metodat institucionale të punës, dhe përgjegjësi të shprehura qartë për promovimin e barazisë gjinore. Në të vërtetë, pabarazitë gjinore mund të trajtohen efektivisht vetëm kur politikat në të gjitha fushat (p.sh., ekonomi, shëndet, arsim, mjedis, infrastrukturë, tregti, shkencë dhe kërkime, bujqësi, mbrojtje dhe siguri) hartohen në mënyrë të tillë që të adresojnë çështjet, nevojat dhe shqetësimet specifike si të burrave dhe të grave, ndërsa mbështetemi në kapacitetet, mundësitë dhe kontributet e tyre respektive. Gjithashtu, integrimi gjinor nënkupton që gratë dhe burrat kanë nevojë të jenë njëjloj të përfshirë në vendosjen e qëllimeve dhe në hartimin e strategjive dhe planeve në mënyrë të tillë që të gjitha ndërhyrjet të jenë të ndjeshme ndaj përkatësisë gjinore. Në këtë mënyrë, prioritetet dhe nevojat e të dy seksëve adresohen dhe merren në konsideratë. Për të integruar barazinë gjinore, në këtë strategji planifikohen një sërë hapash që janë thelbësore:

- Marrja e të **dhënave të ndara sipas gjinisë** dhe informacion cilësor mbi situatën e grave dhe të burrave;
- Bërja e **analizës gjinore** duke nxjerrë në pah dallimet midis dhe ndër gratë, burrat, vajzat dhe djemtë në lidhje me shpërndarjen relative të burimeve, mundësive, shqetësimeve, dhe pushtetit, në

një kontekst të caktuar. Analiza gjinore krijon bazën për integrimin gjinor dhe është e nevojshme për të përcaktuar nëse nevojiten veprime specifike, gjithpërfshirëse për gratë ose burrat, përveç aktiviteteve integruese. Që kjo analizë të bëhet me profesionalizëm, në çdo proces të hartimit të një politikë apo strategjie duhet të përfshihet medoemos nëpunësi i barazisë gjinore, gjë që sigurisht kërkon në radhë të parë emërimin e tij/saj me kohë të plotë si dhe trainimin dhe specializimin e vazhdueshëm të këtij nëpunësi lidhur me integrimin gjinor në fushën përkatëse që mbulon ajo ministri apo institucion. Gjithashtu, një masë që do të siguronte më shumë integrim gjinor është edhe kujdesi nga ana e drejtuesve të institucioneve që grupet e punës për hartimin e politikave apo strategjive të kenë përfaqësim me jo më pak se 30% nga secila gjini;

- Vendosija e një **sistemi monitorimi dhe vlerësimi, të ndjeshëm ndaj përkatësisë gjinore**, duke përfshirë vendosjen e treguesve për të matur deri në ç' masë objektivat e barazisë gjinore plotësohen dhe si u arritën ndryshimet në marrëdhëniet gjinore;
- **Buxheti gjinor** parashikon identifikimin dhe pasqyrimin e ndërhyrjeve të nevojshme për të adresuar hendekun gjinor në politikën, planet dhe buxhetet e sektorëve të qeverisë qendrore dhe vendore; analizën e ndikimit të ndryshëm mbi gratë dhe burrat, të politikave që ngrenë të ardhura dhe shpërndarjen e drejtë dhe të qëllimshme, si të burimeve të brendshme financiare ashtu edhe ato të ardhura si ndihmë e huaj për të ndikuar në zvogëlimin e hendekut mes grave dhe burrave.

Politikat mbi Mekanizmin Institucional dhe Ligjor

Zbatimi i ndërhyrjeve të planifikuara në strategji kryhet nga Mekanizmi Institucional dhe institucionet përkatëse në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Ndërsa pjesëmarrja e partnerëve të tillë, si partitë politike, OJF-të, media dhe bizneset private (shihni Kapitullin 2) është thelbësore, forcimi i strukturave brenda mekanizmit shtetëror, në nivel ministrie dhe qeverisjeje vendore nëpërmjet plotësimin me burime të mjaftueshme njerëzore, ngritje kapacitetesh për monitorim dhe linja të qarta komunikimi dhe

Ilogaridhënieje, mundëson efektivitetin në mbështetje të programeve të mirëformuara që sjellin rrjedhojat e përmenduara në Kapitullin 2. MPCSSH dhe veçanërisht Drejtoria e Administratës Publike (DAP) si dhe strukturat përgjegjëse në nivel lokal duhet të koordinojnë ndërhyrjet në këtë çështje ndërsektoriale.

Ngritja e Mekanizmit Shtetëror është diktuar nga ligji për të monitoruar dhe për të siguruar zbatimin e LBGJSH dhe parimin e mosdiskriminimit dhe barazisë midis grave dhe burrave. Në thelb të përmirësimit të mekanizmit ligjor dhe institucional janë tre drejtime kryesore: (1) forcimi i mekanizmit institucional; (2) rishikimi i legjislacionit nga këndvështrimi gjinor në përshtatje me dokumentat ndërkombëtarë të ratifikuar nga Shqipëria; si dhe (3) rritja e kapaciteteve të autoriteteve qendrore dhe vendore për zbatimin dhe monitorimin e legjislacionit dhe strategjisë për barazinë gjinore në Shqipëri. Ndërsa asnjë strategji sektoriale nuk adreson çështjet e forcimit të mekanizmit shtetëror për barazi gjinore, ndërhyrjet e planifikuara në këtë prioritet, sidomos ato që lidhen me emërimin e NGJ, rishikimin e strategjive sektoriale për integrim gjinor dhe mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave gjinore janë të aplikueshme për çdo sektor/ministri. Politikat në këtë prioritet strategjik ndihmojnë në arritjen e qëllimit strategjik 2 të SKZHI që lidhet me forcimin e shtetit demokratik, të së drejtës dhe lirive.

Forcimi i Mekanizmit Institucional

Politika në lidhje me forcimin e Mekanizmit Shtetëror drejtohet ndaj DPSHBF dhe NGJ në nivel të qeverisë qendrore dhe NGJ në nivelin e qeverisë vendore. Në nivel qendror, DPSHBF duhet të forcohet me ngritjen e një Sektori Monitorimi. Për më tej, monitorimi dhe zbatimi i angazhimeve të qeverisjes qendrore për barazinë gjinore mundësohet nga emërimi dhe trainimi i NGJ në të gjitha ministrinë. Në nivel lokal, duhet të vijohet me emërimin e NGJ-ve në bashkitë dhe komunat e vendit për të monitoruar zbatimin e angazhimeve të qeverisjes vendore për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore.

Harmonizim i Legjislacionit dhe Integrimi Gjinor

Ky drejtim përqendrohet në miratimin e një pakete amendamentesh që sigurojnë përputhjen e legjislacionit shqiptar me CEDAW dhe BE, përfshirë sqarimin e çështjes së vetëzbatueshmërisë së CEDAW, në mbështetje të rekomandimit të përsëritur të Komitetit të CEDAW. Për më tej, të gjitha strategjitë sektoriale duhet të rishihen për te evidentuar masën në të cilën ato integrojnë barazinë gjinore në Planet e tyre të Veprimt. Duhet të zhvillohen analiza gjinore dhe planifikimi paraprak me qëllim që të identifikohen aspekte specifike të kulturës së ndarjes së punës, aksesit dhe kontrollit të burimeve, me qëllim që të kuptohen implikimet e tyre. Strategjia gjithashtu angazhohet që gjinia të integrohet në të gjitha strategjitë sektoriale që kanë ndikim të rëndësishëm në zhvillim dhe të përforcojë koordinimin e veprimeve në këto strategji për të siguruar që të gjitha sinergjitë shfrytëzohen. Strategjia do të vazhdojë të ndikojë që gjinia të integrohet nëpërmjet proceseve menaxheriale që lidhen me hartimin dhe zbatimin e programeve buxhetore sektoriale.

Rritja e Kapaciteteve për Zbatimin dhe Monitorimin e Legjislacionit dhe Strategjisë

Rritja e kapaciteteve të aktorëve qeveritarë në nivel qendror dhe vendor është e rëndësishme për të siguruar transformim gjinor të qëndrueshëm. Pritet që një proces i tillë të çojë në kuptim, zbatim dhe monitorim më të mirë të programeve të barazisë gjinore. Ndërtimi i kapaciteteve shtetërore për të interpretuar dhe përdorur statistikat gjinore gjithëpërfshirëse do të bëhet nëpërmjet trainimit të zyrtarëve për të mbledhur dhe për të përdorur statistikat gjinore. Grupi për Strategji, Buxhetim dhe Integrim në çdo ministri do të trainohet për të integruar përkatësinë gjinore gjithëpërfshirëse në zbatimin e SPI-së (përfshirë përgatitjen e Planeve të Integruara të Ministrisë dhe Planeve Monitoruese të Ministrisë). Aktivitetet e përfshira në këtë politikë kanë të bëjnë edhe me kuptimin e drejtë të konceptit të menaxhimit mbi bazën e rezultateve (përkundër menaxhimit mbi bazën e aktiviteteve) si dhe rritjen e kapaciteteve për monitorim të inspektoriateve shtetërore. Grupet e synuara përfshijnë ministrinë, autoritetet qendrore dhe vendore dhe ekspertë të ndryshëm.

Politikat mbi Pjesëmarrjen e Vajzave dhe Grave në Vendimarrje

Barazia gjinore është pjesë përbërëse e forcimit të demokracisë – procesi është i paplotë nëse nuk ka politika, masa dhe praktika që synojnë të zvogëlojnë pabarazitë midis burrave dhe grave në të gjitha sferat e jetës dhe të përafrojnë demokracinë me përkatësinë gjinore. Demokracia duhet të transformojë marrëdhëniet e pushtetit midis burrave dhe grave duke promovuar shpërndarjen e barabartë të pushtetit dhe influencës midis grave dhe burrave. Si një dimension ndërsektorial i demokracisë, përkatësia gjinore adresohet nëpërmjet integritit gjinor dhe pjesëmarrjes aktive të grave në vendim-marrje. MPÇSSHB, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Drejtoria e Administratës Publike si dhe strukturat përgjegjëse në nivel lokal duhet të koordinojnë ndërhyrjet në këtë çështje ndërsektoriale. Për të arritur këtë, do të monitorohen strategji të ndryshme sektoriale ekzistuese dhe në proces (shihni Planin e Veprimit për këtë fushë prioritare). Arritjet në këtë fushë prioritare do të kontribuojnë në arritjen e qëllimit strategjik 3 të SKZHI për arritje të një zhvillimi të shpejtë, të balancuar dhe të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror e njerëzor të vendit.

Politika kryesore nën këtë prioritet strategjik është aplikimi i masave të veçanta. Neni 9 dhe 22 i LBGJSH e angazhon qartësisht qeverinë shqiptare për të ndërmarrë masa të veçanta për fuqizimin e grave në Shqipëri. Siç u përcoll nga analiza e kushteve aktuale, sektorë të ndryshëm të jetës politike dhe publike nuk kanë drejtpeshim gjinor. Gratë mbeten pak të përfaqësuara në nivele të larta të administratës dhe politikë. Për të korrigjuar këto situata merren masa të veçanta që inkurajojnë pjesëmarrjen e gjinisë më pak të përfaqësuar si për shembull, politika rekrutimi që favorizojnë për një kohë të kufizuar gjininë më pak të përfaqësuar.

Në vazhdim të përpjekjeve të bëra nga Strategjia e mëparshme për rritjen e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në vendim-marrje dhe në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1325, ndërmerren këto politika.

Rritja e Pjesëmarrjes së Grave në Vendim-marrjen Politike

Politikat kryesore synojnë përmirësimin e Kodit Zgjedhor me synim forcimin e dispozitave që garantojnë kuotën 30% të pjesëmarrjes së grave në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale, inkurajojnë nisma që rrisin përfaqësimin e grave në nivel vendor, si p.sh., arritja e një konsensusi politik për një rritje të përfaqësimit të grave, si kryetare komunash/bashkive ashtu dhe për anëtare të këshillave të komunave/bashkive, apo të ndërhyhet në planet e zhvillimit të komunave për të integruar gjininë; fushata kombëtare dhe lokale për të mbështetur hyrjen e gruas në politikë, pa dallim origjine, aftësie apo situatë shoqërore; programe të ndërtimit të kapaciteteve për zgjedhjet vendore dhe të përgjithshme me gra kandidatë të mundshme në tri fusha programatike: aftësi udhëheqëse, njohuri social-politike, dhe menaxhim fushate; si dhe monitorimi e respektimi i kuotës prej 30% në nivelet e larta të vendim-marrjes në politikë.

Rritja e Pjesëmarrjes së Grave në Vendim-Marrjen Publike

Politikat synojnë monitorimin e respektimit të kuotës prej 30% në nivelet e larta të vendim-marrjes në administratën publike; ndërgjegjësimin për reduktimin e stereotipeve gjinore në jetën publike; si dhe nxitjen e programeve të aplikimit të kuotave për të përfshirë sa më shumë vajza në degë studimi jotradicionale për to.

Rritja e Pjesëmarrjes së Grave në Efektivat e Policisë dhe Misioneve Paqeruajtëse

Aplikimi i masave të diskriminimit pozitiv në këtë fushë synon rritjen e numrit të grave dhe vajzave në misionet paqeruajtëse dhe strukturat e policisë. Këto masa shoqërohen me trainimin e efektivave të misioneve paqeruajtëse dhe të strukturave të policisë mbi barazinë gjinore dhe ndërgjegjësimin për reduktimin e stereotipeve gjinore në misionet paqeruajtëse dhe strukturat e policisë.

Rritja e Angazhimit Qytetar të Grave

Ngritja e kapaciteteve për të ndihmuar gratë dhe vajzat, veçanërisht ato me nevoja të veçanta, si gratë me aftësi të kufizuara ose ato që u takojnë minoriteteve etnike dhe gjuhësore për të forcuar vetë-

vlerësimin e tyre dhe për t'i aftësuar për angazhim qytetar dhe angazhimi i tyre në nisma qytetare për të rritur llogaridhënien e autoriteteve publike lidhur me masat që ata marrin për të adresuar e mirëqenien dhe të drejtat e grave është një fushë politikash për rritjen e angazhimit qytetar të grave. Megjithatë, këto përpjekje duhet të shoqërohen nga një mbështetje e fuqishme për shoqërinë civile, si për shembull, hapësira për financimin e projekteve që fokusohen në çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore dhe krijimin e një fondi të veçantë për zhvillimin e Lëvizjes së Gruas.

Politikat mbi Fuqizimin Ekonomik

Fuqizimi ekonomik i vajzave dhe grave, në moshë për të punuar, luan rol shumë të rëndësishëm si në arritjen e barazisë gjinore në realitet ashtu edhe në zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore. Nëpërmjet aksesit të përmirësuar në burimet ekonomike ç'ka rezulton në fuqizim ekonomik të grave, ato fitojnë zë më të fortë dhe fuqi negociuese në familje, bëhen aktore më të barabarta në komunitet dhe shoqëri në përgjithësi. Lipset të koordinohen veprime në tre fusha që çojnë në fuqizimin ekonomik të grave. Së pari, rritja e pavarësisë ekonomike vjen nëpërmjet aksesit të përmirësuar në asete financiare dhe prona, si dhe drejtpeshimit të jetës profesionale dhe asaj familjare. Së dyti, formimi profesional dhe së treti nxitja nëpërmjet programeve të punësimit u japin mundësi sidomos grave të grupeve në nevojë të shkëputin zinxhirin e varfërisë duke hyrë në tregun e punës. MPCSSH, Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe Ministria e Bujqësisë duhet të koordinojnë veprimet për adresimin e sfidave në këtë çështje ndërsektoriale. Brenda kësaj fushe prioritare do të monitorohen veçanërisht Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, e Arsimit Parauniversitar, e Sigurimeve Shoqërore dhe Mbrojtjes Sociale. Arritjet në këtë fushë prioritare do të kontribuojnë në arritjen e qëllimit strategjik 3 të SKZHI për një zhvillim të shpejtë, të balancuar dhe të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror e njerëzor të vendit.

Rritje e Pavarësisë Ekonomike të Gruas

Në thelb të kësaj nënpolitike është rritja e pavarësisë ekonomike të gruas. Duhet të lehtësohet dhe të inkurajohet aksesit i grave në kreditë

e buta. Rishikimi i legjisllacionit bankar për t'u dhënë mundësi grave, veçanërisht grave me aftësi të kufizuara për të marrë kredi lehtësuese do të mbështetet nga kjo Strategji. Krijimi i fondeve të posaçme për grupet e grave në nevojë dhe grave me aftësi të kufizuara, si dhe mundësi konkrete financimi të nismave pozitive, përmes një fondi të posaçëm, për të promovuar biznesin në zonën rurale, janë një drejtim tjetër në këtë nënpolitikë. Duke marrë në konsideratë faktin se shumë pak gra rurale kanë akses ndaj kredive, është e nevojshme që të ndërmerren politika specifike në favor të lehtësimit të marrjes së kredive për gratë rurale. Të krijohen mundësi shkëmbimi eksperiencash midis një sipërmarrjeje të sukseshme në një zonë rurale me një tjetër ku kjo eksperiencë mungon. Duhet rregulluar dhe monitoruar legjisllacioni mbi zotërimin dhe regjistrimin e pronësisë; amendamentet duhet të adresojnë veçanërisht vakuumin ekzistues ligjor në rastet e martesës ose zgjidhjes së saj. Dhënia e një statusi të qartë ligjor për gruan, e veçanërisht asaj me aftësi të kufizuara, do t'i garantonte pozicionin në pronën e familjes dhe do të thyente zinxhirin që e bën atë të varur financiarisht nga burri dhe familja. Nxitja dhe mbështetja për nisma sipërmarrëse të grave, promovimi i modelit të grave të suksesshme sipërmarrëse duhet të shoqërohet edhe me rritjen e sensibilitetit të këtyre grave biznesmene për të punësuar brenda biznesit të tyre vajza dhe gra, përfshirë gra dhe vajza me aftësi të kufizuara, si dhe krijimin e një lobingu të grave, të cilat merren me biznes dhe që do të synojë në mbështetjen e zhvillimit të bizneseve të drejtuara nga gratë.

Formim Profesional

Që formimi profesional dhe pjesëmarrja në tregun e punës të nxiten, është e rëndësishme që këto nisma të kenë një bazë të forte njohurish. Pikësëpari, synohen studime kombëtare mbi vendin që zënë gratë dhe vajzat në tregun formal dhe informal të punës si dhe për të vlerësuar politikat dhe praktikat e punësimit (stereotipia gjinore në punësim, ngritja në detyrë dhe vlerësimi në punë), përfshirë dallimet në pagë të vajzave dhe grave përfshirë dhe ato me aftësi të kufizuara në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Ky komponent plotësohet nga fushata të ndryshme ndërgjegjësimi dhe trainimi lidhur me barazinë gjinore në tregun privat të punës, detyrimet e punëdhënësve dhe të drejtat e të

punësuarve për të parandaluar shqetësimin seksual, si dhe ndërgjegjësimin për të drejtat dhe përgjegjësitë e punëdhënësve dhe punëmarrësve; stereotipat gjinore në arsim si dhe veprime që synojnë uljen e braktisjes së shkollës nga djemtë dhe vajzat me theks të veçantë vajzat e kategorive të prekshme e në nevojë, dhe bashkëpunimin me mediat për të inkurajuar meshkujt që të përfshihen në aktivitete që lidhen me kujdesin për familjen. Komponenti i tretë brenda kësaj fushe ndërhyrjeje janë programe nxitjeje/aplikim kuotash për të sjellë vajzat dhe djemtë në degë studimi jo-tradicionale, si dhe nxitjen e formimit profesional të grave rurale në përputhje me kërkesat e tregut, nëpërmjet programeve të trainimit.

Programet e Punësimit

Kjo politikë synon zgjerimin e shërbimit të punësimit për gratë dhe vajzat, sidomos ato në nevojë, hartimin e politikave të punësimit me kohë të pjesshme për gratë në nevojë, informimin publik të grave dhe vajzave mbi të drejtën për punësim, legjislacionin e punës, informacion mbi tregun e punës, akses në edukimin dhe formimin profesional, ndërtimin e programeve me subvencionim të pagës për kategori të përjashtuara grash, gratë kryefamiljare, gra e vajza të trafikuarra e të dhunuara, afër moshës së pensionit, invalide ose me aftësi të kufizuara si dhe ngritjen e një fondi të veçantë qeveritar për gratë të nevojë. Monitorimi i programit të nxitjes së punësimit të grave dhe vajzave, sidomos për ato që i takojnë kategorive të grave në nevojë është një komponent i rëndësishëm i kësaj politike.

Politikat mbi Dhunën me Bazë Gjinore

Lufta kundër dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, por edhe dhunën jashtë marrëdhënieve familjare në forma të ndryshme, si përdhunimi, shqetësimi seksual dhe forma të tjera të dhunës seksuale, gjurmimi dhe përndjekja e partneres nga ana e dhunuesit etj.) është një çështje ndërsektoriale me tre aspekte themelore: (1) kuadër të fuqishëm ndërgjegjësues për parandalimin e dhunës; (2) mbështetje e gjithanshme që përmirëson aksesin ndaj institucioneve të fuqizuara për të ofruar reagim më të lartë dhe shërbime më të përshtatshme dhe më të ndjeshme shëndetësore dhe sociale; dhe (3) ndjekje të ashpër penale për dhunuesit. Kështu, plotësimi i kuadrit ligjor dhe zbatimi

rigoroz i këtij kuadri nga nëpunës shtetërorë të mirëtrainuar dhe informuar, aksesit i përmirësuar në organet e zbatimit të ligjit, gjykatat, sistemin e kujdesit shëndetësor, dhe burime të tjera të mbështetjes shoqërore përfshirë punësimin, si dhe rehabilitimin e dhunuesve janë disa nga ndërhyrjet që kërkojnë koordinim nga MPCSSHB, Ministria e Drejtësisë (MD), MASH, Ministria e Shëndetësisë (MSH), Gjykata dhe Policia e Shtetit, dhe Pushteti Lokal.

Një nga qëllimet e Strategjisë është të promovojë një mjedis që mundëson reduktimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe fëmijëve në të gjitha aspektet e jetës politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Pritshmëria e përgjithshme për këtë prioritet strategjik është përmirësimi i sistemit të përgjigjes ndaj DHBGJ. Ndërhyrjet për parandalimin dhe zvogëlimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje do të zbatohen sipas tre politikave kryesore: parandalim, mbështetje dhe ri-integrim si dhe ndjekje penale. Strategjitë kryesore që monitorohen janë ato të Mbrojtjes Sociale, Policisë së Shtetit, Shëndetësisë (në proces) dhe Drejtësisë. Arritjet në këtë fushë prioritare do të kontribuojnë në arritjen e qëllimit strategjik 2 të SKZHI që lidhet me forcimin e shtetit demokratik, të së drejtës dhe lirive dhe qëllimit strategjik 3 të SKZHI për arritjen e një zhvillimi të shpejtë, të balancuar dhe të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror e njerëzor të vendit.

Parandalim dhe Përgjigje ndaj Dhunës

Në thelb të parandalimit të dhunës është përmirësimi i mekanizmit shtetëror. Që të parandalohet dhuna është thelbësore të bëhen ndërhyrje edukuese dhe rriten njohuritë e strukturave, të zhvillohet rrjetëzimi dhe partneritetet, si dhe të shkëmbehen praktikatat e mira. Strategjia parashikon veprime ndërgjegjësuese që kanë si synim të reduktojnë qëndrimet dhe praktikatat zakonore ose traditat që janë të dëmshme për vajzat, si martesat e hershme apo të detyruara dhe vrasjet për nder; veprime ndërgjegjësuese që reduktojnë qëndrime diskriminuuese dhe abuzuese ndaj grave me aftësi të kufizuara dhe atyre që u përkasin minoriteteve.

Mbështetja dhe Ri-integrimi i Viktimave të Dhunës

Në themel të ndërhyrjeve në këtë komponent është ndërtimi i kapaciteteve të të gjithë punonjësve shtetërorë që përballen me viktimat e dhunës. Kështu, parashikohen programe trainimi për dhunën në të gjitha nivelet e Policisë së Shtetit. Planifikohen kurse speciale lidhur me barazinë gjinore, mosdiskriminimin dhe adresimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje të cilat duhet të shtohen dhe/ose përforcohen në kurrikulat e Akademisë së Policisë së Shtetit. Një tjetër drejtim i kësaj politike lidhet me ngritjen e kapaciteteve për gjyqtarët që trajtojnë çështjet e dhunës me bazë gjinore. Kjo konsiston në zhvillimin/përmirësimin/përshtatjen e materialeve informuese për rastet e gjyqimit të dhunës, si dhe rritje të ndjeshmërisë së gjykatësve ndaj dukurisë së dhunës. Në mënyrë të ngjashme, kjo politikë nxit trainimin, aftësimin dhe përgatitjen e materialeve informuese profesionale për profesionistë të tjerë në fushën e drejtësisë, si inspektorë, përmbarues, avokatë, administrata gjyqësore, prokurorë, personeli mjeko-ligjor.

Një aspekt i rëndësishëm i kësaj nënpolitike është të mbrojë sigurinë e viktimave dhe mbështesë gratë dhe fëmijët të mbijetuar të dhunës. Një gjë e tillë kërkon vëmendje të shtuar dhe burime publike për t'u dhënë më shumë mundësi për trainim dhe punësim grave të abuzuara dhe për të lehtësuar akses në strehim me kohë të gjatë dhe kushte lehtësuese. Ndërsa në strategjinë para-ardhëse dhe në zbatim të LDHF janë përcaktuar organet përgjegjëse për parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, bëhet e nevojshme që ato të fuqizohen dhe tani të analizohen për efektivitet dhe qëndrueshmëri. Përpos kësaj, është pilotuar në disa bashki mekanizmi i bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në familje . Në zbatim të nenit 8, pika 8 në LDHF, ky mekanizëm duhet të ngrihet në nivel kombëtar. Paralelisht synohet trajtimi dhe rehabilitimi i dhunuesve. Është e nevojshme të hartohen programe që parashikojnë zvogëlimin e sjelljes së dhunshme të dhunuesve, mbrojtjen e sigurisë së viktimës, promovimin e ndërgjegjësimit të dhunuesve, parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe ri-integrimin e dhunuesve në familje, nëse kjo është zgjedhja e të gjithë anëtarëve të familjes.

Kuadër Ligjor i Përmirësuar

Në qendër të kësaj nën-politike do të jetë amendimet i Kodit Penal për të bërë përdhunimin martesor vepër specifike penale kriminale dhe për të kriminalizuar aktet e dhunës në familje, përfshirë abuzimin sistematik psikologjik dhe ekonomik. Rrjedhojat e këtyre amendimeve do të sjellin ndryshim në punën e prokurorisë në lidhje me trajtimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje si krim. Një tjetër aspekt brenda kësaj politike është reformimi i konceptit të barrës së provës. Gjithnjë e më shumë po bëhet e qartë që dispozitat që lidhen me barrën e përmbysur të provës janë detyrim nga pikëpamja e *acquis communautaire* (AC) – në të gjitha legjislacionet evropiane që janë të detyruara të zbatojnë AC, barra e provës vendoset mbi dhunuesin në raste të dhunës në familje, shqetësimit seksual dhe diskriminimit me bazë gjinore dhe aftësie. Pjesë e këtij reformimi është rishikimi i LDHF, LBGJSH dhe Kodit të Punës (përsa i përket mbrojtjes së viktimave nga diskriminimi me bazë gjinore).

KAPITULLI 4

MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Zbatimi i SKBGJ-DHGDHF do të promovojë dhe institucionalizojë proceset e zhvillimit dhe integritit, në të cilat vajzat dhe gratë, djemtë dhe burrat janë partnerë të barabartë në krijimin e një ekonomie të fortë dhe një shoqërie në të cilën barazia gjinore është normative dhe toleranca ndaj dhunës me bazë gjinore është zero. Monitorimi dhe vlerësimi nuk do të përqendrohet vetëm në zbatimin e aktiviteteve individuale të përcaktuara në Planin e Veprimit. Ky proces duhet të bëjë, në të njëjtën kohë, një vlerësim të kontributit që Strategjia ka sjellë në drejtim të qëllimit strategjik që orienton këtë Strategji, më specifikisht kontributin e saj në drejtim të realizimit të SKZHI-së dhe qëllimet e një sërë instrumentash, si QZHM (veçanërisht QZHM 3 dhe 5), CEDAW dhe PVP. Ky kapitull prezanton një sërë mekanizmash dhe udhëzimesh, si për monitorimin ashtu edhe vlerësimin e strategjisë.

Objektivat e Monitorimit dhe Vlerësimit

Monitorimi dhe vlerësimi i SKBGJ-DHGBGJ do të shërbejë për:

1. Matjen e suksesit dhe ndikimit të ndërhyrjeve për përparimin e barazisë gjinore në realitet dhe zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore;
2. Matjen e efektivitetit dhe ndikimit të strategjisë dhe vlerësimin e ndikimit afatgjatë për gratë në veçanësi dhe për gjithë shoqërinë në përgjithësi.

Treguesit në Nivel Kombëtar

Udhëzimi i MPCSSHB Nr.1220, datë 27.5.2010 (MPCSSHB, 2010) mbi treguesit e monitorim-vlerësimit të barazisë gjinore, dhunës ndaj

grave dhe dhunës në familje është baza e monitorimit të ndërhyrjeve të SKBGJ-DHBGJ. Këta tregues përcaktojnë çfarë të dhënash mblidhen në lidhje me barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore për sektorë të veçantë. Ata u hartuan në konsultime formale të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Indikatorët (GPNI) dhe u aprovuan nga KKBGJ në 2010. Këta tregues do të përdoren për të matur ndryshimet afatgjata, për të vlerësuar progresin, dhe efektivitetin e përgjithshëm të veprimeve të ndërmarra për trajtimin e çështjeve të diskriminimit dhe promovimit të barazisë gjinore, si dhe për zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore. Ato janë të informuar dhe nga Qëllimet e Zhvillimit për Mijëvjeçarin. Piketat (të dhënat bazë) do të botohen në Raportin e Parë Vjetor Kombëtar për Statusin e Grave në Shqipëri që do të përpilohet në 2011. Përveç këtyre treguesve, në kuadër të kësaj Strategjie janë hartuar edhe tregues të tjerë për të matur efektivitetin e performancës së Strategjisë.

Treguesit në Nivel Ndërkombëtar

Shqipëria ka ratifikuar instrumenta të ndryshëm ndërkombëtarë dhe kontribon me të dhëna në raporte ndërkombëtare të cilat vlerësojnë performancën e qeverive të ndryshme në lidhje me arritjen e barazisë gjinore. Raporti i Zhvillimit Njerëzor (UNDP, 1995) i Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim ka formuluar një Indeks të Zhvillimit Gjinor (IZHGJ) dhe një Matës të Fuqizimit Gjinor (MFGJ) të cilët përmbledhin dimensionet e përshkruara në Tabelën 2. Të dhënat që mblidhen nëpërmjet treguesve të sipërpërmendur kontribuojnë si në IZHGJ dhe në MFGJ.

Tabela 2: Indeksi i Zhvillimit Gjinor dhe Matësi i Fuqizimit Gjinor

Indeksi i Zhvillimit Gjinor	Matësi i Fuqizimit Gjinor
Përshtat mesataren e arritjeve për të reflektuar pabarazitë midis burrave dhe grave në tre dimensione	Përqendrohet në mundësitë e grave për të gjetur pabarazitë gjinore në tre fusha kyçe
<i>Jetë e gjatë dhe e shëndetshme</i> siç matet nga pritshmëria për jetën (vdekshmëria) në lindje.	<i>Pjesëmarrje politike</i> dhe fuqi vendim-marrëse, siç matet nga përqindja e vendeve në parlament nga gratë dhe burrat.
<i>Njohuri</i> siç matet nga ritmet e aftësive të shkrimit e këndimit dhe shkallën e regjistrimit bruto të kombinuar në arsimin fillor, të mesëm dhe universitar.	<i>Pjesëmarrje ekonomike</i> dhe fuqi vendim-marrese siç matet nga dy tregues – përqindja e grave dhe burrave në pozicione të tilla si ligjvënës, zyrtarë të lartë dhe drejtues dhe përqindja e grave dhe burrave në pozicione profesionale dhe teknike.
<i>Standard i denjë jetese</i> siç matet nga të ardhurat e fituara të përlogaritura (Barazi në fuqi blerëse shprehur në USD)	<i>Fuqi mbi burimet ekonomike</i> , siç matet nga të ardhurat e fituara të përlogaritura për burrat dhe gratë (Barazi në fuqi blerëse shprehur në USD)

Institucionet Përgjegjëse

Për të siguruar që strategjia përkthehet në veprimtari konkrete duhet të ekzistojnë linja të qarta përgjegjësie dhe struktura të përshtatshme për të arritur rezultate të përbashkëta dhe të synuara në trajtimin e pabarazive gjinore dhe në nxitjen e barazisë gjinore.

Institucionet Përgjegjëse në Nivel Qendror

Ndërsa në nivel parlamentar, çështjet gjinore trajtohen nga Komisioni Parlamentar i Shëndetësisë, Punës dhe Çështjeve Sociale, si për të gjitha ligjet dhe programet shtetërore për çështjet gjinore dhe dhunës me bazë gjinore, autoriteti përgjegjës për zbatimin e Strategjisë është Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Sipas

Ligjit Nr. 9970 dt.24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” organe të tjera përgjegjëse për zbatimin e SKBGJ-DHGDHF janë:

Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta dhe Familjen. Bazuar në Ligjin Nr. 9970 dt.24.07.2008 “Për barazi gjinore në shoqëri” dhe Ligjit Nr. 9669 dt. 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” Ministri e kryen funksionin e mësipërm nëpërmjet strukturës përgjegjëse që është, Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta dhe Familjen (DPSHBF) e cila funksionon që prej vitit 2006. Misioni i saj është “formulimi dhe zhvillimi e politikave për nxitjen e barazisë në fusha të tilla si, barazia gjinore, barazinë/pabarazinë në aftësi, problemet e pakicave etnike, etno-kulturore dhe gjuhësore, pabarazinë moshore, atë brezore e racore etj”. Pas daljes së LMD, kësaj Drejtorie iu ngarkua edhe detyra që të punonte edhe për zbatimin e këtij ligji. DPSHBF përbëhet nga dy sektorë: Sektori i Barazisë Gjinore dhe Për Masat Ndaj Dhunës në Familje dhe Sektori Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. Detyrat e kësaj drejtorie për zbatimin e strategjisë rrjedhin nga detyrat për të cilat kjo drejtori është krijuar. Ato janë:

1. Të formulojë politika për mundësi të barabarta të fokusuara në perspektivën e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të gjitha grave dhe vajzave.
2. Të propozojë nisma për studim dhe analiza në fushën e barazise gjinore dhe shfrytëzimin e këtyre studimeve në procesin e politikave të zhvillimit.
3. Të hartojë akte ligjore të nevojshme për arritjen e barazisë në fusha të ndryshme dhe të zbatojë e monitorojë dispozitat e ligjit për barazi dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij.
4. Të mbikëqyrë zbatimin e marrëveshjeve dhe akteve ndërkombëtare në fushën që mbulon, të cilat miratohen nga Qeveria.
5. Të bashkëpunojë me organizatat jo-fitimprurëse të cilat janë aktive në fushën e barazisë gjinore dhe të sigurojë financim të pjesshëm për projekte apo aktivitete të tyre.

6. Të hartojë strategji dhe politika për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare.
7. Të mbledhë, përpunojë dhe analizojë informacionin e nevojshëm statistikor për dhunën në marrëdhëniet familjare dhe të formulojë politikat në këtë fushë.
8. Të programojë masat për rritjen e kapaciteteve për të gjithë aktorët në nivel qendror e vendor, që janë të angazhuar për kujdesin ndaj viktimave të dhunës në familje.
9. Të krijojë një bazë të dhënash dhe të vendosë lidhjet e bashkëpunimit me OJF-të që veprojnë në këtë fushë.
10. Të sigurojë programet sociale, parandaluese dhe mbrojtëse si dhe masat për reduktimin e dhunës në familje.

Ministritë e Linjës dhe Institucionet Vartëse marrin një sërë masash për zbatimin e strategjisë. Këto përfshijnë:

- ☞ Emërojnë një nëpunësi/eje gjinor/e apo njësi për të lehtësuar veprimet për integrimin gjinor, promovimin e barazisë gjinore dhe për të bashkëpunuar me DPSHBF (Përshkrimi i punës së Nënpunësve Gjinorë është dhënë në Shtojcën 5, Pika A).
- ☞ Komunikojnë me të gjitha drejtoritë brenda një Ministrie linje dhe institucionet vartëse të tyre në lidhje me veprimet për barazinë gjinore;
- ☞ Sigurojnë që stafi është i ndërgjegjësuar dhe kupton perspektivën gjinore dhe çështjet që dalin nga veprime specifike brenda politikave të një ministrie;
- ☞ Identifikojnë veprime të përshtatshme me qëllimet e strategjisë dhe prioritetet e ministrisë për përfshirjen në strategjitë sektoriale;
- ☞ Monitorojnë dhe vlerësojnë veprimet e tyre për të kontribuar në raportet vjetore që evidentojnë zbatimin e Planit të Veprimit të kësaj Strategjie;
- ☞ Diskutojnë dhe zbërthejnë strategjinë me ofrues të tjerë të shërbimeve dhe punojnë me ta për zbatim efektiv;
- ☞ Ndajnë njohuritë, ekspertizën dhe praktikat e mira me të tjerët.

Ministritë (së bashku me institucionet e tyre vartëse) të përfshira në këtë strategji janë MASH, MSH, MB, MD, MM, METE, MF dhe MBUMK.

Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore (KKBGJ) është ngritur me Urdhër të Kryeministrit Nr.3 datë 8.1.2009. Ai është organ këshillimor për politikën gjinore. Me mandat katërvjeçar, KKBGJ drejtohet nga Ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe në përbërje ka 9 zëvendësministra dhe tre anëtarë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile të përzgjedhur nëpërmjet procesit të konkurimit të hapur mbështetur në kriterë që vlerësojnë angazhimin e këtyre organizatave në çështjet e barazisë gjinore. Këshilli mblidhet jo më pak se dy herë në vit dhe detyrat e tij janë:

1. këshillon Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për barazi gjinore, me përjashtim të çështjeve që merren në shqyrtim nga Këshilli Kombëtar i Punës. Për çështje të një rëndësie të veçantë, Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore mund të zhvillojë mbledhje të përbashkëta me Këshillin Kombëtar të Punës;
2. siguron integrimin gjinor në të gjitha fushat, sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore;
3. i propozon Këshillit të Ministrave programet kryesore për nxitjen dhe arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri;
4. vlerëson gjendjen konkrete të barazisë gjinore në vend, duke dalë me udhëzime për strukturën e çështjeve të barazisë gjinore në ministrinë që mbulon çështjet e barazisë gjinore, si dhe propozime e rekomandime për Qeverinë, për përmirësimin e gjendjes;
5. miraton raportin vjetor për çështjet e barazisë gjinore të ministrisë që mbulon çështjet e barazisë gjinore.

Pas aprovimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, KKBGJ do të vazhdojë të këshillojë dhe ndihmojë DPSHB për të monitoruar progresin e veprimeve nga departamentet e ndryshme. Ai do të ndihmojë dhe këshillojë gjithashtu rishikimin e strategjisë në fund të mandatit të saj. KKBGJ do të ndihmojë qeverinë për të siguruar angazhim të vazhdueshëm me përfaqësues të grave dhe të burrave për promovimin e barazisë gjinore.

Institucionet Përgjegjëse në Nivel Vendor

Në nivel vendor Strategjia zbatohet nëpërmjet njësive të pushtetit vendor, prefekturave, bashkive dhe komunave. Koordinimi i Punës bëhet nëpërmjet Nënpunësit vendorë për çështjet gjinore në nivel vendor (Përshkrimi i Punës për Nënpunësit Gjinorë në nivel vendor jepet në Shtojcën 5, Pika B).

Mekanizmat e Monitorimit dhe Vlerësimit

Monitorimi i SKBGJ-DHBGJ mbështetet në mekanizmin e monitorimit të bazuar në rezultate. Baza e këtij mekanizmi është Matrica e Vlerësimit të Rezultateve (MVR) që përmban treguesit për objektiva specifike, të matshëm, të arritshëm, realistë dhe brenda afateve kohore. MVR hartohet nga Ministria që koordinon strategjinë ndërsektoriale e sektoriale në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 137, datë 1.7.2010 “*Për Zbatimin e Procesit të Monitorimit të Strategjive Sektoriale dhe Ndërsektoriale*”. Përgatitja e tabelave të MVR është vjetore si pjesë e kërkesave të Programimit Buxhetor Afatmesëm. Plani i Veprimit dhe Modeli Logjik i Strategjisë shërbejnë si bazë për hartimin e tabelave vjetore të MVR.

Çdo vit, Plani i Veprimit të SKBGJ-DHBGJ 2011-2015 do të vlerësohet dhe në rast nevojë, të rifreskohet për të adresuar sa më mirë çështjet që lidhen me barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. DPSHBF do të koordinojë dhe botojë çdo vit raportin e vlerësimit bazuar në Planin e Veprimit si dhe do të prezantojë ndryshimet në Planin e Veprimit nëse ka të tilla. Drejtoritë përkatëse në ministrinë e linjës që do të zbatojnë ndërhyrjet e planifikuara në Planin e Veprimit do të paraqesin progresin e veprimeve që kanë ndërmarrë, krahasuar me rrjedhojat, duke u fokusuar në synimet dhe me objektivat strategjike të kësaj Strategjie, në bazë të një formati të përcaktuar nga DPSHBF. Ky raport do të përmbajë gjithashtu ilustrime me shembuj dhe praktikë të mira që janë evidentuar në punën e tyre. Për më tepër, me anë të raporteve specifike, drejtoritë do të kontribuojnë veprime të reja që janë identifikuar gjatë vitit për të adresuar pabarazitë gjinore dhe që demonstron integrimin gjinor në të gjitha politikat e tyre.

Burimet Financiare

Mobilizimi i Burimeve

Ndërsa vlerësimi i Strategjisë së mëparshme tregoi që ishte e vështirë të matej sa kishte kushtuar kjo Strategji, përvoja e deritanishme, si në vend dhe jashtë tij tregon që integrimi gjinor kërkon nivele të konsiderueshme financimi, pasi ky është një aktivitet i specializuar dhe që kërkon kohë. Ai kërkon staf të trainuar me njohuri të sakta dhe shërbime të përshtatura për të gjitha kategoritë e qytetarëve që i përdorin këto shërbime, monitorim të detajuar të performancës, statistika të ndara gjinore dhe ekspertë gjinorë në terren. Në të gjitha këto aspekte qeveria duhet të investojë burime operationale përfshirë forcimin e llogaridhënies, menaxhimin e njohurive, kapacitetet dhe ekspertizë. Kjo strategji do të punojë për të krijuar një fond të veçantë dhe vendosë disa synime minimale për të planifikuar buxhete për programim të barazisë gjinore.

Përvoja e krijuar me programe të caktuara si Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore, Barazi në Qeverisje dhe Fuqizimi Politik i grave tregojnë se qeveria mund të eksplorojë partneritete me donatorë të huaj në programe të përbashkëta. DPSHBF duhet të ndërtojë një plan për mobilizimin e burimeve, në të cilin të përcaktohen: (1) Kostim realist i të gjitha aktiviteteve; (2) Analizë e hollësishme e burimeve të brendshme; (3) Analizë e detajuar e burimeve të jashtme; (4) Njëpërmjet DEBASKON-it, lidhje të forta me donatorët bazuar në rrjedhjen e informacionit dhe në shkëmbim të komenteve dhe rekomandimeve.

Ndjekja e Shpërndarjes së Burimeve dhe Shpenzimet

Financimi i SKBGJ-DHF 2007-2010 u bë sipas vullnetit të ministrive të linjës, të cilat kanë mbështetur aktivitete të pjeshme të Planit të Veprimit. MPCSSH ka financuar një pjesë aktiviteteve si dhe pagat e punonjësve të DPSHBF. Aktivitete të veçanta janë financuar nga donatorë të ndryshëm. Ministria e Financave ka një pasqyrë të buxhetimit në vite të strategjisë, e cila ndërkohë që pasqyron mbështetjen financiare të strategjisë në tërësi, nuk tregon financimin e zërave të Planit të Veprimit dhe efektivitetin e burimeve financiare të

përdorura. Mbetet detyrë për Strategjinë e rishikuar diskutimi për procesin e kontroll-revizionit dhe llogaridhënies. MPCSSHB duhet të ndihmojë ministrinë e tjera të identifikojnë dhe monitorojnë shpërndarjen e tyre buxhetore për të zbatuar SKBGJ-DHBGJ 2011-2015 në fushat e veprimtarisë që mbulojnë këto ministri.

Dokumentimi i Procesit të Konsultimeve

Progresi i Strategjisë ndiqet ngushtësisht nga një forum vjetor kombëtar. Një proces i tillë mund të marrë formën e një takimi kombëtar në të cilin aktorë të ndryshëm, përfshirë dhe përfaqësues të shoqërisë civile të ftohen për të raportuar mbi progresin. Takimi duhet të përqendrohet në vlerësimin e rezultateve në bazë të treguesve të dhënë në Planin e Veprimit dhe do të japë udhëzime për punën në të ardhmen.

Ky takim vjetor do të organizohet bashkërisht nga DPSHBF dhe KKBGJ. DPSHBF do të jetë përgjegjëse për të dhënë udhëzimet monitoruese që do të përdoren për të mbledhur informacion në drejtoritë përkatëse të ministrive, organizata të sektorit privat dhe jo-qeveritar. Kjo drejtori do të marrë gjithashtu përgjegjësinë për të siguruar që udhëzimet për monitorim t'u shpërndahen të gjithë aktorëve dhe për mbledhjen e qarkullimin e informacionit që do të prezantohet në takimin vjetor të monitorimit. KKBGJ do të shqyrtojë sa të gjithanshëm janë këta tregues.

Rishikimi i Strategjisë

Strategjia do të zgjasë pesë vjet, deri më 2015. Në fund të pesë vjetëve kjo Strategji do të rishikohet për të vlerësuar efektivitetin e saj duke matur ndryshimet në treguesit e barazisë gjinore dhe të dhunës me bazë gjinore për të dokumentuar pozitën e grave dhe burrave në Shqipëri.

BIBLIOGRAFI

- ACER & ASET. (2010). *The situation of women leaders at the local level in Albania – a baseline analysis* ëSituata mbi gratë udhëheqëse në nivel vendor në Shqipëri – analizë e informacionit fillestarç. Tiranë, Shqipëri: Autorët.
- ACER & ASET. (2008). *Perceptimi publik në lidhje me pjesëmarrjen e grave në zgjedhje në Shqipëri*. Tiranë, Shqipëri: UNIFEM.
- ASC. (2008). *Përkujdesja si punë e papaguar-pesha e padukshme që mbartin gratë*. Tiranë, Shqipëri: Autori.
- Civicus, IDM & UNDP Albania (2010). *Indeksi i shoqërisë civile për Shqipërinë. Në kërkim të qytetarëve dhe impaktit*. Tiranë, Shqipëri: Autorët.
- Çela, E. & Arqimandriti, M. (2010). *Fuqizimi i Gruas Rurale Shqiptare: Perspektivat ekonomike dhe sociale*. Tiranë, Shqipëri: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim & Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim.
- European Commission. (2010). *Communication from the Commission to the European Parliament and the Council: Commission Opinion on Albania's application for membership of the European Union* ëKomunikim nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin Evropian: Opinioni i Komisionit mbi aplikimin e Shqipërisë për anëtarësi në Bashkimin Evropianç. Brussels, Belgium: Autori.
- EU Heads of Mission to Albania. (2010). *Local strategy for the implementation of the EU Guidelines on violence against women and girls and combating all forms of discrimination against them* ëStrategjia lokale për zbatimin e Udhëzimeve të BE mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave dhe luftës së të gjitha formave të diskriminimit kundrejt tyreç . Tiranë, Shqipëri: Autori.
- Grupi i Grave Intelektuale me Aftësi të Kufizuara. (2009). *Platformë: Respektimi i të drejtave dhe pjesëmarrje e plotë e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në shoqëri dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së tyre*. Tiranë, Shqipëri: Autori.
- INSTAT. (2010). *2009 Labour Force Survey Results Labour Market in Albania* ë2009 Rezultatet e Anketimit për Fuqinë Punëtore – Tregu i Punës në Shqipëriç. Tiranë, Shqipëri: Autori.

- INSTAT. (2010). *Femra dhe Meshkuj, 2008*. Tiranë, Shqipëri: Autori.
- INSTAT. (2010). *Shqipëria në Shifra, 2010*. Tiranë, Shqipëri: Autori.
- INSTAT. (2009). *Anketa Demografike e Shëndetit*. Tiranë, Shqipëri: Autori.
- INSTAT. (2009). *Dhuna në familje në Shqipëri – Vrojtim kombëtar*. Tiranë, Shqipëri: Autori.
- Kuvendi i Shqipërisë. (2010a). *Rezolutë “Për Luftën kundër Dhunës ndaj Gruas dhe Rritjen e Dimensionit Parlamentar të Luftës kundër Dhunës në Familje”*. Tiranë, Shqipëri: Autori.
- Kuvendi i Shqipërisë. (2010b). *Ligji Nr. 10329 datë 30.9.2010 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9669, Datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të Ndryshuar*. Tiranë, Shqipëri: Autori.
- Kuvendi i Shqipërisë. (2010c). *Ligji Nr 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”*. *Fletorja Zyrtare, Nr. 15, Faqe 482*. Tiranë, Shqipëri: Qendra e Publikimeve Zyrtare.
- Kuvendi i Shqipërisë. (2008). *Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”*. *Fletorja Zyrtare, Nr 125, Faqe 5540*. Tiranë, Shqipëri: Qendra e Publikimeve Zyrtare.
- Kuvendi i Shqipërisë. (2006). *Ligji 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*. *Fletorja Zyrtare, Nr 150, Faqe 6113*. Tiranë, Shqipëri: Qendra e Publikimeve Zyrtare.
- Kuvendi i Shqipërisë. (2005). *Ligji Nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”*. *Fletorja Zyrtare, Nr. 22, faqe. 829*. Tiranë, Shqipëri: Qendra e Publikimeve Zyrtare.
- MPÇSSHB. (2010). *Udhëzim i MPÇSSHB nr.1220, datë 27.5.2010 Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të treguesve të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, mbikëqyrjen, mbledhjen dhe përpunimin e tyre*. *Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 78*. Tiranë, Shqipëri: Qendra e Publikimeve Zyrtare.
- MPÇSSHB. (2010). *Raporti Vjetor i Monitorimit për SKBGJ-DHF 2007-2010, Janar-Dhjetor 2009*. Tiranë, Shqipëri: Autori.
- Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim. (2009). *Trajtimi i problematikave sociale në media – Perspektivë gjinore*. Tiranë, Shqipëri: Autori.

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, (2009). *Përkatësia gjinore dhe të drejtat e njeriut, qytetaria, dhuna në familje, integrimi evropian, media, shëndeti riprodhues, zhvillimi i karrierës, mjedisi*. (Libër për nxënësit dhe libër për mësuesit). Tiranë, Shqipëri: Autori.

UNDP (1995). *Human Development Report 1995* ëRaport i Zhvillimit Njerëzor 1995ç. Oxford: OUP.

UNDP dhe UN-INSTRAW. (2010). *Migrimi, dërgesat dhe zhvillimi lokal që i përgjigjet nevojave gjinore*. Tiranë, Shqipëri : Autori.

UN Security Council Resolution 1325 (2000). *On women, peace and security* ëMbi gratë, paqen dhe sigurinëç.

Shtojca 1: Plani i Detajuar i Veprimit për Mekanizmin Institucional dhe Ligjor

Qëllimi Strategjik 1: Të fuqizohet Mekanizmi Institucional dhe Ligjor për të nxitur përparimin e barazisë gjinore dhe siguruar gëzimin e të drejtave njerëzore të të gjithë qytetarëve shqiptarë pa dallim përkatësie gjinore

Rrjedhojat deri në fund të vitit 2015

1. Barazia gjinore e integruar në politikat, strategjitë dhe programet sektoriale;

Evidentuar nga prania e aspektit gjinor (adresimi i nevojave të grave dhe burrave) në dokumentet përkatëse;

2. Burime financiare, njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për veprime ndërsektoriale mbi integrimin gjinor;

Evidentuar nëpërmjet buxheteve të ndjeshme nga pikëpamja gjinore të secilës ministri si dhe pushtetit vendor, dhe departamenteve të burimeve njerëzore në institucionet përkatëse (shprehur në lekë);

3. Të gjitha institucionet shtetërore dhe punonjësit shtetërorë (burra dhe gra) ndajnë përgjegjësitë për progres drejt arritjes së barazisë midis burrave dhe grave;

Evidentuar nëpërmjet veprimeve të ndërmarra për të integruar përkatësinë gjinore, si për shembull, aftësi të analistëve dhe planifikuesve për të integruar çështjet gjinore, sistemeve mbështetëse të informacionit dhe të dhënave për të ndihmuar vendim-marrjen, mekanizma konsultues me publikun (pjesëmarrja e OJF-ve dhe grupeve të tjera të interesit), kapacitete për të ndërmarrë ose porositur studime empirike dhe politikash për barazinë gjinore relevante për mandatin e institucionit, prezenca dhe funksionimi i rrjeteve brenda dhe midis institucioneve publike (në nivele operacionale dhe vendim-marrëse) dhe me shoqërinë civile që mbështet formulimin e politikave të barazisë gjinore.

4. Të dhëna të përditësuara në lidhje me përparimin e meshkujve dhe femrave në shoqëri

Evidentuar nëpërmjet statistikave tremujore dhe vjetore të INSTAT, të ministrive dhe të pushtetit vendor, si dhe Raportit Kombëtar për Statusin e Grave dhe Barazinë Gjinore (për t'u hartuar çdo dy vjet)

Tabela 3: Plani i Veprimit për Mekanizmin Institucional dhe Ligjor

Programe/Ndërhyrje	Strategjia Sektoriale Përkatëse	Institucionet përgjegjëse dhe/ose partnerë	Koha e realizimit	Treguesit	Metoda e Mbledhjes së Informacionit		Kosto
					Mbledhës Informacioni	Burimi	
Objektiv Specifik 1: Të përmirësohet Mekanizmi Shtetëror në nivel qendror dhe vendor për të përmbushur detyrat e tij siç parashikohet nga LBGJSH							
1.1.1 Të ftohet METE për të marrë pjesë në Këshillin Kombëtar i Barazisë Gjinore (KKBGJ) dhe të shihet mundësia e zgjerimit të KKBGJ me Ministri të tjera.	n/a	Ministritë përfaqësuese në KKBGJ OJF-të përfaqësuese në KKBGJ Organizatat Ndërkombëtare	2011-2015	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i ministrive të përfaqësuar në KKBGJ • Numri i takimeve të KKBGJ, me pjesëmarrjen e anëtarëve të rinj • Çështje të diskutuara në takime specifike të KKBGJ 	MPÇSSH	Protokolli i aktivitetit të KKBGJ	Kosto shtesë për honoraretë çdo anëtar të ri të KKBGJ-së, përpos koston për honoraretë anëtarëve ekzistues

Programe/Ndërhyrje	Strategjia Sektoriale Përkatëse	Institucionet përgjegjëse dhe/ose partnerë	Koha e realizimit	Treguesit	Metoda e Mbledhjes së Informacionit		Kosto
					Mbledhës Informacioni	Burimi	
1.1.2 Të fuqizohet struktura e DPSHBF, pas kryerjes së një analize të funksioneve që mund të diktojë shtimin e numrit të personelit ku një përfaqësues/e të jetë me aftësi të kufizuara	n/a	MPÇSSHB Organizata ndërkombëtare	2011-2012	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i punonjësve • Struktura e rishikuar • Ekzistenca e fondeve për të mbuluar shtesat 	MPÇSSHB	DPSHBF	Kosto e strukturës shtesë përfshirë pagat vjetore për vitet që do të mbulojë strategjia përfshirë dhe specialistët që mund t'i shtohen strukturës, DPSHBF-së, dhe kosto për pajisjen e këtyre personave me tavolinë dhe mjete pune, kompjuter. Kosto për kryerjen e analizës së funksioneve të Drejtorisë

Programe/Ndërhyrje	Strategjia Sektoriale Përkatëse	Institucionet përgjegjëse dhe/ose partnerë	Koha e realizimit	Treguesit	Metoda e Mbledhjes së Informacionit		Kosto
					Mbledhës Informacioni	Burimi	
1.1.3 Të forcohen kapacitetet e stafit të DPShBF në fushën e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të strategjisë si dhe të legjislacionit të barazisë gjinore, mosdiskriminimit dhe kundër dhunës me bazë gjinore. Kjo ndërhyrje duhet të synojë forcimin e kapaciteteve të stafit të kësaj Drejtorie për të siguruar integrimin gjinor edhe në politikat e tjera të MPÇSSHB	n/a	MPÇSSHB Organizata ndërkombëtare	2011-2015	Numri i aktiviteteve trainuese, materialeve teknike të prodhuara dhe i shkëmbimit të përvojave	MPÇSSHB	Raporte të trainimeve dhe aktiviteteve të tjera	Kosto për realizimin e trainimeve dhe prodhimin e materialeve teknike, të cilat evidentohen nga raporti i analizës së funksioneve (më lart)
1.1.4 Të vazhdohet emërimi dhe të garantohet	n/a	Ministritë dhe strukturat qeverisëse vendore	2011-2014	• Numri i NGJ-ve të emëruar në nivel	MPÇSSHB	Drejtoritë e Burimeve Njerëzore	Buxhetim organike në secilin ministri dhe

Programme/Ndërhyrje	Strategjia Sektoriale Përkatëse	Institucionet përgjegjëse dhe/ose partnerë	Koha e realizimit	Treguesit	Metoda e Mbledhjes së Informacionit		Kosto
					Mbledhës Informacioni	Burimi	
qëndrueshmëria e strukturave të Nënpunësve Gjinorë (NGJ) në nivel qendror dhe vendor sipas LBGJSH, Neni 13, pika 3		DAP		qendror dhe vendor; <ul style="list-style-type: none"> Fond i përcaktuar për këtë pozicion pranë institucioneve në nivel qendror dhe vendor. 		pranë Ministrive dhe strukturave vendore	në qeverinë vendore për një punonjës/e me kohë të plotë për çdo institucion
1.1.5 Të institucionalizohet rrjeti i NGJ në nivel qendror dhe vendor dhe të bëhet mirëmbajtja e bazës së të dhënave të NGJ, lidhur me ndërhyrjet për rritjen e kapaciteteve të	n/a	MPÇSSHB	2011-2015	<ul style="list-style-type: none"> Rrjet i ngritur Bërthamë koordinimi e rrjetit e ngritur pranë DPSHBF-së Numri i 	MPÇSSHB	Raportet vjetore të Strategjisë, raportet e mbledhjeve të KKBGJ ku raportohet	Ngritje e rrjetit, p.sh., mbledhje e të gjithë NGJ, ndërtimi i një bërthame që do të koordinojë punën e rrjetit dhe që do të

Programe/Ndërhyrje	Strategjia Sektoriale Përkatëse	Institucionet përgjegjëse dhe/ose partnerë	Koha e realizimit	Treguesit	Metoda e Mbledhjes së Informacionit		Kosto
					Mbledhës Informacioni	Burimi	
tyre				<p>mbledhjeve të organizuara nga MPÇSSHB me rrjetin e NGJ (listat e pjesëmarrësve)</p> <ul style="list-style-type: none"> Nismat e ndërmarra nga rrjeti i NGJ në nivel qendror dhe vendor 		<p>lidhur me punën e NGJ</p> <p>Raporti periodik i CEDAW-t</p>	<p>përcaktojë çfarë realisht do të bëjë ky rrjet – kosto që do të përfshihen në rishikimin e funksioneve të DPSHBF.</p>
1.1.6 Të organizohet një konferencë e përvitshme ku të trajtohen arritjet dhe problematikat në fushën e barazisë gjinore në	n/a	<p>MPÇSSHB</p> <p>Ministri të përfshira</p> <p>OJF</p> <p>Donatorë</p>	2012-2015	<p>Konferenca</p> <p>Numri i organizatave dhe institucioneve</p>	MPÇSSHB	<p>Raporte të prodhura nga MPÇSSHB në lidhje me konferencën</p>	<p>Kostimi të bëhet në bazë të Konferencës në lidhje me stereotipet gjinore</p>

Programe/Ndërhyrje	Strategjia Sektoriale Përkatëse	Institucionet përgjegjëse dhe/ose partnerë	Koha e realizimit	Treguesit	Metoda e Mbledhjes së Informacionit		Kosto
					Mbledhës Informacioni	Burimi	
Shqipëri		Media Sektori privat Partitë politike		përfaqësuese në forum		vjetore	në Qershor 2010.
Objektiv Specifik 1.2 Të rishikohet legjislati shqiptar nga këndvështrimi gjinor në përputhje me dokumentat ndërkombëtarë dhe kombëtarë të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit							
1.2.1 Të hartohet një plan pune në bazë të rekomandimeve të CEDAW për secilin institucion përgjegjës	n/a	MPÇSSH, Ministrinë dhe institucionet vartëse	2011	Numri i planeve të punës	MPÇSSH	Ministrinë e linjës	Nuk ka kosto shtesë veç pagave ekzistuese të nëpunësve që do të punojnë me hartimin e planeve
1.2.2 Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Komiteti i CEDAW në kuadër të	n/a	MPÇSSH, MPJ, Ministrinë dhe	2011-2015	<ul style="list-style-type: none"> Raportet vjetore të Strategjisë duhet të 	MPÇSSH	Raportet vjetore të Strategjisë Raporti IV zyrtar i Shqipërisë	Raportet vjetore të Strategjisë nuk kanë kosto shtesë

Programe/Ndërhyrje	Strategjia Sektoriale Përkatëse	Institucionet përgjegjëse dhe/ose partnerë	Koha e realizimit	Treguesit	Metoda e Mbledhjes së Informacionit		Kosto
					Mbledhës Informacioni	Burimi	
Raportit të III të Qeverisë Shqiptare.		institucionet që ngarkohen direkt, Kuvendi		<p>përbajnë të dhëna për zbatimin e planeve të punës për zbatimin rekomandimeve të CEDAW-t</p> <ul style="list-style-type: none"> Raport i katërt periodik i Shqipërisë, adreson rekomandime të dhëna nga Komiteti i CEDAW-t gjatë raportimit III periodik. 		pranë Komitetit të CEDAW	Përkthimi i Raportit IV periodik të Shqipërisë kërkon kosto

Programe/Ndërhyrje	Strategjia Sektoriale Përkatëse	Institucionet përgjegjëse dhe/ose partnerë	Koha e realizimit	Treguesit	Metoda e Mbledhjes së Informacionit		Kosto
					Mbledhës Informacioni	Burimi	
				<ul style="list-style-type: none"> Numri i raportimeve të Qeverisë në Kuvend për zbatimin e rekomandimeve të CEDAW-t 			
1.2.3 Vlerësim lidhur me përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar me Konventën CEDAW, acquis communautaire të BE-së, LBGJSH, LDHF, LMD.	n/a	MPÇSSHB, MD, MI, MSH, MASH, KKRTSH, KOZ Organizatata ndërkombëtare	2015	Raporti	MPÇSSHB	Raporti i përgatitur	Kosto për dy eksperte
1.2.4 Të vazhdohet ndërgjegjësimi i opinionit publik sidomos i grave dhe vajzave për të drejtat	n/a	MPÇSSHB Komisioneri për Mbrojtjen nga	2011-2015	<ul style="list-style-type: none"> Numri i aktiviteteve informuese dhe 	MPÇSSHB	Raporte të përgatitura për aktivitetet ndërgjegjësuere	6 mln lekë në vit

Programe/Ndërhyrje	Strategjia Sektoriale Përkatëse	Institucionet përgjegjëse dhe/ose partnerë	Koha e realizimit	Treguesit	Metoda e Mbledhjes së Informacionit		Kosto
					Mbledhës Informacioni	Burimi	
ligjore që u takojnë (LBGJSH, LDHF, LMD)		Diskriminimi Media OJF-të Organizatat Ndërkombëtare		ndërgjegjësues <ul style="list-style-type: none"> • Numri i pjesëmarrësve në aktivitete • Numri i grave dhe vajzave që nisin procese gjyqësore ose administrative për të kërkuar të drejtat e tyre, si rezultat i ndërgjegjësimit 		dhe informuese	
1.2.5 Të bëhet analizë gjinore e të gjitha	Të gjitha strategjitë	Të gjitha institucionet me strategji sektoriale	2011-2013	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i strategjive 	MPÇSSHB	Analiza e Strategjive	Kosto për ekip ekspertësh

Programe/Ndërhyrje	Strategjia Sektoriale Përkatëse	Institucionet përgjegjëse dhe/ose partnerë	Koha e realizimit	Treguesit	Metoda e Mbledhjes së Informacionit		Kosto
					Mbledhës Informacioni	Burimi	
strategjive sektoriale për të parë si perspektiva gjinore është integruar në ndërhyrje dhe buxhete				sektoriale që integrojnë perspektivën gjinore në ndërhyrje dhe buxhet			
Objektiv Specifik 1.3: Të rriten kapacitetet e autoriteteve qendrore dhe vendore për zbatimin dhe monitorimin e legjisllacionit dhe stategjisë për barazinë gjinore në Shqipëri							
1.3.1 Të ngrihet dhe të forcohet me aktivitete trainuese Sektori i Monitorimit të strategjisë brenda DPSHBF	n/a	MPÇSSHB Organizatrat Ndërkombëtare	2011-2015	<ul style="list-style-type: none"> Sektor i formuar Numri dhe lloji i trainimeve 	MPÇSSHB	DPSHBF	Të bëhet kostimi sipas një zyre me tre ekspertë përfshirë një eksperte me aftësi të kufizuar – kosto përshtatshme.
1.3.2 Të rriten kapacitetet e nëpunësve të Ministrive dhe	n/a	MPÇSSHB Ministrinë e linjës dhe	2011-2014	<ul style="list-style-type: none"> Numri dhe lloji i aktiviteteve trainuese; 	MPÇSSHB	Raportet e aktiviteteve trainuese	Të kostohe në bazë të trainimeve klasike

Programe/Ndërhyrje	Strategjia Sektoriale Përkatëse	Institucionet përgjegjëse dhe/ose partnerë	Koha e realizimit	Treguesit	Metoda e Mbledhjes së Informacionit		Kosto
					Mbledhës Informacioni	Burimi	
administratës publike të cilët merren me planifikimin e buxheteve, hartim të strategjive me çështje të integritit gjinor.		institucionet vartëse Organizatrat ndërkombëtare		<ul style="list-style-type: none"> Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet trainuese 			<p>një ditore me kosto ekspertize një eksperti të huaj, një eksperti shqiptar dhe një lehtësues si dhe materiale dhe shpenzime trainimi.</p> <p>Kosto për dy udhëtime jashtë vendit për shkëmbim përvojë me institucione të specializuara</p>
1.3.3 Të ngrihen kapacitetet e NGJ qendrorë dhe vendorë	n/a	Ministritë dhe strukturat qeverisëse vendore	2011-2015	<ul style="list-style-type: none"> Numri i trainimeve, vizitave 	MPÇSSHB	NGJ në çdo institucion në nivel qendror	Kosto trainimesh dhe ekspertësh trainues të

Programe/Ndërhyrje	Strategjia Sektoriale Përkatëse	Institucionet përgjegjëse dhe/ose partnerë	Koha e realizimit	Treguesit	Metoda e Mbledhjes së Informacionit		Kosto
					Mbledhës Informacioni	Burimi	
për monitorimin në bazë të treguesve për çështjet e barazisë gjinore		DAP, Organizatat nderkombetare		shkëmbje në lidhje me zbatimin dhe monitorimin <ul style="list-style-type: none"> • Numri i pjesëmarrësve • Numri i nismave të ndërmarra nga NGJ-të në çdo institucion në nivel qendror dhe vendor 		dhe vendor	përlogaritura si më lart
1.3.4 Të rifreskohen dhe riprodhohen sipas nevojës manualët e UNDP, UN Women dhe	n/a	MPÇSSH B Organizatat Ndërkombetare	2011	Numri dhe lloji i materialeve të riprodhuar dhe shpërndarë	MPÇSSH B	Raporte të projekteve që prodhojnë këto materiale	Të kostohe në bazë të manualëve të krijuar nga DAP

Programet/Ndërhyrje	Strategjia Sektoriale Përkatëse	Institucionet përgjegjëse dhe/ose partnerë	Koha e realizimit	Treguesit	Metoda e Mbledhjes së Informacionit		Kosto
					Mbledhës Informacioni	Burimi	
Programit Barazi në Qeverisje për punën e NGJ në nivel ministrie dhe nivel vendor për të siguruar integrimin gjinor në fushat përkatëse dhe për të promovuar barazinë gjinore në nisma të ndryshme programatike të qeverisë.							
1.3.5 Të hartohen paketa udhëzimesh që do të lehtësojnë monitorimin e zbatimit të standardeve gjinore nga inspektoratet shtetërore	Strategjitë e sektorëve të Arsimit, Shëndetësisë, të Punësimit, të Drejtësisë Plani Vjetor i punës së	MPÇSSHB, MF, MB, MD (asistencë ligjore), MR, Inspektoratet Shtetërore ⁵⁴ , KKRTSH Organizatata ndërkombëtare	2011-2012	<ul style="list-style-type: none"> • Paketat e hartuar • Ritmet e përdorimit të paketave • Raportet vjetore të inspektoratëve 	MPÇSSHB	Vrojtime në inspektoriatet shtetërore lidhur me përdorimin e paketave	Kosto e ekspertizës

⁵⁴ DPSHBF duhet të përcaktojë edhe institucionet e tjera përgjegjëse dhe partnere për këtë ndërhyrje.

Programe/Ndërhyrje	Strategjia Sektoriale Përkatëse	Institucionet përgjegjëse dhe/ose partnerë	Koha e realizimit	Treguesit	Metoda e Mbledhjes së Informacionit		Kosto
					Mbledhës Informacioni	Burimi	
	KKRTSH			e evidentojnë rastet kur monitorimi është kryer sipas paketave udhëzuese të përgatitura			
1.3.6 Të forcohen kapacitetet për zbatimin e paketave monitoruese të zbatimit të integritit gjinor përfshirë analizën gjinore.	Strategjitë sektoriale të Arsimit, Shëndetësisë, të Punësimit, të Drejtësisë Plani Vjetor i Punës së KKRTSH	MPÇSSHB Organizatat Ndërkombëtare	2011-2015	<ul style="list-style-type: none"> • Numri i trainimeve të organizuara • Numri i pjesëmarrësve në trainime 	MPÇSSHB	Raporte vlerësuese të aktiviteteve trainuese	Të kostonen trainime klasike 2-ditore për çdo grup profesionistësh, në varësi të numrit që ka çdo inspektoriat. Pjesëmarrja mund të jetë në 25-30 persona për çdo trainim. Gjithashtu të

